



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E AELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E
ORGANIZUAR

Nr. Regj. Them.16/73
Dt. e regj. 17.10.2022

Nr. Vendimi 5
Datë vendimi 12.01.2023

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Posaçme e AELIT për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e përbërë nga gjyqtarët:

MILIANA MUÇA	Relatore
DANIELA SHIRKA	Anëtare
IGERTA HYSI	Anëtare

më datë 06.01.2023, në prani të sekretares gjyqësore Valbona Zenelaj, mori në shqyrtim në seancë publike çështjen me numër regjistri nr.73, datë regjistrim 17.10.2022 që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorja **Enkeleda Millonai**.

KUNDËR TË PANDEHURËS: **E.Ç.**, e bija e R. dhe e S., e datëlindjes {...}, lindur në {...} dhe banuese në {...}, me adresë: {...}, me shtetësi shqiptare, gjendja gjyqësore e padënuar, me arsim të lartë, mbrojtur nga **Av.Ermal Yzeiraj**, me Nr.10407 Liçense dhe NIPT N01411034T dhe **Av.Artemida Hoxhaj** me Nr.10975 Liçense anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

E AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikim i dokumentave”, në formën e përdorimit, si dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, në formën e “deklarimit të rremë”, parashikuar përkatësisht nga nenet 186/1 dhe 257/a/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr.48, datë 16.09.2022 ka vendosur:

- 1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.*
- 2. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprës penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.*
- 3. Në aplikim të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara dhe të përshkruara në Urdhrin e datës 21.06.2022 “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin e gjykimit” të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, t’i kthehen noterës Luljeta Kongoli; ASHK, Tirana Veri, Arkiva vendore; ASHK, Dega Kavajë dhe Bankës Amerikane të Investimeve.*

4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Pasi dëgjoji palët në përfundim të shqyrtimit gjyqësor që përmbledhtazi kërkuan:

I. Prokuroren e posaçme Enkeleda Millonai:

1. Ndryshimin e vendimit nr.315, datë 17.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke u pranuar kërkesa e prokurorit me objekt përjashtimin e gjyqtarit Erjon Bani dhe bazuar në nenin 428 gërma “ç”, prishjen e vendimit 16.09.2022 dhe kthimi për rigjykim i çështjes dhe në rast mospranimi ndryshimn e vendimit nr.48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke vendosur përfundimisht:

1. Deklarimin fajtores të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i K.Penal, duke e dënuar me 1 (një) vit burgim.

2. Deklarimin fajtores të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprës penale të “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i K.Penal, duke e dënuar me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

3. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

4. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, t’i zbritet 1/3 nga masa e dënimit duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit burgim.

5. Në zbatim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venien në provë për një afat prej 2 (dy) vitesh, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

6. Në zbatim të nenit 391 të K.Pr.Penale të deklarohet falsiteti i kontratës së shitblerjes me nr. {...}rep, nr. {...} kol, datë {...} (data {...} e korrigjuar) për shitblerjen e pasurisë me nr. {...} ZK {...}, sipërfaqe prej 3440 m², me çmim 50 000 euro.

7. Shpenzimet proceduriale të kryera në hetim paraprak, si dhe ato të kryera gjatë gjykimit, t’i ngarkohen te pandehurës”.

II. Mbrojtësi i të pandehurës E.Ç., av.Ermal Yzeiraj: Rrëzimin e ankimit të bërë nga ana e Prokurorisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.315, datë 17.07.2022 dhe vendimit nr.48, datë 16.09.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

III. E pandehura E.Ç. pohoi fjalën e mbrojtësit të zgjedhur prej saj.

VËREN

1. Vendimi nr.48, datë 16.09.2022 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë duhet të lihet në fuqi.

I. Rrethanat procedurale dhe qëndrimi i këtij kolegji mbi ato të rezultuara gjatë gjykimit në juridiksion apeli.

2. Pranë Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është paraqitur kërkesa me Nr.97 Akti, me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr.202, datë 13.07.2021, në ngarkim të të pandehurës E.Ç., e cila akuzohet për kryerjen e veprave penale “*Falsifikim i dokumentave*”, në formën e përdorimit, dhe “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 257/a/2 i Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar nga Prokuroria e Posaçme mbi kallëzimin e paraqitur me nr.593 Prot, datë 28.06.2021 të SH.A.A.SH. (nr.211 kallëzimi, datë 30.06.2021), duke i atribuar të kallëzuarës kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 180, 186, 257/a dhe 287 të Kodit Penal.

3. Më datë 04.07.2022 gjyqtari i përcaktuar me short për gjykimin e kërkesës i ka paraqitur Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështje. Me vendimin Nr.1052 Prot, datë 13.07.2022 “Mbi kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes”, Kryetarja e Gjykatës ka vendosur *refuzimin e kërkesës se gjyqtarit Erjon Bani, për heqje dorë nga gjykimi i kërkesës penale nr.97 Akti, datë 30.06.2022, me të pandehur E.Ç..*

4. Pas kësaj, Prokurorja e çështjes ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues (monokratik), gjyqtarit Erjon Bani, pasi sipas saj çënohet “paanësia në dukje”, duke referuar në nenet 17, pika “ë”, 18 shkronja”a”, 19, 21, 22 të K.Pr.Penale. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues, ku me vendimin Nr.315, datë 17.07.2020 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me nr.regj.them 315, datë regjistrimi 15.07.2022, me objekt "Përjashtimi i gjyqtarit Erjon Bani, nga shqyrtimi në seancë paraprake të kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë... ”.*

5. Gjykimi në shkallë të parë rezulton të jetë zhvilluar me ritin e gjykimit të shkurtuar, konform neneve 403-406 të K.Pr.Penale, mbi kërkesën e të pandehurës E.Ç. (të paraqitur fillimisht në fazën e seancës paraprake). Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me përbërje të njëjtin gjyqtar, pra, me gjyqtarin e seancës paraprake (sipas nenit 332/dh, shkronja “c” të K.Pr.Penale¹, ka disponuar me vendimin nr.48, datë 16.09.2022, objekt apelimi nga prokurori i posaçëm, duke kërkuar ndër të tjera në aktin “apel” dhe përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në apel, duke referuar në nenin 427 të K.Pr.Penale.

5.1. E pandehura E.Ç., brenda afatit ligjor, ka paraqitur apel kundërshtues.

6. Rezulton se ka ushtruar apel edhe SH.A.A.SH, ankim i cili është regjistruar në kryesekretarinë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me numër 451,

¹ Neni 332/dh, shkronja “c” i K.Pr.Penale: “**Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake**”: “1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzë; c) **të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi.** Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një veprave penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit.

datë 06.10.2022, në përfundim të të cilit kërkohet: “Prishja e vendimit dhe kthimin e akteve për shqyrtim me tjetër trup gjykues”.

7. Nga gjykata që ka dhënë vendimin, aktet e procedimit dhe ankimet, përfshirë edhe atë të SH.A.A.SH, i janë dërguar Gjykatës që do shqyrtojë ankimin, Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në zbatim të nenit 419 të K.Pr.Penale².

8. Në seancat gjyqësore të datave 11.11.2022 dhe 25.11. 2022, ky kolegji, kryesisht, shtroi për diskutim legjitimitimin e SH.A.A.SH, rezultuar pala kallëzuese, **për të ushtruar ankim ndaj vendimit nr.48, datë 16.09.2022**, gërshetuar me **legjitimitimin në vështrim të nenit 426/a, pika 2 të K.Pr.Penale**, i cili parashikon vijimin e gjykimit në apel me hapat e tjerë proceduralë, pas verifikimit dhe legjitimitimit të palëve: “Pas verifikimit të palëve dhe legjitimitimit të tyre ...”.

8.1. Në seancën gjyqësore të datës 25.11.2022, Gjykata e Posaçme e Apelit, referuar në pikën 1, shkronja “a” të nenit 420 të Kodit Procedurës Penale vendosi: “*Mospranimin e ankimit nr.451, datë 16.09.2022 të SH.A.A.SH, ndaj vendimit nr.48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”.

8.2. Në vendimin e arsytuar me shkrim nga ky kolegji ndër të tjera është konkluduar, se: “6.Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit arsyeton se, **rrethanat lidhur me mospranimin e ankimit mund të konstatohen në çdo kohë, dhe kjo rezulton qartazi nga parashikimi i nenit 420, pika 1 të K.Pr.Penale (fjalë e parë): “.....Mospranimi mund të deklarohet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit”**.

7. Ky kolegji vlerëson se gjendet në kushtet e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, për shkak se SH.A.A.SH, nuk legjitimohet të apelojë vendimin nr.48, datë 16.09.2022.

Neni 420, pika 1, shkronja “a” të K.Pr.Penale, parashikon si një ndër rastet e mospranimit të ankimit: “**kur është bërë nga ai që nuk është legjitimuar**”.

8. Konstatohet se subjektet që kanë të drejtën e apelit ndaj vendimit përfundimtar janë të përcaktuar në nenin 422 të K.Pr.Penale, që parashikon shprehimisht: “**1. Prokurori, i pandehuri dhe, paditësi civil dhe i padituri civil kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës së Shkallës së Parë**”. Pra, vetë kjo dispozitë procedurale ka saktësuar se cilët ushtrojnë ankim ndaj vendimit përfundimtar, duke rezultuar ky parashikim në harmoni me parashikimin e nenit 407 të K.Pr.Penale, pika 4, sipas të cilës e drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njej shprehimisht (kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre)“ (citim).

8.3. Po në seancën gjyqësore të datës 25.11.2022, kolegji, në vijim të vendimmarrjes për mospranimin e ankimit të SH.A.A.SH, disponoi edhe: “*Për sa i përket legjitimitimit si palë në Gjykatën e Posaçme të Apelit, në vështrim të nenit 426/a të K.Pr.Penale, kjo palë, pra, SH.A.A.SH, nuk legjitimohet për faktin se si palë në juridision apeli legjitimohen ato që kanë qenë palë edhe gjatë gjykimit në shkallë të parë*” (citim nga procesverbali i seancës gjyqësore).

8.4. Ndërkohë, gjatë seancës paraprake (në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë) është disponuar me rrëzimin si të pabazuar në ligj të kërkesës së SH.A.A.SH. me objekt: “*Thirrjen procedurale me cilësinë e kallëzuesit të veprës penale*”, me argumentin se shoqata nuk ka cilësinë e viktimës, duke referuar në nenin 332/a të K.Pr.Penale (nen sipas të cilit, gjyqtari i seancës paraprake njofton të

² Neni 419 i K.Pr.Penale: “Gjykata që ka dhënë vendimin i dërgon, brenda pesë ditëve nga realizimi i njoftimeve, gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, aktet e procedimit dhe ankimin, nëse nuk është hequr dorë nga ankimi.

pandehurin dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj). Gjithashtu, ka vlerësuar të drejtë faktin që prokurorja nuk e ka njoftuar në përfundim të hetimit, duke referuar në nenin 327, pika 2 të K.Pr.Penale (nen sipas të cilit prokurori, njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin, mbrojtësin, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj).

9. Gjatë gjykimit në apel, prokurorja e posaçme, sikurse kishte kërkuar dhe ndër shkaqet e ankimit, kërkoj përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në apel, referuar në nenin 427, pika 4 të K.Pr.Penale³, meqenëse gjykata e shkallës së parë e ka deklaruar të pafajshme të pandehurën E.Ç.. Prokurorja kërkoj marrjen e po atyre provave që ishin marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe meqenëse, sipas prokurores, procedura e gjykimit ka qenë ajo e gjykimit të shkurtuar, duhet të merren të gjitha aktet e fashikullit të procedimit penal nr.202 të vitit 2021.

9.1. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, mori në shqyrtim paraprakisht kërkesën e prokurores për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në apel dhe në referencë të pikës 4, në lidhje me pikën 1 të nenit 427 të K.Pr.Penale, vendosi të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. U lejuan për shqyrtim të njëjtat prova të kërkuara nga palët, duke iu dhënë mundësia palëve t'i kundërshtojnë provat dhe t'i debatojnë ato (trajtuar më hollësisht ky moment përsa i përket kufijve të shqyrtimit gjyqësor në apel, në pjesën IV “Vlerësimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit).

II. Shkaqet e ankimit

10. Kundër vendimit është depozituar *ankim nga Prokuroria e Posaçme* në kryesekretarinë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr.444 ankimi, datë 28.09.2022. Konkretisht, si shkaqe ankimi ngrihen:

i. Nga ana e gjykatës nuk është dhënë asnjë arsye e vlefshme, pra, nuk është arsyetuar në thelb, përse tek prokurori apo publiku nuk perceptohet ekzistenca e konfliktit të interesit në dukje e gjyqtarit Erjon Bani me të pandehurën E.Ç., i perceptuar në fakt edhe prej vetë gjyqtarit.

ii. Mënyra e zhvillimit të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kriteret mbi të cilat mbështetet ky proces, krijon konflikt interesi në dukje, referuar sjelljes së kryer nga e pandehura, të lindura si pasojë e funksionit të saj si anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), në ndërthurje se, në kuadrin e këtij funksioni, ajo ka hetuar edhe gjykuar vetë gjyqtarin Erjon Bani, ndër të tjera dhe deklaramet e tij të pasurisë.

iii. Megjithëse procesi i zhvilluar në KPK shfaqet i natyrës administrative dhe në rastin e të pandehurës E.Ç. i natyrës penale, në thelb mbështetet në një pjesë dërrmuese në deklaramet e dhëna para ILDKPKI-së nga subjekti dhe në rastin konkret nga e pandehura E.Ç..

iv. Sillen në vëmendje në aktin ankim, ligji nr.9367, dat 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”, Parimet e Bangalores, Rezoluta me 10 parimet miratuar nga GJEDNJ-ja, neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 17, pika “ë” i K.Pr.Penale dhe, në tërësi, prokurorja e posaçme argumenton perceptimin tek të tretët të faktit se i gjykuari (pra, gjyqtari Erjon Bani), gjykon “gjykuesen e vet”, dmth të pandehurën E.Ç. dhe në përfundim kërkon ndryshimin e vendimit që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, i ankimueshëm së bashku me vendimin përfundimtar.

³ Neni 427, pika 4 i K.Pr.Penale :“Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor”.

v. Fokusuar në këtë shkak ankimi, bazuar në nenin 428 gërma “ç”, kërkohet prishja e vendimit nr.48, datë 16.09.2022 dhe kthimi për rigjykim i çështjes.

vi. Kundërshtohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili ka deklaruar të pafajshme të pandehurën E.Ç. lidhur me dy akuzat, duke vlerësuar se vendimi i gjykatës vjen në kundërshtim me ligjin dhe me provat, më specifikuisht si më poshtë:

vii. Veprimi juridik i shitjes që arsyeton gjykata se fsheh veprimin juridik të dhurimit, nuk qëndron, pasi e pandehura është bashkëpronare në këto prona dhe ka marrë gati 1/5 tokë sa i takon. Rruga e duhur ligjore, nëse e pandehura nuk dëshironte të ishte më në bashkëpronësi, do të kishte qenë pjestimi i sendit. Dy sipërfaqet e tokave të të pandehurës E.Ç. janë fituar në mënyrë të kundërligjshme, pasi përveçse nuk është ndjekur rruga e duhur ligjore, rezulton se një prej bashkëpronarëve nuk ka nënshkruar. Sidoqoftë, e pandehura nuk është sjellë në gjykim për falsifikim në lidhje me këto dy kontrata që gjenden tek noteri dhe në ASHK, por për një kontratë të falsifikuar që paraqet të dhëna të ndryshme nga njëra prej kontratave që gjendet tek noteri dhe në ASHK, konkretisht, për një kontratë ku ndryshon dukshëm çmimi, shumë herë më i lartë.

viii. Ndryshe nga sa arsyeton gjykata, kontrata me nr. {...} rep, datë {...} (datë {...} e korrigjuar), për parcelën me sip 3440 m² me vlerë 50 000 euro, nuk është bërë në të njëjtën ditë si kontrata me të njëjtat ekstremite, por me vlerë 300 000 lekë për shkak se më datë 31.07.2006 kontrata ka qarkulluar me vlerë 300 000 lekë dhe është depozituar në ish-ZVRPP Kavajë për regjistrim. Duke pranuar interpretimin e gjykatës se është kryer mbi sugjerimin e bankës, atëherë vlera është ndryshuar në përputhje me provat e tjera pas datës 06.09.2006, pra, dy muaj më vonë, pasi është bërë vlerësimi i pronës nga banka. Pikërisht, ky vlerësim i bërë dy muaj më vonë, ka nxjerrë një vlerë të pronës në shumën 48,000 euro që i ka shërbyer të pandehurës E.Ç. për të falsifikuar në bashkëpunim me noteren dhe familjarët e saj kontratën e sipërcituar, kjo duke i ndryshuar çmimin nga 300,000 lekë në 50,000 euro. Që një akt të jetë origjinal, nuk do të thotë se nuk është i falsifikuar. Akti i falsifikuar është origjinal, është kryer me vullnet të palëve, pasi edhe falsifikimi me vullnet kryhet dhe është akt zyrtar, pasi është kryer para noterit.

ix. Kontrata me nr. {...} rep, datë {...} (datë {...} e korrigjuar), për parcelën me sipërfaqe 3440 m² me vlerë 50,000 euro, është përdorur nga e pandehura E.Ç. në momentin e thirrjes dhe pyetjes nga inspektorja e ILDKPKI më datë 02.10.2017, ndërkohë që deklarata e pasurisë së interesave private është dorëzuar më datë 17.07.2017. Pra, e pandehura e ka dorëzuar këtë kontratë më vonë nga data e deklaratës, mbi dy muaj më vonë dhe sipas akuzës (në ndryshim nga çfarë arsyetohet në vendimin e ankimuar), kemi konkurim ndërmjet veprave penale të parashikuar nga neni 257/a dhe 186 të Kodit Penal.

x. Pasuritë janë regjistruar në emër të të pandehurës, konkretisht, dy parcelat tokë arë, në kundërshtim me ligjin, pasi nuk mund të regjistroheshin me kontratë shitje, ndërkohë që ajo ishte bashkëpronare, nuk mund të konsiderohen dhurim, pasi është bashkëpronare dhe, për më tepër, fitimi i pronësisë mbi këto dy parcela specifike në emër të të pandehurës E.Ç., pavarësisht formës juridike që ka zgjedhur, konstatohet se i mungon vullneti i bashkëpronares tjetër O.Ç.. Në mënyrën se si e pandehura ka deklaruar në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, ajo nuk i justifikon pasuritë e saj me të ardhura të ligjshme, pra, blerja e dy parcelave tokë arë dhe e apartamentit me të ardhura nga paga dhe kredia. Deklarimi në vijim i kësaj të pandehure, gjendur para thirrjes nga ILDKPKI për të dhënë shpjegime, nuk mund ta përjashtojë atë nga përgjegjësia penale.

xi. Vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshem, se e pandehura E.Ç. ka nënshkruar me vullnet të plotë dy kontrata me çmime të ndryshme, në periudha të ndryshme kohore dhe përgjatë arsyesimit të vendimit, gjykata këmbëngul të theksojë se çmimi qenka ndryshuar brenda të njëjtës ditë. Sipas palës ankuese, pas datës 06.09.2006, pasi ishte bërë raporti i ekspertimit nga studio “{...}”, rezulton e

provuar se e pandehura dhe familjaret e saj, në bashkëpunim kanë ripërgatitur dhe nënshkruar kontratën nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...}, duke ndryshuar çmimin nga 300,000 lekë në 50,000 euro. Sipas Prokurorisë së Posaçme, rezulton e provuar se kontrata me nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} (data {...} e korrigjuar) për shitblerjen e pasurisë me nr. {...}, sipërfaqe prej 3440 m² ku çmimi i shitjes është shënuar të jetë në vlerëm 50,000 euro, provohet sipas Prokurorisë së Posaçme tej çdo dyshimi se është dorëzuar dy muaj më vonë pas dorëzimit të deklaratës dhe është dorëzuar, pikërisht, më datë 02.10.2017.

xii. Gjykata nuk mund të quajë të provuar faktin se kontrata është lidhur realisht më datë {...}, pasi, siç u theksua më sipër, në regjistrin e noteres kontrata është e regjistruar më datë 06.07.2006. Data {...} është korrigjuar me qëllim që të përputhej me kartelat e pasurisë që po shitej në emër të shtetasit R.Ç., të cilat mbanin datën {...}. Pra, këto kartela janë shtuar më vonë dhe, kur janë shtuar, ka ndryshuar edhe data.

xiii. Gjykata shprehet se shuma e përmendur në kontratën e shitjes është diktuar nga “{...}” Bank, sikur ky të jetë një fakt lehtësues dhe justifikues në kryerjen e veprimeve të kundërligjshme. Gjykata nuk vë në dukje fare se këto veprime janë veprime mashtruese në kurriz të ligjit, pasi edhe bashkëlidhur kontratave, nuk vendosen certifikatat e vitit 1991, ku shfaqet gjendja familjare e familjes Ç., me pesë anëtarë, pra, edhe motrat E. dhe O. si bashkëpronare, por vendosen certifikatat familjare të vitit 2006 të shtetasit R., ku motrat janë shkëputur nga trungu familjar.

xiv. Prokuroria e Posaçme nuk është dakort me arsyetimin në vendimin e ankimuar, duke përmendur dispozita të katër Kodeve (civile, penale dhe procedurat përkatëse), për të kualifikuar faktin në juridiksionin që kjo gjykatë mendon se duhet kualifikuar e me sa kuptohet në juridiksionin civil. Veprimi që palët kanë dashur të fshehin, nuk ka qenë ai që konkludon gjykata e shkallës së parë, pra, “dhurimi”, por ka qenë marrja e një kredie për blerje apartamenti.

xv. Gjykata anashkalon faktin se vlera 50,000 euro ekziston në një kontratë me të njëjtat ekstremitete si ajo që gjendet në ASHK dhe në arkivën e noteres, por me vlerë të ndryshme, duke e quajtur si normale që palët të qarkullojnë akte noteriale për të njëjtin veprim me vlera të ndryshme. Mundohet të analizojë se ky çmim është ndryshuar po atë ditë, kur në fakt nga provat rezulton qartësisht që është bërë dy muaj më vonë, pasi kanë ardhur në dijeni të vlerësimit që banka i ka bërë pronës.

xvi. Në vijim, teksa ka dashur të analizojë se çfarë quhet falsifikim, gjykata ka vlerësuar se kontratat me nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} dhe kontrata e shitblerjes me nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...}, nuk futen në kategorinë e dokumentave të falsifikuara, pasi këto dokumenta janë origjinale dhe shprehje e vullnetit të palëve. Fakti që në institucione të ndryshme qarkullon një kontratë me të njëjtat ekstremitete, por me vlerë të ndryshme çmimi, vërteton më së miri ekzistencën e dokumentit të falsifikuar. Dokumenti i falsifikuar është, pikërisht, kontrata me nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} e gjendur pranë {...} Bak dhe pranë ILDKPKI-së që nuk përputhet me kontratën me nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} të gjendur pranë ASHK-së dhe pranë arkivës së noteres Luljeta Kongoli. Në gjithë arsyetimin e vendimit në vijim, gjykata e shkallës së parë vijon t’i mëshojë faktin se kemi të bëjë me fiktivitet dhe simulim dhe për mosmarrëveshje juridiko-civile personi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi penale. Ky arsyetim është jashtë frymës së akuzës së ngritur dhe e le të paarsyetuar pafajësinë e dhënë.

xvii. Përmendja në arsyetimin e gjykatës në pikën 37.6, të vendimit nr.26511, datë 22.09.2020 të Seksionit V Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Italisë, mbi falsifikimin e padëmshëm, lidhet me diçka tjetër që nuk mund të gjejë krahasim në çështjen.

xviii. Konkurimi apo jo i veprave penale në rastin konkret, nuk gjen vend për diskutim, pasi sjelljet kanë ndodhur në periudha të ndryshme kohore. Pra, veprimet kanë ndodhur në kohë të ndryshme, kanë cënuar marrëdhënie të ndryshme juridike dhe konkurojnë më së miri me njëra-tjetrën.

xix. Neni 24 i ligjit flet për thirrjen e subjektit për të dhënë shpjegime dhe nuk mund të justifikojë pasqyrimin e deklarimeve të rreme të dhëna me vullnet të lirë në një dokument, siç është deklarata e pasurive.

xx. Në lidhje arsyetimin në vendimin nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, se neni 257/a/2 i Kodit Penal ka si qëllim fshehjen e pasurisë së paligjshme, legjislatori nuk kërkon detyrimisht një qëllim të caktuar për ta kualifikuar si vepër penale. Vepra ka motive dhe qëllime, sikurse çdo vepër, ndaj dhe vepra është konsumuar, pasi nuk ka dashur të zbulohet që ka qenë pjesëmarrëse në një sërë veprimesh falsifikuese, transaksione mashtruese. Për këtë arsye iu është përmbajtur dokumentave të falsifikuara, kur ka bërë deklarin dhe këtë fakt e ka pranuar dhe vetë.

xxi. Edhe në veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, legjislatori nuk ka përcaktuar qëllimin, por qëllimi ka qenë vullneti i të pandehurës për t'i qëndruar besnike akteve të falsifikuara, me qëllim që të mos diktohej se çfarë kishte ndodhur në realitet.

xxii. Në përfundim, në mbështetje të nenit 17 gërma “ë”, 427, 428 gërmat “b”, “ç” të K.Pr.Penale, prokurorja e posaçme kërkon: **1.** Ndryshimi i vendimit nr.315, datë 17.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke u pranuar kërkesa e prokurorit me objekt: Përrjashtimi i gjyqtarit Erjon Bani, dhe në respektim të nenit 428 gërma “ç” kërkohet prishja e vendimit 16.09.2022 dhe kthimi për rigjykim i çështjes. **2.** Në rast të mospranimit të pikës 1, ndër shkaqet e ankimit, në respektim të nenit 428, pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale, kërkohet ndryshimi i vendimit nr.48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, duke vendosur përfundimisht deklarin fajtores të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i Kodit Penal, duke e dënuar me 1 (një) vit burgim; deklarin fajtores të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprës penale të “Refuzimi për deklarin, mosdeklari, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin”, parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i K.Penal, duke e dënuar me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim; në aplikim të nenit 55 të K.Penal, bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim; në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 nga masa e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 1 (një) vit burgim; në zbatim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe venien në provë për një afat prej 2 (dy) vitesh, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

11. Kundër vendimit është depozituar *apel kundërshtues nga e pandehura E.Ç.*, depozituar në kryesekretarinë e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me nr.451 ankimi, datë 06.10.2022. Konkretisht, parashtrohet se:

i. Në ngritjen e pretendimeve se gjyqtari gjendet në kushtet e ekzistencës së “konfliktit në dukje të interesit”, i cili klasifikohet si një “shkak tjetër i rëndësishëm njëanshmërie” i përcaktuar në pikën “ë” të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, barra e provës i takon prokurorisë që ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, e cila duhet të bindë gjyqtarin që do të shqyrtojë kërkesën që ekzistojnë rrethanat objektive dhe subjektive që çojnë në perceptimin e njëanshmërisë së gjykatës. Në rastin konkret mungon prova për perceptimin e publikut në lidhje me “konfliktin në dukje të interesit” dhe e gjitha është një aludim që publiku e percepton situatën si një “konflikt në dukje të interesit”.

ii. Për aq kohë sa “konflikti në dukje të interesit” nuk është aktual si një interes të caktuar ndaj të pandehurës në gjykim, kjo mungesë aktualiteti është provë që anon nga arsyetimi që publiku nuk do

ta perceptonte situatën si një “konflikt në dukje interesi”, duke qenë i mësuar tashmë që situata të tilla të ngjashme ndodhin vazhdimisht në jetën e përditshme si psh, në rastin kur para gjykatës shkon një pedagog i Fakultetit të Drejtësisë apo i Shkollës së Magjistraturës, një koleg tjetër gjyqtar apo ish-gjyqtar.

iii. Në lidhje me këtë pjesë të ankimit të prokurorisë ndaj vendimit nr.315, datë 17.07.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i qëndrohet plotësisht qëndrimit që ka mbajtur të dy gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që kanë shqyrtuar si kërkesën për dorëheqje të gjyqtarit z.Erjon Bani (kryetari i gjykatës), ashtu dhe kërkesën e prokurorisë për përjashtim të gjyqtarit të çështjes.

iv. Në lidhje me ankimin e paraqitur nga prokurori kundër vendimit përfundimtar, atij me nr.48, datë 16.09.2022, lidhur me çështjen e ekzistencës së kontratave që cilësohen si: “fiktive, të simuluar për të fshehur dhurimin” në aspektin civil, apo e ekzistencës së kontratave që cilësohen si “falsifikim”, në aspektin penal, e cila trajtohet në disa pjesë të ankimit, e pandehura dhe mbrojtja i qëndron plotësisht arsytimit të drejtë të gjykatës në lidhje me këtë çështje.

v. Në rastin konkret, në ngritjen e një akuze për “përdorim të dokumenteve të falsifikuara” prokurori i çështjes është në pamundësi të konfirmimit paraprak nga gjykata që dokumenti është i falsifikuar dhe e gjitha ngelet në rangun e një pretendimi. Prandaj, ka shumë logjikë që çështja në fjalë është një çështje tërësisht në aspektin civil.

vi. Sipas të pandehurës dhe mbrojtjes, diferenca kryesore ndërmjet kontratave fiktive dhe/apo të simuluar në aspektin civil për të fshehur dhurimin dhe ndërmjet kontratave të falsifikuara, qëndron, pikërisht, tek qëllimi në raport me veprimet/mosveprimet dhe në raport me pasojën e këtyre veprimeve/mosveprimeve. Në kushtet kur prokurorja e çështjes refuzon në mënyrë kategorike që të njohë rëndësinë që ka qëllimi si element i anës subjektive të figurës së veprës penale të falsifikimit, është e natyrshme që e pandehura dhe organi i akuzës të kenë qëndrime diametralisht të kundërta, si për sa i përket fajësisë apo pafajësisë, ashtu dhe për sa i përket veprimeve me karakter civil dhe atyre penal. Gjithsesi, kjo çështje është zgjidhur nga praktika gjyqësore dhe në lidhje me këtë e pandehura i qëndron tërësisht jo vetëm arsytimit të Gjykatës, por edhe asaj ç’ka është paraqitur në pretendimet përfundimtare të datës 12.09.2022.

vii. Organi i akuzës, sipas të pandehurës dhe mbrojtjes, është shumë konfuz lidhur me çështjen e arsyes se përse është sjellë në gjykim e pandehura, për falsifikim apo për përdorim të dokumenteve të falsifikuara. Në mënyrë të qëllimshme ose jo, duket sikur thelbi i shkeljes dhe i akuzës është “falsifikimi” i ndodhur në vitin 2006, dijenia e znj.E.Ç. në lidhje me këtë falsifikim, bashkëpunimi i saj me familjarët dhe noteren, si dhe përgjegjësia e saj për nënshkrimin e këtyre akteve. Akuza për përdorim në vitin 2017 të një dokumenti të falsifikuar është dukshëm inferiore në raport me trajtimin e zgjeruar, superior dhe të stërpërsëritur që i bëhet akuzës për falsifikim në vitin 2006, për të cilën (gjithsesi) si përfundim nuk mund të kërkohej asgjë, për aq kohë sa një fakt i tillë edhe sikur të ketë ndodhur, është parashkruar.

viii. Nëse do të kishim një ndarje normale të periudhave dhe të akuzave konkrete, çdo gjë që ka ndodhur në vitin 2006 (në bashkëpunim apo jo; me ndryshime datash apo jo; me ndryshime vlerash në kontrata apo jo; me aplikim në ASHK apo jo; etj) e provuar apo jo, nuk ka asnjë rëndësi në rastin konkret për ngritjen e ndonjë akuze për sa i përket “falsifikimit të ndonjë dokumenti”, pasi tashmë çdo gjë është parashkruar. Ajo që ka rëndësi është analiza e ngjarjeve të ndodhura në vitin 2017 dhe fakti, nëse kemi apo jo të gjithë elementët e figurës së “përdorimit të një dokumenti të falsifikuar”.

ix. Tentativa për t’i mëshuar fort bashkëpunimit ndërmjet të pandehurës, familjarëve të saj dhe noteres, është një akuzë apo pretendim i ri që nuk shfaqet as në vendimin për marrjen e personit të

pandehur dhe njoftimin e akuzës, dhe as në kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq. Ky fakt përmendet në faqen e fundit të konkluzioneve përfundimtare, ku shfaqet si element i rrezikshmërisë së falsifikimit, një akuzë e cila nuk mund të ngrihet, pasi vepra, edhe sikur të ketë ndodhur, është parashkruar.

x. Ndryshimi i datës, ngatërrimi i fletëve të dy kontratave nga noteri, aplikimi në ASHK, korrigjimet në regjistrin e noterit nga noteri etj, implikojnë noterin, por jo znj.E.Ç. dhe familjarët e saj. Ndërkohë, në lidhje me këtë bashkëpunim kërkohen prova se ai ka ndodhur për të gjitha elementët e pretenduar të falsifikimit dhe, njëkohësisht, sërish ekziston një pikëpyetje e madhe se përse bëhet gjithë ky investim i madh në arsyetim dhe në analizë për një fakt që edhe sikur të ketë ndodhur, është parashkruar.

xi. Në lidhje me nënshkrimin apo jo të kontratave në të njëjtën ditë, me të njëjtat ekstremite, por me çmim të ndryshëm, të cilat (sipas prokurores) janë bërë në distancë kohore dhe vetëm pasi doli raporti i Bankës, sqarohet që puna për nxjerrjen e raportit të Bankës ka nisur para datës 06.09.2006, duke parë rolin që ka patur Banka, periudhën që ka zgjatur gjithë procesi nën mbikëqyrjen e Bankës, nuk ka asnjë provë që të vërtetojë pretendimin që kontratat nuk janë firmosur në të njëjtën ditë. Në këtë aspekt arsyetimi i Gjykatës është mëse i plotë dhe i saktë.

xii. Paraqiten kundërshtime në lidhje me çështjen e dashjes si element i figurës së veprës penale të nenit 186 dhe 257/a të Kodit Penal, pasi prokuroria nuk ka arritur (madje nuk ka tentuar) që të bindë gjykatën, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm që nga ana e të pandehurës është konsumuar edhe elementi i dashjes. *Dashja*, si element, ekziston për të dyja këto figura të veprave penale (pranuar kjo nga praktika gjyqësore). Automatikisht bien të dyja akuzat e bëra ndaj të pandehurës. Në lidhje me këtë çështje, i qëndrohet totalisht arsyetimit të Gjykatës dhe pretendimeve përfundimtare të të pandehurës, ku sqarohet mjaft qartë dhe praktika gjyqësore (tashmë) e konsoliduar në këtë drejtim.

xiii. Në lidhje me çështjen e pretendimeve të Prokurorisë së Posaçme që Gjykata ka konkluduar në vendim në ekzistencën e fakteve që nuk rezultojnë në ndonjë akt të dosjes⁴ dhe Gjykata që vetë ka renditur aktet e dorëzuara nga e pandehura, nuk citon ndonjë kontratë qiraje, sipas të pandehurës, faktet e pretenduara nga prokurorja si të parezultuara nga aktet e dosjes, rezultojnë në procesverbalin e prokurorisë të datës 19.04.2022, atë të marrjes në pyetje të nënës së të pandehurës.

xvi. Në lidhje me konkureshmërinë e veprave penale të parashikuara nga neni 186 dhe 257/a i Kodit Penal, e pandehura dhe mbrojtja i qëndron totalisht arsyetimit të përdorur nga Gjykata dhe arsyetimit në pretendimet përfundimtare.

xv. Sipas të pandehurës, analizimi siç duhet i faktit, nëse deklarata dhe dokumentacioni tjetër plotësues që i bashkëlidhen asaj për një vit të caktuar kalendarik, përbëjnë apo jo një dokument të vetëm total mbi të cilin në tërësinë e tij, çon automatikisht në konkluzionin që, si datë e fillimit të gjykimit, nëse kemi apo jo deklaram të rremë apo fshehje, është data 02.10.2017 (data fundore e plotësimit të plotë të deklaratës së një viti) dhe jo data 17.07.2017 (data kur filloi deklarimi).

xii. Në përfundim, duke i konsideruar, si vendimin nr.315, datë 17.07.2022 ashtu dhe vendimin nr.48, datë 16.09.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si vendime të drejta, të mbështetura në prova dhe në ligj, kërkohet nga Gjykata e Posaçme e Apelit, lënia në fuqi e tyre.

III. Rrethanat e faktit dhe provat, faktet penale atribuar të pandehurës E.Ç.

⁴ Ndodhur në faqen 26 të ankimit ku prokurorja e çështjes pretendon që Gjykata ka konkluduar që e pandehura në vitin 2006, ishte e martuar me një fëmijë 1 vjeç dhe jetonte në Tiranë me qera, ndërkohë që ky fakt nuk rezultoi nga ndonjë akt i dosjes (referim nga apeli kundërshtues).

12. Së pari, sikurse u pasqyrua edhe më lart (në paragrafin 9.1 të këtij vendimi), arsyetuar më hollësisht për sa iu përket kufijve të shqyrtimit gjyqësor në apel në pjesën “Vlerësimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit”, Gjykata e Posaçme e Apelit përsëriti shqyrtimin gjyqësor në këtë juridiksion duke marrë të njëjtat prova mbi të cilat gjatë gjykimit në shkallë të parë ishte proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar. Në vijim, pasqyrohen provat e marra dhe faktet e rezultuara prej tyre.

13. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e ka regjistruar procedimin penal nr.202, datë 13.07.2021, në ngarkim të të pandehurës E.Ç., për kryerjen e veprave penale “Falsifikim i dokumentave”, në formën e përdorimit, si dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 257/a/2 të Kodit Penal, referuar në kallzimin e paraqitur me Nr.593 Prot, datë 28.06.2021 të SH.A.A.SH. (nr.211 kallzimi, datë 30.06.2021).

13.1. Kallzuesi ka parashtruar se shtetasja E.Ç. është emëruar më datë 17.06.2017 nga Kuvendi, si Komisionere pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK). Në përmbushje të detyrimit për deklarimin e pasurisë pranë ILDKPI-së, kjo shtetase ka depozituar “*Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës*” me datë dorëzimi 17.07.2017. Referuar kësaj të fundit, kallzuesit i krijohet dyshime të forta mbi burimin e pajustificuar të krijimit të pasurive të deklaruara. Sipas kallzuesit, në vitin 2006, pa përfshirë shpenzimet për jetesë, pushime, mobilime, udhëtime etj, kjo shtetase ka kryer shpenzime në vlerën prej 3,000,000 lekë dhe 42,864 USD. Ndërkohë, referuar CV-së së saj, kjo shtetase ka nisur karrierën në vitin 2001 si ndihmëse në një zyrë avokatie pa emër dhe nuk ka deklaruar se sa ka qenë paga e saj dhe, nëse janë paguar detyrimet tatimore. Në vitin 2009 ka punuar pranë subjektit “{...}” si këshilltare ligjore dhe nuk ka deklaruar pagën dhe taksat. Kallzuesi pretendon, gjithashtu, se kjo shtetase ka deklaruar blerjen e një toke arë me sipërfaqe 3440 m² në vlerën 50 000 euro, ndërkohë që sipas kontratës së shitjes me Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, kjo pasuri rezulton e blerë në vlerën prej 300,000 lekë. Po vlera prej 300 000 lekësh është shënuar në kartelën e pasurisë pranë ish-ZRPP-së.

13.2. Kjo shtetase ka deklaruar se ka blerë edhe tokën me sipërfaqe 1450 m² të llojit arë me vlerë 300,000 lekë, ndërkohë që, nëse merret i mirëqenë çmimi prej 300,000 lekë sipas kontratave për të dyja pronat, nuk ka mundësi që referuar sipërfaqeve të ndryshme, të kenë çmime të njëjta. Sipas kësaj logjike, i bie që sipërfaqja e tokës arë prej 1450 m² është blerë në vleftën prej 207 lekë/ m², ndërkohë që sipërfaqe prej 3440 m² është blerë në vleftën prej 2,035 lekë/ m². Pra, parcelat, megjithëse janë blerë në të njëjtën ditë, ndodhen në të njëjtin vend, janë blerë me një diferencë çmimesh për m², sa dhjetëfishi. Sipas kallzuesit, nënshkrimi i një kontrate, me çmim qindrafish më të ulët, janë përdorur si mekanizëm për t’iu shmangur pagesave e detyrimeve në përqindje të caktuar (jo 15 % në favor të buxhetit të organeve tatimore) sipas ligjit.

13.3. Kjo shtetase ka deklaruar se tokën e ka blerë nëpërmjet kredisë, e cila rezulton të jetë marrë më datë 29.09.2006, ndërkohë që toka është blerë më datë {...}, pra, dy muaj pas disbursimit të kredisë. Referuar të njëjtës deklaratë, kallzuesi ngre pretendime në lidhje me vlerën e apartamentit. Kallzuesi parashtron se në vitin 2006, kjo shtetase deklaroi se ka blerë apartament banimi me sipërfaqe 70.80 m² në vlerën 42,864 USD, me një çmim disa herë më të ulët se sa duhet të ishte vlera e tij, pasur parasysh se ndodhet në qendër të Tiranës. Si burim ka deklaruar pagat e saj dhe të bashkëshortit. Kjo pasuri, dukshëm konstatohet se, megjithëse ndodhet në qendër të Tiranës, është blerë në një çmim preferencial dhe më pak se sa toka e ndodhur në Kavajë.

14. Rezulton se e pandehura E.Ç., me vendimin Nr.82/2017, datë 17.06.2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", është zgjedhur në institucionet e rivlerësimit si komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK). Ndodhur në këto kushte, në zbatim të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë", i ndryshuar, e pandehura E.Ç., provat dokument të marra pranë ILDKPKI-së tregojnë se më datën 17.07.2017 ajo ka dorëzuar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës. Në këtë deklaratë pasurie, e pandehura E.Ç. ka deklaruar *pasuritë* si më poshtë vijon:

- i.** Apartament banimi me sipërfaqe 70.80 m², "{...}", {...}. Kontratë shitje datë 30.11.2016 me vlerë 42,864 USD. Vlera e paguar në bazë të kontratës së sipërmarrjes me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga. Pronësia 50 %.
- ii.** Kuota në Fondin e Investimeve {...}, blerë më: 01.10.2012 me vlerë transksioni 1 200 000 lekë; 15.03.2013 me vlerë transaksioni 400 000 lekë; 13.12.2013 me vlerë transaksioni 1 200 000 lekë; 12.02.2015 me vlerë transaksioni 600 000 lekë; 16.06.2015 me vlerë transaksioni 1 000 000 lekë; 30.06.2016 me vlerë transaksioni 1 500 000 lekë. Totali i blerjeve 5 900 000 lekë, çmimi i kuotës 1 418.0836 lekë. Numri i kuotave 4 979.4118 lekë. Burimi i krijimit: Nga {...}Pronësia 100%.
- iii.** Llogari bankare page në lekë pranë Raiffeisen Bank dhe gjendje më datë 17.06.2017 në vlerën 975 573.12 lekë. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e pagës si Drejtoreshë Ligjore pranë shoqërisë {...}Pronësia 100%.
- iv.** Llogari bankare në euro pranë Raiffeisen Bank dhe gjendje më datë 17.06.2017 me vlerë 0 (zero). Burimi i krijimit: Nga të ardhurat e pagës si Drejtoreshë Ligjore pranë shoqërisë {...}Pronësia 100%.
- v.** Tokë arë me sipërfaqe 1450 m² në adresë Rreth Greth Kavajë, blerë më datë {...}, në vlerën 300,000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga. Pronësia 100%.
- vi.** Tokë arë me sipërfaqe 3440 m² me adresë fshati {...}, blerë më datë {...}. Burimi i krijimit: Kredi nga {...} ({...}) ish Banka {...} - Shqiperi sh.a. në shumën prej 35,000 euro dhe të ardhura nga paga 15,000 euro si Drejtoreshë Ligjore pranë "{...}". Pronësia 100%.
- vii.** Autoveturë e tipit Benz 203, prodhim i vitit 2000, me targa {...}, blerë më datë 23.04.2012, në vlerën 1 000 000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga. Pronësia 50%.
- viii.** Autoveturë e tipit Benz, 4+1, tipi 124 (200D) prodhim i vitit 1985, me targa {...}, blerë më datë 04.07.2005, në vlerën 250 000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga. Pronësia 50%.
- ix.** Llogari bankare në euro, pranë {...} dhe gjendje më datë 17.06.2017 në vlerën 688.12 euro. Burimi i krijimit: Llogari për pagesë kredie me të ardhurat e pagës. Pronësia 100%.
- x.** Llogari bankare në lekë pranë {...} dhe gjendje më datë 17.06.2017 në vlerën 0.40 lekë. Burimi i krijimit: Paga. Pronësia 100%.
- xi.** Llogari bankare në lekë pranë {...} dhe gjendje deri më datë 17.06.2017, në vlerën 1,116.99 lekë. Burimi i krijimit: Bashkëshorti D.Ç..
- xii.** Llogari bankare në lekë pranë {...} dhe gjendje deri më datë 17.06.2017 në vlerën 80,304 lekë. Burimi i krijimit: Bashkëshorti D.Ç..
- xiii.** Llogari bankare në lekë pranë {...} dhe gjendje deri më datë 17.06.2017 në vlerën 5,628.88 lekë. Burimi i krijimit: Bashkëshorti D.Ç..

14.1. Lidhur me përkrahimin *e të ardhurave* të tij në këtë deklaratë që përfshinë periudhën nga data 1 Janar deri në ditën e fillimit të punës së vitit të deklaramit, e pandehura E.Ç., ka deklaruar:

- i. Drejtoresh Ligjore pranë Shoqërisë {...}- 17.06.2017. Vlera e të ardhurave 2,947,226 (dy milion e nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë.
- ii. Të ardhura/rimbursim nga siguracioni privat. Vlera e të ardhura 117,330 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë.
- iii. Të ardhurat të pritshme nga paga pas datës 17.06.2017. Vlera e të ardhurave 1,640,707 (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë e shtatëqind e shtatë) lekë.
- iv. Të ardhurat nga paga. Bashkëshorti D.Ç. oficer pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Personaliteteve të Larta, Garda e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Brendshme. Vlera e të ardhurave 372,903 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tre) lekë.

14.2. Lidhur me përkrahimin *e detyrimeve* të saj, e pandehura E.Ç. në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës ka deklaruar si më poshtë vijon:

1. Kredi për blerje tokë arë, me sipërfaqe 3440 m² tek {...} (ish Banka {...} - Shqipëri sh.a.) më datë 29.09.2006 në shumën 35 000 euro me afat 20 vjet. Gjendja më datë 17.06.2017 është në shumën 16 699.30 euro. Shlyerja ka filluar një muaj nga tërheqja e shumës së kredisë, 29.09.2006 dhe përfundon më datë 29.09.2026 me interes, me këst mujor 215 euro. Ka deklaruar se deri në datën e deklaramit ka shlyer 16 699.30 euro.

15. Bazuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (nën titullin “Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime”) Inspektoriat i Lartë i Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i është drejtuar shtetases E.Ç., Komisionere pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me shkresën Nr.3058/28 Prot, datë 31.08.2017, me lëndë: “*Ftesë për t’u paraqitur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me deklaramin e interesave private*”. Konkretisht, kjo strukturë i është drejtuar si më poshtë: “*Inspektorati i Lartë i Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në Nenin 3, të Ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, ka në proces kontrolli të plotë deklaramin tuaj të interesave private, Para Fillimit të Detyrës 2017, të dorëzuar në dt.17.7.2017. Për të dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me problemet e dala gjatë kontrollit të plotë, bazuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9049 datë 10.4.2003 Në rast mosparaqitje, Inspektorati i Lartë do të vazhdojë kontrollin dhe marrjen e masave penale, administrative e disiplinore në mungesën tuaj*”.

15.1. Më datë **18.09.2017** është mbajtur procesverbali “*Mbi shpjegimet e subjektit deklarues*” midis të pandehurës E.Ç. dhe Inspektorit të Inspektoriatin e Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ku të pandehurës i janë bërë tetë pyetje. Në procesverbal në përfundim thuhet se: “*Subjekti u njoh me problematikën e sipërcituar dhe në dt.02.10.2017 do të paraqitet për të dhënë sqarime duke dorëzuar dhe dokumentacionin justifikues përkatës*”.

15.2. Më datë **02.10.2017** është mbajtur procesverbali “*Mbi shpjegimet e subjektit deklarues*” midis të pandehurës E.Ç. dhe Inspektorit të Inspektoriatin e Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga ku citohet:

Subjektit iu shpjeguan arsyet e thirrjes së saj për të dhënë shpjegime dhe u paralajmërua për përgjegjësinë që ka në bazë të nenit 38, të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në rast deklarimi të rremë. Subjekti, pasi u njoh me problematikën e konstatuar në deklaratat e saj të Interesave Private në Proces-Verbalin e dt.18.9.2017, sot, sqaroi si më poshtë:

Pyetje nr. 1: Në deklarin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Apartament banimi, me sip.70.80 m², Rruga e Dibrës, në Tiranë. Kontratë Shitje datë 30.11.2016 me vlerë 42 864 USD. (Vlera paguar në bazë të Kontratës së sipërmarrjes me nr.{...} Rep, nr. {...} Kol, datë {...}). Burimi te ardhura nga paga. Zotëron 50% me bashkëshortin. Paraqisni dokumentacion vërtetues në lidhje me këtë aset. Sqaroni lidhur me burimin e krijimit të këtij aseti në vitin 2006 në vlerën 42 864USD, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues. (DPPPP konfirmon se ju pagesën në dt.30.11.2006 e keni kryer për këtë apartament në shumën 42 864 euro dhe jo në USD). Sa kanë qenë shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti?

Përgjigje nr.1: Unë po dorëzoj Çertifikatën e Pronësisë, me nr. {...} lëshuar dt. {...} + Kontratën e Shitblerjes me nr. {...} Rep dhe nr. {...} Kol, dt. {...}. Gjithashtu, po dorëzoj dhe Kontratën e Sipërmarrjes të dt. {...} + Zgjidhje Kontrate e dt. {...} që konfirmon se me firmën "{...}" marrëveshja ishte kryer me familjen "K." dhe ne u lidhem pas kësaj Kontrate Zgjidhje me firmën "{...}". Pagesën ia kemi kryer familjes "K." në vlerën 42,864 USD dhe me firmën "{...}" ne s'kemi kryer transaksione. Me firmën "{...}" shpk Kontratën e Shitblerjes e kemi lidhur përfundimisht në 2016 dhe atëherë firma e ka deklaruar si pagesë meqenëse është lidhur në noteri kjo kontratë në dt.30.11.2016. Deklaroj me përgjegjësi të plotë që pagesa është kryer në 2006 dhe jashtë zyrës. Pagesa është kryer në USD dhe nuk e di pse është deklaruar në euro nga firma. Këtë e konfirmojnë Kontratat që sapo dorëzova. Ne kemi hyrë për të banuar në vitin 2006 dhe pagesat për mobilim kanë shkuar në shumën rreth 5 000 Euro. Burimi i pagesës ka qenë me kredinë e marrë në {...} Bank në dt.29.09.2006 në vlerën 35 000 Euro. Kjo shumë mbuloi dhe blerjen në vlerën 42 864 USD dhe shpenzimet e mobilimit. Në Kontratën me bankën, meqenëse firma "{...}" ende nuk e kishte të regjistruar në ZVRPP këtë pallat që po ndërtonte, unë nuk mund të merrja kredi me kolateral apartamentin dhe për këtë arsye vura si qëllim marrje kredi dhe kolateral, blerjen e një toke me sipërfaqe 3 440 m² në {...}. Kjo tokë u vlerësua nga ekspertët e Bankës në vlerën 50 000 euro. Në fakt, këtë tokë unë nuk kisha nevojë ta bleja, sepse ishte tokë në pronësi të babait tim, i cili e kishte përfutuar me ligjin nr.7501. Po dorëzoj Kontratën e Huasë me {...} Bank të dt.29.09.2006 + Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi të dt.15.09.1995 + Vërtetim i dt.29.6.2006 lëshuar nga Komuna {...} që konfirmon se babai im R.K. ka në zotërim sipërfaqe 3440m² në ZK {...} + Çertifikatën për Vërtetim Pronësie e dt.21.06.2006 që konfirmon regjistrimin e tokës me sip. 3 440 m² Arw në {...} ne emër të babait tim R.K..

Pyetje nr. 2: Në deklarin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Arë me sipërfaqe 1 450 m², me adresë {...}, blerë me datë {...} në vlerën 300 000 lekë, të ardhura nga paga dhe Arë me sip. 3 440 m², me adresë {...}, blerë më datë {...} në vlerën 50 000 Euro me burim kredi nga {...}, në shumën prej 35 000 Euro dhe 15 000 Euro të ardhura nga paga. Paraqisni dokumentacion vërtetues në lidhje me këto asete. Sqaroni lidhur me burimin e krijimit të këtyre aseteve (kredi dhe paga) në vlerat 300 000 leke dhe 50 000 Euro, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues (vetëm në 2006 ju keni krijuar asete, në vlerën totale 10,527,717 leke, konvertuar në all me kursin e vitit). Sqaroni pse keni deklaruar që toka në {...} me sip. 3 440 m² është blerë në masën 35 000 Euro nga kredia e marre ne {...}, kur kjo bankë, në përgjigjen e dt. 8.8.2017, na konfirmon se kredia 35 000 Euro është marre në dt.29.09.2006 për blerje apartamenti.

Përgjigje nr. 2: Për sipërfaqen e tokës 3 440 m² e sqarova me lart kur shpjegova qëllimin e marrjes së kredisë në {...} Bank. Pra, kjo tokë ishte e babait tim dhe që te vihej Kolateral duhej të bëhej një

Kontrate Shitblerje në emër tim si Blerës që pastaj ta përdorja si Kolateral për marrjen e kredisë. Pra, kjo tokë nuk është blere realisht nga unë, sepse kredia është marrë për apartamentin. Dhe toka e II-të me sipërfaqe 1 450 m² nuk është blerë, por që të regjistrohej në emrin tim duhet të lidhja një Kontratë Shitblerje me tim ate që ishte pronar i kësaj toke. Dhe për këtë tokë nuk kam paguar asgjë. Babai im e ka përfituar këtë tokë njësoj si Tokën e I, nga ligji nr.7501. Po dorëzoj Kontratën e Shitblerjes të dt.{...} për blerje të tokës Arë me sip. 3 440 m² + Kontratë Shitblerje të dt.10.7.2006 që konfirmon blerjen nga unë të tokës me sip. 1 450 m² (dhe për këtë blerje nuk kam kryer pagesë) + Çertifikatën e Pronësisë për tokë me sip. 1 450 m² në emër të babait tim R.K. + Vërtetim i dt.29.6.2006 lëshuar nga Komuna {...} që konfirmon që babai im R.K. ka në zotërim sip. 1 450 m² në ZK {...}. E gjithë sipërfaqja që u regjistrua në emrin tim ishte në respekt të ligjit 7501, që çdo pjesëtar i familjes bujqësore të merrte 5 000 m² nga toka në pronësi dhe regjistrimi në emrin tim mund të kryhej vetëm nëse kryetari i familjes bujqësore i shiste këto toka me Kontrata Shitblerje (sic vepruam ne). Po dorëzoj dy Çertifikatat e Pronësisë të tokave të shpjeguara më lart që tashmë janë të regjistruara në emrin tim.

Pyetje nr. 3: Në deklarin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Kuota në Fondin e Investimeve {...}. Blerë më: - datë 1.10.2012 me vlerë transaksioni 1 200 000 lekë; - datë 15.3.2013 me vlerë transaksioni 400 000 lekë; - datë 13.12.2013 me vlerë transaksioni 1200000 lekë; - datë 12.2.2015 me vlerë transaksioni 600 000 lekë; - datë 16.6.2015 me vlerë transaksioni 1 000 000 lekë; - datë 30.6.2016 me vlerë transaksioni 1 500 000 lekë. Totali i blerjes: 5 900 000 lekë. {...} me përgjigjen e dt.4.8.2017 konfirmon deklarin tuaj. Sqaroni në mënyrë të detajuar, lidhur me burimin e krijimit të këtij investimi, për vitet 2012, 2013, 2015 dhe 2016, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues.

Përgjigje nr. 3: Ky investim në Fondin e Investimeve në RP është kryer vetëm me burim pagën time në çdo vit. Për këtë po dorëzoj dhe Vërtetim të lëshuar nga {...} sh.a. në dt.2.10.2017 dhe gjithashtu po dorëzoj dhe statement të RZB që konfirmon derdhjen e pagës në favorin tim dhe pastaj kalimin në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj...[...]

16. E pandehura E.Ç. në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, gjatë hetimit ka depozituar dokumentacionin si më poshtë vijon:

16.1. Kontratë sipërmarrje datë 21.08.2003 më palë: **Investitor:** Shoqëria “{...}” sh.p.k dhe **Porositës:** R.K. Sipas kësaj kontrate sipërmarrësi Shoqëria “{...}” sh.p.k marrë përsipër që të ndërtojë për porositësin një apartament me sipërfaqe 75.2 m² së bashku me ambientet e përbashkëta, e përbërë nga një dhomë dhe një guzhinë, pallati {...}, kati i tetë i banimit. Çmimi i shitjes së apartamentit është 42. 864 USD (dyzetë e dymijë e tetëqind dollarë). Sipas kësaj kontrate kësti i parë në shumën 12.800 dollarë është paguar jashtë zyrës noteriale. Kësti i dytë në shumën 12.800 USD do të paguhet brenda muajit dhjetor 2003. Kësti i tretë në shumën 12.800 USD do të paguhet në 30 maj 2004, ndërsa kësti i katërt në shumën 4464 USD do të paguhet me marrjen e çelësave.

16.2. Zgjidhje e kontratës datë 08.09.2006 midis palëve: Shoqëria “{...}” sh.p.k dhe: 1. M.K.; 2. M.Xh.; 3. V.H.; 4. M.M. dhe 5. I.K., në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit R.K.. Sipas këtij veprimi juridik zgjidhet Kontrata e Sipërmarrjes datë 21.08.2003 me palë: **Investitor:** Shoqëria “{...}” sh.p.k dhe **Porositës:** R.K., për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe 75.2 m² në vlerën 42.864 USD (dyzetë e dymijë e tetëqind dollarë), e cila është likuaduar tërësisht. Në këtë dokument thuhet se palët me marrëveshje e zgjidhin këtë kontratë, pasi trashëgimtarët e R.K.t ia kalojnë këtë apartament z.D.Ç. dhe znj.E.Ç., si dhe deklarojnë se shoqëria “{...}” sh.p.k ka të drejtë që të lidhë një kontratë të re sipërmarrje me porositës D.Ç. dhe E.Ç. me shumë të likuaduar.

16.3. Kontratë Sipërmarrje me Nr.3728 Rep, Nr.2052/1 Kol, datë 08.09.2006, me palë: **Investitor:** Shoqëria “{...}” sh.p.k dhe **Porositës:** 1. E.Ç. dhe 2. D.Ç.. Sipas kësaj kontrate sipërmarrësi Shoqëria “{...}” sh.p.k merr përsipër që të ndërtojë për porositësin një apartament me sipërfaqe 75.2 m² së bashku me ambientet e përbashkëta, e përbërë nga një dhomë dhe një guzhinë, pallati D1, kati i tetë i banimit. Çmimi i shitjes së apartamentit është 42.864 USD (dyzetë e dymijë e tetëqind dollarë), shumë e cila është likuaduar jashtë zyrës noteriale.

16.4. Kontratë Shitblerje me Nr.{...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, me palë: **Shitëse:** Shoqëria “{...}” sh.p.k dhe **Blerës:** 1. E.Ç. dhe 2. D.Ç.. Objekti është blerja e apartamentit objekt i Kontratës së Sipërmarrjes me Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}. Sipas Çertifikatës së Pronësisë me Nr. {...}, datë {...} dhe kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet kontratës së shitjes rezulton se apartamenti objekt i këtyre kontratave është regjistruar në favor të Shoqërisë “{...}” Sh.p.k pranë ZVRPP-së më datë **31.03.2010.**

16.5. Kontratë Shitblerje me Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, të lidhur përpara noteres Luljeta Kongoli, me palë: **Shitësit: R.K., S.K. dhe E.K.; Blerës: E.Ç.** Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 3440 m² në {...}, Kavajë që shitësat kanë në pronësi sipas Çertifikatës së Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Në këtë kontratë, ndër të tjera, thuhet se: *“Shitësit deklarojnë se me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ia shesin pronën me cilësitë e sipërshënuara bazuar në ligjin nr.8337, datë 30.04.1998, blerësit E.Ç. në shumën 50 000 euro (pesëdhjetë mijë euro) duke e lënë të lirë dhe të papengueshme që nga ky moment. Blerësi E.Ç. e pranon blerjen e pronës të cilën e merr, të lirë dhe të papengueshme, si dhe likuadon totalisht me lekë në dorë jashtë Zyrës që redaktohet ky akt.”* Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet: **i)** Vërtetimi i datës 29.06.2006 lëshuar nga Kryetari i Komunës {...}, ku citohet se R.K. në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë sipas ligjit nr.8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyejore, livadhe dhe kullota” nuk ka anëtarë të tjerë përveç çertifikatës familjare bashkëngjitur këtij vërtetimi; **ii)** Çertifikata familjare me kryefamiljar R.K. dhe pjesëtarë S.K. e E.K.; **iii)** Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006 së bashku me hartën treguese të regjistrimit. Sipas kartelës së pasurisë rezulton se toka objekt i kontratës së shitjes është regjistruar që prej datës 28.05.1996.

16.6. Kontratë Shitblerje me Nr.{...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, të lidhur përpara noteres Luljeta Kongoli, me palë: **Shitësit: R.K., S.K. dhe E.K.; Blerës: E.Ç.** Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 1450 m² me adresë: {...} që shitësat kanë në pronësi sipas Çertifikatës së Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Në këtë kontratë, ndër të tjera, thuhet se: *“Shitësit deklarojnë se me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ia shesin pronën me cilësitë e sipërshënuara bazuar në ligjin nr.8337, datë 30.04.1998, blerësit E.Ç. në shumën 300.000 lekë (treqind mijë lekë) duke e lënë të lirë dhe të papengueshme që nga ky moment. Blerësi E.Ç. e pranon blerjen e pronës të cilën e merr, të lirë dhe të papengueshme si dhe likuadon totalisht me lekë në dorë jashtë Zyrës që redaktohet ky akt.”* Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet: **i)** Vërtetimi i datës 29.06.2006 lëshuar nga Kryetari i Komunës {...}, ku citohet se R.K. në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë sipas ligjit nr.8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyejore, livadhe dhe kullota” nuk ka anëtarë të tjerë përveç çertifikatës familjare bashkëngjitur këtij vërtetimi; **ii)** Çertifikata familjare me kryefamiljar R.K. dhe pjesëtarë S.K. e E.K.; **iii)** Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006 së bashku me hartën treguese të regjistrimit. Sipas kartelës së pasurisë rezulton se toka objekt i kontratës së shitjes është regjistruar që prej datës 28.05.1996.

16.6.1. Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) me Nr.1128, datë 15.09.1995, ku rezulton se familjes së R.K., nga fshati {...} i jepet në pronësi gjithsej **27191 m² tokë**.

16.6.2. Çertifikatë Familjare lëshuar më datë 04.10.2021 nga Njësia Administrative {...}, ku rezulton se më datë 01.08.1991, përbërja e familjare e shtetasit R.K. ishte me pesë persona, ky i fundit, bashkëshortja S.K., si dhe fëmijët E.Ç., E.K. dhe O.K.

16.6.3. Çertifikatë Pronësie lëshuar më datë 15.09.2006, së bashku me hartën treguese të regjistrimit, ku rezulton se shtetësja E.Ç. është pronare e një sipërfaqe tokë arë 3440 m², me adresë {...}, me numër pasurie **131/54**.

16.6.4. Çertifikatë Pronësie lëshuar më datë 08.09.2006, së bashku me hartën treguese të regjistrimit, ku rezulton se shtetësja E.Ç. është pronare e një sipërfaqe tokë arë 1450 m², me adresë {...}, me numër pasurie {...}.

17. Kontratë Hipoteke me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} të lidhur përpara Noteres **Luljeta Kongoli**, me palë: BANKA “{...} - SHQIPERI” sh.a; **Hipotekuesi: E.Ç.** Në këtë kontratë, ndër të tjera, thuhet shprehimisht se: *“1.1. Objekti i kësaj Kontrate është vënia e hipotekës së shkallës së parë në favor të Bankës mbi pronën në pronësi të E.Ç., e cila është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë, Shqipëri, si me poshtë: Nr.Pasurie {...}, Volumi 4, Faqja 100, Zona Kadastrale Nr. {...}. ...1.3. Kjo Kontratë Hipotekë është pjesë përbërëse dhe e pandarë e Kontratave të kredisë që janë lidhur dhe që do të lidhen në të ardhmen ndërmjet Bankës dhe Kredimarrësit E.Ç., të treguara në pikën 1.2. më lart, deri në ripagimin e plotë dhe pa kushte të shumës se çdo kredie të kredimarrësit të mësipërm dhe të të gjitha detyrimeve sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Kontratat përkatëse të kredive. ... 2.1. Prona që hipotëkohet është një arë me sipërfaqe 3, 440 m²”*.

17.1. Kontratë Huaje me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} të lidhur përpara Noteres **Luljeta Kongoli**, me palë: **Huadhënës:** BANKA “{...} - SHQIPERI” sh.a; **Huamarrës:** E.Ç.; dhe **Dorëzanës:** D.Ç.. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet shprehimisht se: *“Banka bie dakord që t’i japë Huamarrësit një Hua në Shumën maksimale EURO 35,000. – (EURO tridhjetë e pesë mijë vetëm) “HUAJA”, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme: ...2. Të ardhurat e Huasë do të përdoren nga Huamarrësi për financimin e nevojave të tij për blerjen e një toke me sipërfaqe 3,440 m², me adresë në {...}, Kavajë, Shqipëri, në përputhje me Kontratën Nr.Rep.{...}, Nr.Kol.{...}, datë {...}, vërtetuar nga notere Luljeta KONGOLI, nënshkruar ndërmjet R.K., S.K., E.K., (Shitës) dhe E.Ç. (Bleresi). Banka ka të drejtën, po jo detyrimin të monitoroje, kontrollojë përdorimin e fondeve të huasë nga Huamarrësi. Gjithashtu, është rënë dakord që Huaja mund të përdoret për xxxx ne bazë të kërkesës dhe të udhëzimeve të Huamarrësit, me kusht që këto të përputhen me qëllimin e Huasë. Të ardhurat nga Huaja nuk do të përdoren për veprime apo transaksione që vijnë në kundërshtim me sanksionet e Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Europian ose me legjislacionin shqiptar.”*

17.2. Raport Vlerësimi “Tokë me sipërfaqe 3440 m², {...}”, datë **06 Shtator 2006** me Porositës: {...} BANK; **Pronari:** z.R.K.; dhe **Klienti:** znj.E.Ç.. Sipas këtij raporti vlera e tregut të lirë të kësaj prone është **48 000 euro**, ndërsa vlera e shitjes së detyruar ose vlera e likuidimit është **38 500 euro**.

17.3. Deklaratë Noteriale me Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...} lëshuar nga BANKA {...}, ku ndër të tjera thuhet se: *“Ndërmjet Bankës {...}-Shqiperi SHA (sot {...}) dhe Kredimarrësve E.Ç. dhe D.Ç. është lidhur Kontrata e Kredise Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, Notere Luljeta Kongoli, për sigurimin e së ciles është vendosur hipotekë ne favor te Bankes me anë të Kontraten e Hipotekes Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, Notere Luljeta Kongoli, mbi pronen e regjistruar si më poshtë: a) Prona në pronësi të Shoqëria E.Ç., e cila është regjistruar në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavaje, Shqipëri (tashme Drejtoria Vendore e ASHK Kavaje), Nr.Pasurie {...}, volumi 4, Faqe 100, Zona Kadastrale {...}, ndodhur ne {...}, Shqipëri. Me anë të kësaj deklarate kërkohet nga Drejtoria Vendore e ASHK Kavajë (ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë), Shqipëri të fshijë vetëm hipotekën e vendosur në favor të Bankës mbi pasurinë e përshkruar më sipër, me anë të Kontratës të cituar më poshtë: Kontrata e Hipotekes Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë {...}, Notere Luljeta Kongoli”*.

18. E pandehura E.Ç. ka depozituar pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

18.1. Vërtetim me Nr.188 Regj, datë 27.01.2000 të Ministrisë së Drejtësisë, ku pasqyrohet se kjo shtetase është regjistruar në regjistrin e asistentëve për avokatë në Ministrinë e Drejtësisë, diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të UT më Tiranë më datë 08.08.1999. Regjistrimi është bërë konform nenit 34 të ligjit nr.7827, datë 31.05.1994 *“Për Avokatinë në R.Sh”*, pasi mbledhja e përgjithshme e Dhomës së Avokatëve Tiranë, ka caktuar për të kryer stazhin si asistent, pranë avokatit të kësaj dhome Syrja Dosti. Stazhi fillon më dt.15.08.1999 dhe mbaron me dt.15.08.2000.

18.1.1. Sipas vërtetimit pa datë, të nënshkruar nga Av.Syrja Dosti: shtetasja E.K. ka punuar si asistente pranë këtij avokati nga muaji gusht i vitit 1999, ku vazhdon të punojë dhe aktualisht. Për sa më sipër figuron e regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë (Regjistrin e asistentëve). Ky vërtetim lëshohet për efekt testimi.

18.2. Sipas vërtetimit të muajit korrik 2006 të lëshuar nga shoqëria “{...}” sh.p.k për shtetasen E.Ç., rezulton të jetë pasqyruar se kjo shtetase është e punësuar si këshilltare juridike me kohë të pjeshme, pranë kësaj shoqërie, me pagë mujore 30,000 lekë. Ky vërtetim është lëshuar me kërkesën e të interesuarit për ta përdorur si dokument në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi.

18.3. Vërtetim Nr.10557/ Prot, datë 18.11.2020 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, ku theksohet se shtetasja E.K. për periudhën mars 2001-dhjetor 2004 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti “{...}” me nr.dosje 5365 juridike.

18.3.1. Vërtetim Nr.10557/ Prot, datë 18.11.2020 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasja E.K. për periudhën janar 2005-dhjetor 2008 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti “{...}” me nr.dosje 5365 juridike.

18.3.2. Vërtetim me Nr.1316 Prot, datë 06.10.2021 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë, ku vërtetohet se shtetësja E.Ç. (K.) me ID {...} është trajtuar me raport barrëllindje, pranë DRSSH Tiranë nga data 01.09.2005-29.08.2006 me vlerë 393145 (treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzetë e pesë) Lekë. Listëpagesat janë dorëzuar nga subjekti {...} me NIPT {...} Tiranë.

18.3.3. Vërtetim Nr.10557/ Prot, datë 18.11.2020 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasja E.K. për periudhën janar 2009-maj 2009 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti “{...}” me nr.dosje 5365 juridike.

18.4. Vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku theksohet se shtetasi D.Ç. për periudhën **01.07.2000-31.12.2002** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti Garda e Republikës.

18.4.1. Vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku theksohet se shtetasi D.Ç. për periudhën **01.01.2003-16.11.2005** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti Garda e Republikës.

18.4.2. Vërtetim Nr.9899 Prot, datë 30.09.2021 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasi D.Ç. për periudhën **maj-tetor 2005** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti **“Garda e Republikës së Shqipërisë”** me nr.dosje 276 juridike.

18.4.3. Vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku theksohet se shtetasi D.Ç. për periudhën **16.11.2005-16.11.2007** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti Garda e Republikës.

18.4.4. Vërtetim Nr.9899 Prot, datë 30.09.2021 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasi D.Ç. për periudhën **shkurt 2010-dhjetor 2012** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti **“Banka e Shqipërisë”** me nr.dosje 1 juridike.

18.4.5. Ekstrakt nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shtetasin D.Ç. që provon pagimin e kontrobuteve për periudhën dhjetor 2011-dhjetor 2016.

18.4.6. Stamentin e llogarisë bankare pranë {...}, për shtetasin D.Ç. për periudhën janar 2010-dhjetor 2014.

18.4.7. Stamentin e llogarisë bankare pranë {...}-së, për shtetasin D.Ç. për periudhën tetor 2013-dhjetor 2016.

18.5. Nga shkresa Nr.1803 Prot, datë 14.04.2022 Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me lëndë: *“Kthim përgjigje”* rezulton: *“Në vijim të shkresës tuaj nr.3018 prot, (E.M) datë 12.04.2022, ardhur dhe protokolluar më datë 13.04.2022, bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar për subjektin E.Ç.. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se ILDKPKI nuk ka marrë masa administrative për këtë subjekt.”*

19. Mbi vendimin e datës 15.07.2021 “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave” **pranë Bankës Amerikane të Investimeve sh.a** janë sekuestruar: Kontrata Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} e lidhur ndërmjet Bankës {...} sh.a dhe shtetasve E. dhe D.Ç., si dhe të gjithë praktikës përkatëse që lidhet me marrjen e huasë. Është mbajtur procesverbal “Për sekuestrimin e dokumentave” mbajtur më datë 28.07.2021, duke u sekuestruar:

19.1. Aplikim-Deklaratë për Kredi Hipotekore të bërë nga shtetasja E.Ç. më datë 16.08.2006 pranë {...} Bank.

19.2. Kontratë Shitblerje me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, të lidhur përpara noteres Luljeta Kongoli, me palë: **Shitësit:** R.K., S.K. dhe E.K.; **Blerës:** E.Ç.. Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 3440 m² në {...} që shitësat kanë në pronësi sipas çertifikatës së pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet se: *“Shitësit deklarojnë se me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ia shesin pronën me cilësitë e sipërshënuara bazuar në Ligjin 8337*

datë 30.04.1998, blerësit E.Ç. në **Shumën 50 000 euro (pesëdhjetë mijë euro)** duke e lënë të lirë dhe të papengueshme që nga ky moment. Blerësi E.Ç. e pranon blerjen e pronës, të cilën e merr të lirë dhe të papengueshme, si dhe **likujdon totalisht me lekë në dorë jashtë Zyrës që redaktohet ky akt.** Pjesë e praktikës është edhe Çertifikata e pronësisë lëshuar më datë 15.09.2006 për këtë pasuri në emër të të pandehurës E.Ç., bashkëlidhur se cilës gjendet edhe kartela e pasurisë, ku është pasqyruar shuma e paguar për blerjen e pasurinë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë.

19.3. Kontratë Hipoteke me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} të lidhur përpara Noteres Luljeta Kongoli, me palë: BANKA “{...} - SHQIPERI” sh.a; **Hipotekuesi:** E.Ç.. Pjesë e praktikës është dhe Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 15.09.2006 për këtë pasuri në emër të të pandehurës E.Ç., bashkëlidhur se cilës gjendet edhe kartela e pasurisë, ku është pasqyruar shuma e paguar për blerjen e pasurinë në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë dhe jo 50.000 euro, sikurse përmendet në kontratën e shitjes.

19.4. Kontratë Huaje me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} e lidhur përpara Noteres Luljeta Kongoli, me palë: **Huadhënës:** BANKA “{...} - SHQIPERI” sh.a; **Huamarrës:** E.Ç.; dhe **Dorëzanës:** D.Ç., si dhe praktika që shoqëron atë ku përfshihet dhe siguracioni shëndetësor. Më konkretisht, si më poshtë:

19.5. Vërtetim i datës 12.06.2006 lëshuar nga Garda e Republikës nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi D.Ç. është efektiv i Gardës së Republikës me pagë 36.300 (tridhjetë e gjashtë mijë e treqind) lekë.

19.6. Vërtetim i lëshuar qershor 2006 nga kompania “{...}”, ku vërtetohet se shtetasja E.Ç. punon me profilin si juriste në kompani nga periudha mars 2021 dhe në vazhdim, me pagë mujore 80,000 (tetëdhjetë mijë) lekë. Kjo provohet dhe me Kontratën Individuale të Punës e lidhur më datë 01.03.2001.

19.7. Vërtetim i muajit korrik 2006 të lëshuar nga shoqëria “{...}” sh.p.k. për shtetasen E.Ç., sipas të cilit kjo shtetase është e punësuar si këshilltare juridike me kohë të pjesshme, pranë kësaj shoqërie, me pagë mujore 30,000 lekë.

19.8. Njoftim për shlyrjen totale të parakohshme të kredisë depozituar nga shtetësja E.Ç. më datë 04.03.2020 pranë Bankës Amerikane të Investimeve.

19.9. Deklaratë Noteriale “Për fshirje hipoteke” me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} lëshuar nga {...}SH.A, për heqjen e hipotekës mbi sendin e paluajtshëm tokë armë të vendosur si garanci nga e pandehura E.Ç..

20. Me shkresën Nr.04262, datë 10.03.2022 të Bankës Amerikane të Investimeve, drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar konfirmohet dokumenti: Raport Vlerësimi “*Tokë me sipërfaqe 3440 m2, {...}*”, datë **06 shtator 2006** me **Porositës:** {...} BANK; **Pronari:** R.K.; dhe **Klienti:** E.Ç.. Sipas këtij raporti **vlera e tregut të lirë të kësaj prone është 48 000 euro**, ndërsa **vlera e shitjes së detyruar ose vlera e likuidimit është 38 500 euro.**

21. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake rezulton se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar më datë 28.04.2022 ka marrë vendimin “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave” pranë arkivës noteriale të noteres Eriketa Kokoli, të akteve: **i)** praktika e plotë e Kontratës së Sipërmarrjes Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} me palë: Shoqëria “{...}”

sh.p.k si sipërmarrës dhe R.K. si porositës; **ii**) praktika e plotë e aktit “Zgjidhje kontrate” datë 08.09.2006, mes shoqërisë “{...}” sh.p.k dhe shtetasve M.K., M.Xh., V.H., M.M. dhe I.K.; **iii**) praktika e plotë e Kontratë Sipërmarrje me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} me sipërmarrës shoqëria “{...}” sh.p.k dhe porositës E. dhe D.Ç.; **iv**) praktika e plotë e Kontratë Shitblerje me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} me shitës Shoqëria “{...}” sh.p.k dhe blerës shtetasit E. dhe D.Ç., si dhe regjistri noterial nëse këta të fundit kanë kryer ndonjë veprim tjetër noterial. Nga procesverbali “Për kqyrjen e dokumenteve” mbajtur më datë 29.04.2022 rezultuan të njëjta akte që vetë e pandehura E.Ç. i ka dorëzuar si prova, të cilat janë cituar më sipër.

22. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar më datë 22.04.2022 ka marrë vendimin “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave” pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Dega Kavajë, dokumentat në origjinal si më poshtë vijon: **i**) Praktika e plotë e regjistrimit të pasurisë në emër të familjes bujqësore të shtetasit R.K. me nr.131/54, vol 4, faqe 100, ZK nr.2292, adresa e pasurisë {...}, lloji arë, sipërfaqe totale 3440 m²; **ii**) Praktika e plotë e regjistrimit në emër të shtetasve E.Ç., pasurisë me nr.{...}, vol 5, faqe 40, ZK nr.{...}, adresa {...}, lloji i pasurisë arë, sipërfaqe totale 1450 m². Me procesverbalin “Për sekuestrimin e dokumentave” mbajtur më datë 16.05.2022 është sekuestruar dokumentacioni origjinal: Akti i marrjes së tokës në pronësi Nr.{...}, datë 1995 lëshuar nga Komuna {...} me sipërfaqe 27,191 m², familjes së R.K..

23. Me shkresën Nr.5263/1 Prot, datë 09.07.2021 të noterit Gjergj Kongoli është përcjellë (mbi kërkimin e prokurorisë së posaçme): Kontrata e Shitblerjes Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, **datë {...}** për shitblerjen e pasurisë me nr.131 /54, vol 4, faqe 100, sipërfaqe 3440 m² me shitës R.K., S.K. dhe E.K. dhe blerës E.Ç., në vlerën **300,000 lekë**.

24. Nga kqyrja e regjistrimit të veprimeve noteriale të noterit Luljeta Kongoli rezulton se kontrata me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, është regjistruar në këtë regjistër në datë **06.07.2006**. Pas sekuestrimit të praktikës së kontratës së shitblerjes si më sipër cituar pranë noterit, rezulton se gjendet e njëjta kontratë, me vlerë 300,000 lekë, por me datë 06.07.2006, të korrigjuar.

25. Gjithashtu, është sekuestruar pranë **ASHK-së** praktika e regjistrimit të pasurisë me nr.{...}, vol 4, faqe 100, dhe konstatohet se gjendet kontrata me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, e korrigjuar data dhe çmimi i shitjes është 300,000 lekë. Kjo praktikë regjistrimi ka referencë 00000099.

26. Gjithashtu, është sekuestruar pranë noterit edhe praktika e kontratës së shitblerjes me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, por me datë të korrigjuar, lidhur ndërmjet shtetasve R.K., S.K. dhe E.K. me shtetasin E.Ç. për shitblerjen e pasurisë me Nr.{...}, vol 5, faqe 40, me sipërfaqe 1450 m², në vlerën 300,000 lekë.

27. Nga kqyrja e regjistrimit të veprimeve noteriale, edhe kjo kontratë rezulton e pasqyruar në regjistrin e veprimeve noteriale më datë 06.07.2006.

28. Po ashtu, është sekuestruar pranë **ASHK-së** edhe praktika e regjistrimit të pasurisë me nr.{...}, vol 5, faqe 40, dhe konstatohet se gjendet kontrata me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...} e korrigjuar data dhe çmimi i shitjes është 300,000 lekë. Kjo praktikë regjistrimi ka referencë 00000194.

29. Më datë 29.09.2006, E.Ç. njofton Bankën {...} se ka tërhequr huanë prej 35,000 euro. Nga statement bankar i Bankës {...}, rezulton se më datë 29.09.2006 është kredituar në llogarinë bankare me nr {...} shuma e huasë e marrë pranë Bankës {...} në vlerën 35,000 euro. Më datë 29.09.2006 kjo

shtetase, kalon për llogari të shtetasës S.K. shumë prej 34,000 euro me përshkrimin "*Për shlyerje detyrimi për blerje toke*". Pjesa tjetër e ngelur në këtë llogari konstatohet se ka pasur destinacione për pagesa të tjera për efekt të kësaj kredie si pagesë primi të policës së sigurimit, shpenzime vlerësimi për pronën e ofruar si kolateral, shpenzime materiale për dokumentacionin e kredisë, shpenzime të hipotekës për regjistrimin e barrës mbi pronën, shpenzime të zyrës ligjore për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për kredinë, interes i depozitës me afat, duke shkuar më datë 30.10.2006 kjo llogari në gjendjen zero. Pra, rezulton sikur shtetasës S.K. i është bërë një pagesë prej 4,182,680 lekë, të cilat e kanë burimin nga një kredi e marrë pranë ish-Bankës {...} (34 000 X 123.02 kursi i këmbimit më datë 29.09.2006), ndërkohë që nuk rezulton të jetë paguar pjesa e mbetur nga 50 000 euro (50 000 euro X 123.26 lekë kursi i këmbimit valutor më datë {...} = 6 163 000 lekë), por as pagesa për parcelën tjetër të tokës me nr.35/30 në vlerën prej 300,000 lekësh. **Po më datë 29.09.2006 këto para janë tërhequr nga shtetasja S.K., në vlerën 33,900 euro.** Përveç kësaj pagese, nuk evidentohet të jetë kryer ndonjë pagesë tjetër në drejtim të shtetasve K. Gjithashtu, nuk konstatohet të jetë kryer ndonjë pagesë as për parcelën tjetër të tokës, atë me nr.35/30.

30. Sipas analizës financiare të bërë nga prokuroria (nga oficeri i policisë gjyqësore) rezulton se, nëse do të përlllogarisnim të ardhurat dhe shpenzimet, referuar faktit se për sipërfaqet e tokave arë nuk është paguar asnjë lek, pasur parasysh pretendimet mbi të gjithë të ardhurat e shtetasës E.Ç., pra, edhe të ardhurat e deklaruara sipas saj në një zyrë avokatie dhe pranë shoqërisë "{...}" sh.p.k dhe kredinë e marrë, duke zbritur shpenzimet për jetesë, shpenzimet për blerje pasurish (*apartment dhe makinë*) dhe mobilim, por duke mos përlllogaritur vlerën e deklaruar për blerjen e tokave, sipas pretendimeve të palëve, rezulton se familja Ç., në vitin 2006, e ka mbyllur me një kursim prej 278,850 lekë dhe, nëse mbajmë parasysh kursimet e mundshme të viteve të mëparshme, shkon në një pozitivitet prej 4,570,133 lekë (*pasur parasysh shpenzimet me normen e inflacionit*). Ky rezultat të çon, **sipas prokurorisë**, drejt allogjikës së marrjes së kredisë për blerjen e apartamentit, i cili shkon në një vlerë të përafërt. Nëse do të përlllogarisnim shpenzimet sipas të dhënave jo të plota të INSTAT, do të rezultonte se shtetasja E. e ka mbyllur vitin 2006 me një kursim prej 716 226 lekë (*nëse është paguar nga shoqëria "{...}" dhe av.Syrja Dosti*) dhe, në total, në përmbledhje edhe të kursimeve të viteve të mëparshme me një kursim të mundshëm prej 7 139 548 lekë. Ky rezultat del i pakuptimtë, sipas prokurorisë, dhe e bën allogjik marrjen e një kredie. Nëse do të zbrisnim shumat që pretendohet se janë marrë nga shoqëria "{...} - Ja" dhe av.Syrja Dosti, pasi nuk rezultojnë realisht të dokumentuara dhe as të vërtetuara se në çfarë periudhe janë marrë, kursimet e mundshme do të rezultonin në një vlerë prej 4 023 858 lekë (*pasur parasysh shpenzimet me normën e inflacionit që sërish përafrohet me vlerën e apartamentit dhe shtetasja E. nuk ka pasur asnjë arsye përse të merrte kredinë në vlerën e sipërcituar*). Nëse do të përlllogarisnim shpenzimet sipas të dhënave jo të plota të INSTAT, do të rezultonte se shtetasja E. e ka mbyllur vitin 2006 me një kursim prej 476 226 leke (*nëse nuk është paguar nga "{...}" dhe av. Syrja Dosti*) dhe, në total, në përmbledhje edhe të kursimeve të viteve të mëparshme me një kursim të mundshëm prej 6,238,662 lekë. Ky rezultat del i pakuptimtë sipas prokurorisë dhe e bën allogjik marrjen e një kredie.

30.1. Gjatë shpjegimeve **në apel** mbi këtë analizë të kryer, prokurorja u shpreh se: "...vërtetohet se e pandehura nuk ka pasur mundësi ekonomike për të blerë të tre pasuritë, pra, dy tokat arë dhe apartamentin në vitin 2006 me të ardhurat e deklaruara". Ndërsa në përgjigje të Memos në përfundim të hetimi, prokurorja ka mbajtur këtë qëndrim: "... në lidhje me pretendimet mbi analizën financiare, sjellim në vëmendje se **përveçse ajo nuk ndikon në akuzën e ngritur, është kryer në përputhje me të dhënat e administruara dhe pretendimet e parashtruara nga vetë e pandehura për të ardhurat që ka pasur ndër vite**".

31. Në përsëritje të shqyrtimit gjyqësor në apel, dëshmitarët u thirrën për t'u pyetur në seancë gjyqësore dhe ky kolegj vlerëson që qëndrimin e tyre ta pasyrojë në vijim:

32. Dëshmitarja **Luljeta Kongoli, noterja**, e cila kur është pyetur në seancë gjyqësore në gjykimin në apel lidhur me praktikën e lidhjes së kontratës së shitblerjes për pasurinë tokë arë, me 3440 m², e ndodhur në {...} Kavajë, ka deklaruar shprehimisht se:

Kur i kishte shkuar fillimisht kërkesa e prokurorisë për vënien në dispozicion të dy kontratave të shitblerjes (pra, të kontratave të shitblerjes së tokës bujqësore që e pandehura ka lidhur me familjarët e saj), deklaroi se i ka nxjerrë ato dhe nga prokuroria janë marrë kopjet. Kur e ka ballafaquar me regjistrin i ka rezultuar që në regjistër (pyetjet e prokurores konsistojnë mbi kontratën e shitblerjes të pasurisë nr.131/54, vol 4, faqe 100, me adresë {...}, nr.{...} prot, nr.{...} kol), ishte regjistruar në datën 6. Dëshmitarja e ka konsideruar një gabim material nga ana e saj, nuk e ka menduar që mund të rimerreshin dhe njëherë aktet nga prokuroria, se gjithë arshivat e noteres po kalonin në sistem me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë, po kryhej skanimi i të gjitha akteve dhe, sipas saj, për të qenë në rregull me gjithë origjinën e dokumentacioneve, që të kishin një vazhdimësi të numrave, e bëri dhe këtë korrigjim. Sipas dëshmitares, nuk kishte ndonjë interes apo dyshim për ta bërë këtë gjë. Kjo ndërhyrje nga ana e saj është bërë atëherë, kur është kërkuar nga prokuroria, pasi dëshmitarja nuk merret më vetë, se aktivitetin e ka i biri. Pra, sipas dëshmitares, data e vërtetë e lidhjes së kontratës është data 6, gabimi është data 10. Dëshmitarja shprehet nuk e mban mend pse është bërë ky gabim, kur e ka verifikuar numrin rendor i përket datës 6 në regjistër rendor. Mundet, sipas dëshmitares, që në momentin e bërjes së akteve, ato të ngeleshin pa regjistruar në regjistër dhe mbas 5 ditësh, apo mbas një jave bëhej regjistrimi.

Për sa i përket faktit se bashkëlidhur praktikës gjendjen dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme të këtyre pronave, konkretisht, të njërit prej shitësve, të familjarit R.K., ku konstatohet që data e lëshimit të këtyre në fakt është data 10, sipas dëshmitares, kjo nuk përbën ndonjë problem të jashtëzakonshëm futja e këtyre kartelave në dt.10, ndërkohë që kontrata është lidhur në datë 6. Në rastin konkret, me E. dëshmitarja shprehet se dhe e njihte dhe se nuk i ka dhënë rëndësi. Rëndësi kishte që noteres i kishte shkuar kartela. Gjatë lidhjes së kontratës, në datë 06.07.2006 komunikimi me zyrën (me ish-ZRRPP Kavajë) ka qenë nëpërmjet telefonit.

Meqenëse toka në fjalë, e cila shitej nga familjarët Kaja, rezulton të ishte përfituar me ligjin nr.7501 “Për Tokën”, sipas noteres, dokumenti që duhej për të proceduar për përpilimin e kontratave të shitjes ishte çertifikata e trungut familjar e vitit që bëhet kontrata, pra, çerifikata e trungut familjar e vitit 2006 dhe se nuk e ka vlerësuar që certifikata e vitit 1991 mund të duhet.

Momentin e hartimit të kontratës nr.{...} Rep, nr.{...} Kol, për shitjen e parcelës prej 3440 m², dëshmitarja e mban mend shumë mirë, e mban mend se ka pasur lidhje me të pandehurën, të cilën e përmend me emrin L. (juriste e {...}), e cila në atë kohë punonte bashkë me dëshmitaren dhe se vetë noterja në atë kohë ishte dhe notere e Bankës {...}.

Dëshmitarja shprehet se, në rastin konkret kontrata u bë formalisht me shitje, sepse ashtu e donte Banka {...} dhe nuk e donte me kontratë dhurimi dhe u bë me një çmim simbolik. Kur e çoi L. në bankë, nuk e pranoi, ata e kthyen përsëri, duke mos e pranuar pa i vënë një vlerë, duke kërkuar rritjen e vlerës, pra, të çmimit, kjo për të mundësuar marrjen e kredisë. Kontrata e parë u bë me vlerë 3 milion lekë të vjetra dhe, meqenëse Banka {...} nuk e pranoi, u detyruan ta rikthejnë kontratën. Po atë ditë është nënshkruar kontrata me 50 mijë (milion lekë) apo (dollarë). Sipas dëshmitares, mund të jetë devijuar “në mënyrën e mirë të fjalës”, sepse ishin dy kontrata të bëra në një ditë dhe kur janë hapur letrat, gabimisht dëshmitarja shprehet se ajo me cilësinë e noteres mund të mos ketë zëvendësuar faqen e vlerës, pra, atë faqe të kontratës që kishte dhe çmimin. Meqenëse është

ndryshuar po atë ditë, dëshmitarja shprehet se kontrata e parë me vlerë 300 mijë lekë nuk është tërhequr, në moment nga neglizhenca. Është bërë vetëm një kontratë urgjente për ta çuar tek Banka. Nga neglizhenca, dëshmitarja në cilësinë e noteres ka menduar që do t'i bëjë më pas. Dokumentet ishin të gjitha në zyrën e noteres, u rregullua dokumentacioni vetëm për Bankën, pjesa tjetër është në zyrë.

Pranë ASHK-së është gjetur kontratat me vlerë 300 mijë lekë për pasurinë me 3440 m² pasi, sipas dëshmitares në cilësinë e noteres, ajo ka harruar ta ndryshojë. Nuk e mban mend, nëse ia ka marrë palës kontratën e parë, por dëshmitarja shprehet se ajo, me cilësinë e noteres, e ka ndryshuar kontratën po atë ditë, pra, duke i vënë çmimin 50 mijë euro.

Kur ndodh një ndryshim i tillë i vullnetit të palëve në lidhje me një kontratë të lidhur me persona të huaj, sipas dëshmitares, patjetër duhet t'i kthejnë mbrapsht kontratat gabuara dhe, nëse është bërë një gabim, rregullohet brenda ditës, tërhiqet, grisët, pra, kontrata tjetër. Ndryshimet në qoftë se kanë kaluar ditë, bëhet një shtesë e kontratës, por, nëse është bërë brenda ditës dhe brenda orës, nuk ka nevojë të bëhet. Çmimi u ndryshua nga 300 mijë në 50 mijë euro për shkak edhe të bisedimeve me Bankën {...}. Vlerën 50 mijë euro e sugjeroi vetë Banka.

Vlerësimi i bankës është çështje e ekspertit të bankës. Dëshmitarja nuk i mban mend, nëse ka bërë verifikimet në lidhje me pronarët e vërtetë të tokës, e cila u shit e përfituar sipas ligjit nr.7501 "Për Tokën". E.Ç. mund të ketë qenë nën moshën ligjore dhe nuk përfiton. Është një udhëzim i Gjykatës së Lartë dhe në këto raste nuk merret parasysht.

Ditën e lidhjes së kontratës dëshmitarja ka pasur tre persona në zyrë. Nuk e mban mend, nëse këta persona kanë qenë në zyrë gjithë kohës deri sa vajti momenti në bankë.

Mbi pyetjet e të pandehurës E.Ç. dëshmitarja i përgjigjet se transaksioni e një pasurie nuk mund të bëhet pa u administruar kartela e pasurisë, por përgjigjia në këtë kohë është marrë në telefon. Palët janë lidhur me hipotekën e Kavajës, ku dhe është vërtetuar që prona është e lirë, por kjo nuk e pengonte për të bërë aktin. Nëse është vënë data 10, kjo ka ndodhur mbas për kartelën, por në kronologji të regjistrit të noteres doli data 6, ndaj dhe ky mund të jetë gabim material i noteres në të shkruajtur. Sipas dëshmitares, aktet mund të rrinin dhe një javë pa u regjistruar dhe më vonë i vinin numrat për shkak të volumit të punës. Pra, sipas saj, më vonë, në momentin që ajo do të ishte e lire. Në momentin që ka hapur regjistrin i korrespondonte data 6, numrin kronologjik të regjistrit dhe dëshmitarja këtë e ka bërë këtë vetëm për të qenë në rregull, meqë po hidheshin në sistem të gjitha aktet e vjetra, pasi mund ta kishte lënë edhe ashtu.

.... Me Bankën kanë negociuar të dyja, pra, pra edhe dëshmitarja edhe e pandehura. Dhe eksperti po të shkonte nuk kishte një çmim, ndaj kërkohet nga banka domosdoshmërisht një tokë me çmim.

Kjo tokë që e pandehura merrte nga prindërit do të vihej kolateral për të marrë një kredi nga e pandehura nga kjo bankë, ku dëshmitarja, punonte si notere për klientë të ndryshëm, kryente punën si notere për llogari të bankës. Sipas noteres, arsyeja pse nuk u bë kontrata e dhurimit, ishte sepse toka nuk kishte çmim në kontratën e dhurimit dhe i është vënë çmim simbolik. Banka kishte kërkuar të rritej çmimi tokës, me qëllim që të jepej kredia.

Dëshmitarja e ka nënshkruar kontratën e kredisë. Nuk e mban mend si u shkrua për të blerë shtëpi apo diçka tjetër, janë kontrata tip, të hartuara nga banka.

Pyetjes së gjykatës, nëse ajo mban mend çfarë është shkruar në këtë kontratë, për çfarë do përdorej kjo vlerë, dëshmitarja i përgjigjet se banka do të garantohej mbi kolateralin që vë, sepse banka nuk shkruan qëllimin përse po e merr kredinë dhe se bankës i intereson vetëm bllokimi në hipotekë i pronës.

33. Dëshmitari Gj.K., i cili ka trashëguar arkivën e noteres, nënës së tij, Luljeta Kongoli, është shprehur se kontrata nr.{...} rep, nr.{...} kol, datë {...} është kërkuar me shkresë nga ana e

Prokurorisë së Posaçme dhe që i është vënë në dispozicion ka pasur datën “10.06”. Pastaj, kur është bërë konstatimi që kishte një mospërputhje midis regjistrimit dhe kontratës dhe është bërë një vetërregullim nga ana e nënës së tij, Luljeta Kongoli dhe kjo pa dijeninë e tij. Sipas dëshmitarit, këto rregullime po i hedhin tani, pasi po skanojnë gjithë aktet e vjetra të arshivave të trashëguara nga ana e tyre dhe, kur është bërë konstatimi i gabimit në datë, me iniciativën e saj, nëna e tij ka menduar për të bërë një vetë rregullim, pa e vënë dëshmitarin në dijeni. Kontratën me ndryshimet në datë sipas regjistrimit nëna e tij e ka lënë në arshivë. Nëna e tij, sipas dëshmitarit, e asiston atë që nga viti 2012, vit kur ka dalë në pension.

Referuar profesionit që dëshmitari ka, kur shitet një pasuri e paluajtshme e përfituar me ligjin nr.7501, është e nevojshme kartela e pasurisë, në momentin që lidhet kontrata e shitblerjes me qëllim për të parë gjendjen juridike të pronës. Referuar gjithmonë faktit që kemi të bëjmë me pasuri të përfituar sipas ligjit nr.7501, në praktikën e tij të punës dëshmitari merr çertifikatë të vitit 1991 dhe të gjendjes aktuale. Dëshmitari deklaroi që veprimet i ka kryer nëna e tij dhe se nuk ka patur dijeni për këtë fakt. Lidhur me këto fakte ai ka marrë dijeni, kur u ballafaqua nga prokuroria.

34. Dëshmitari R.K., rezultuar babai i të pandehurës E.Ç., bazuar në nenin 158/a të K.Pr.Penale, përfitoi nga e drejta për të mos u pyetur në seancë gjyqësore. Mbi kërkesën e prokurores, duke qenë se dëshmitari në fazën e hetimit nuk kishte përfituar nga kjo e drejtë, u lexua procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, procesverbal ky i datës 19.04.2022 (i cili u pjesë e fashikullit të gjykimit në kuptimin procedural⁵), në referim të nenit 371 të K.Pr.Penale.

Referuar këtij procesverbali: “E.Ç. është ime bijë, ne si anëtarë të kooperativës {...} në Kavajë, gëzonim të drejtën e pronës në bazë të ligjit nr.7501. Kështu në bazë të ligjit nr.7501 neve na takonte nga 5000 m² për anëtar familje. Vajza ime E. është martuar në Tiranë, lindi një fëmijë dhe kishte nevoja për një apartament. Bëmë kontrat akt-shitje të këtyre dy parcelave për efekt kredie. Akt shitblerja u bë tek noterja, ne firmosëm duke e ditur se kjo tokë e disponueshme i takonte vajzës në bazë të ligjit. Prona, toka bujqësore që është dhënë në bazë të ligjit nr.7501, ka kaluar në emrin e kryefamiliarit dhe sipërfaqja totale që kemi përfituar është rreth 25,000 m² për të cilat disponoj çertifikatë pronësie. Aktualisht zotëroj 16, 450 m² në ({...}), 1,500 m² tek {...}, plus 1,333 m² në {...}, 207 m² pemëtore. Meqënëse vajza kërkonte kredi, u mblodhëm bashkë me pjestarët e familjes, ramë në kompromis që bijës time E. t’i japim këtë sipërfaqe toke që disponojmë (sipërfaqja 3440 m² tek {...} dhe 1,450 m² tek {...}). Pyetje: Sa fëmijë keni? Përgjigje: Unë kam 3 fëmijë, 2 vajza , E. dhe O. si dhe 1 djalë i quajtur E.. **Pyetje:** Nga shqyrtimi i dokumentave na rezulton që keni kryer 3 kontrata shitblerje me blerëse shtetasen E.Ç., për çfarë pasurish bëhet fjalë dhe a janë nënshkruara prej jush këto kontrata? (I tregohen; kontrat shitblerje nr.{...}rep, nr.{...} kol, pasuria tokë arë me sip 3440 m², nr.pasurie 131/54, vol, faqe 100 , me adresë në {...} me çmim shitje 300,000 lekë, kontrat shitblerje nr.{...} rep, nr.{...} kol, pasuria tokë arë me sip 3440 m², nr.pasurie 131/54, vol 4, faqe 100, me adresë në {...} me çmim shitje 50,000 euro; kontrat shitblerje nr.2937 rep, nr.1489kol, pasuria tokë arë me sipërfaqe 1450 m², nr.pasurie 35/30, vol 5, faqe 40, me adresë {...} me çmim shitje 300,000 lekë. A janë nënshkruar nga ju dhe çfarë mund të na thoni referuar çmimit të shitjes? Përgjigje: Nënshkruar janë nga dora ime, meqë ishte për efekt kredie nuk u interesova për çmimin për arsye se kontratën, me sa më kujtohet, e kemi nënshkruar për shkak të bankës për të marrë kredi. Unë nuk kisha interes nga shitja e pronës, për arsye se vajzës time i takonte ligjërisht toka, unë nuk do merrja para dhe, siç e thashë më sipër, nuk isha i interesuar për çmimin dhe nuk më kujtohet

⁵ Fizikisht procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, R. Kaja, i datës 19.04.2022 gjendej në fashikull për shkak të të proceduarit në shkallë të parë me ritin e gjykimit të shkurtuar.

saktësisht se çfarë ka ndodhur, por di që është bërë për shkak të kredisë që duhej marrë për blerjen e apartamentit. **Toka është dhënë pa pagesë, unë lekë s'kam përfituar. Pyetje:** Në lidhje me pasuritë e shituar, a jeni paguar dhe në çfarë formë janë marrë paratë, me bankë apo në dorë (cash)? **Përgjigje:** Siç e thashë më sipër, nuk kam marrë asnjë lekë nga shitja e këtyre pronave, as me bankë as me para në dorë (cash). **Pyetje:** Ju thatë që i keni dhënë sipërfaqet e tokës 3,440 m² dhe 1450 m² vajzës tuaj E. pa pagesë, dmth pa përfituar para prej saj, po fëmijëve të tjerë a i keni dhuruar prona apo pasuri? **Përgjigje:** Fëmijëve të tjerë aktualisht nuk u kam ndarë prona, sepse nuk iu janë dashur, kur të vijë koha do ua ndaj me noter, kur të kenë nevojë. **Pyetje:** Sipas të dhënave të marra nga {...} Bank rezulton që në 20.09.2006 shtetasja E.Ç., i ka kaluar 34,000 euro shtetases S.K., me përshkrimin "Kalim për shlyerje detyrimi për blerje toke", shumë që është tërhequr (33,900 euro) po në këtë datë nga shtetasja S.K.. Ç'mund të na thoni për këtë transaksion, pse ka ndodhur? (I tregohet ekstrakti i {...} Bank i llogarisë nr. {...} në emër të S.K.). **Përgjigje:** Për këtë fakt unë nuk kam dijeni, dhe nuk kam çfarë të shtoj".

35. Dëshmitarja S.K., rezultuar nëna e të pandehurës E.Ç. dhe bazuar në nenin 158/a të K.Pr.Penale, përfitoi nga e drejta për të mos u pyetur në seancë gjyqësore. Mbi kërkesën e prokurores, duke qenë se dëshimtari në fazën e hetimit nuk kishte përfituar nga kjo e drejtë, u lexua procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, i datës 19.04.2022 (i cili u pjesë e fashikullit të gjykimit në kuptimin procedural⁶, në referim të nenit 371 të K.Pr.Penale).

Referuar këtij procesverbal: "E.Ç. është vajza jonë. Me sa më kujtohet E. donte të merrte një shtëpi pasi kish djalin një vjeç dhe në atë kohë ishte me qira. Për blerjen e apartamenti i nevojitej një kredi bankare, pasi nuk i kishin lekët për të blerë shtëpinë. Ne si familje në bazë të ligjit 7501 kemi marrë sipërfaqe toke rreth 5000 m² për frymë. Edhe E. si bija jonë i takonte të merrte 5,000 m² nga toka që ne kemi marrë në bazë të ligjit nr.7501. Si familje ne kemi marrë rreth 25 mijë - 27 mijë m² tokë. **Shkuam tek noterja për të firmosur kontratën që do t'i shërbente E. për të marrë tokën me të cilën do merrte kredi në bankë. Me sa mbaj mend, unë kam qenë dy ose tre herë te noterja, por saktësisht nuk mbaj mend. Ne kemi nënshkruar kontratën vetëm për kredinë e gocës. Pyetje:** Sa fëmijë keni? **Përgjigje:** Unë kam 3 fëmijë, 2 vajza, E. dhe O. si dhe 1 djalë i quajtur E.. **Pyetje:** Nga shqyrtimi i dokumentave na rezulton që keni kryer 3 kontrata shitblerje me blerëse shtetasen E.Ç., për çfarë pasurish bëhet fjalë dhe a janë nënshkruara prej jush këto kontrata? (I tregohen; kontrat shitblerje nr.{...} rep, nr.{...} kol, pasuria tokë arë me sipërfaqe 3440 m², nr.pasurie {...}, vol 4 faqe 100, me adresë {...} me çmim shitje 300,000 lekë, kontrat shitblerje nr.{...} rep, nr.{...} kol, pasuria tokë arë me sipërfaqe 3440 m², nr.pasurie 131/54, vol 4 faqe 100, me adresë {...} me çmim shitje 50,000 euro; kontrat shitblerje nr.{...} rep, nr. {...} kol, pasuria tokë arë me sipërfaqe 1450 m², nr.pasurie {...}, vol 5, faqe 40, me adresë {...} me çmim shitje 300,000 lekë. A janë nënshkruar nga Ju, dhe çfarë mund të na thoni referuar çmimit të shitjes? **Përgjigje:** **Nënshkruar janë nga dora ime. Nuk me kujtohet saktësisht se çfarë ka ndodhur, kam firmosur çfarë më kanë vënë përpara. Firmën e kam hedhur me qëllim për të ndihmuar vajzën ime, E. të merrte kredi. Kontratat janë firmosur përpara noteres dhe nuk më kujtohet pse janë bërë tre kontrata, pasi unë mbaj mend që 2 kontrata kemi nënshkruar, pasi dy pasuri i janë dhënë E., si pjesë të vetën.**

Pyetje: Në lidhje me pasuritë e shitur, a jeni paguar dhe në çfarë forme janë marrë paratë, me bankë apo në dorë (cash)? **Përgjigje:** Pasuritë, Sipërfaqet e tokës nuk i janë shitur E., pasi asaj i takonte në bazë të ligjit 7501, ne si prindër nuk kemi shitur as nuk kemi marrë para, por e bëmë për të mbështetur gocën të merrte kredi. **Pyetje:** Ju thatë që i keni dhënë sipërfaqet e tokës 3,440 m² dhe

⁶ Fizikisht procesverbali për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, S. Kaja, i datës 19.04.2022 gjendej në fashikull për shkak të të proceduarit në shkallë të parë me ritin e gjykimit të shkurtuar.

1450 m² vajzës tuaj E. pa pagesë, pa përfutuar para prej saj, po fëmijëve të tjerë a i keni dhuruar prona apo pasuri? Përgjigje: Pronat, sipërfaqet e tokës janë në emrin e R.it, bashkëshortit tim, vajza jonë E. kishte nevojë të merrte kredi dhe kjo ishte arsyeja që i dhamë pjesën e vet, pronat që do t'iu jepjen fëmijëve të tjerë janë në emër të R.it, aktualisht nuk iu janë kaluar fëmijëve të tjerë. Pyetje: Sipas të dhënave të marra nga {...} Bank rezulton që në 20.09.2006 shtetasja E.Ç., ju ka kaluar juve 34,000 euro në llogarinë bankare pranë {...} Bank me përshkrimin "Kalim për shlyerje detyrimi për blerje toke", shumë që është tërhequr (33,900 euro) po në këtë datë nga ju. Çmund të na thoni për këtë transaksion, pse ka ndodhur? (I tregohet ekstrakti i {...} Bank i llogarisë nr. 006081 në emër të S.K.). Përgjigje: Me sa më kujtohet, kam shkuar tek banka me E., kam tërhequr shumën e parave dhe ia kam dhënë vajzës. Dua të them edhe njëherë, ne nuk i kemi shitur pronë E. dhe nuk kemi përfutuar para nga kalimi i pronës, çdo gjë është bërë për të marrë kredi në bankë".

36. Dëshmitari J.K. u shpreh gjatë pyetjes në seancë gjyqësore: Shoqëria "{...} Jan" sh.p.k është administruar nga babai i dëshmitarit (Th.) dhe ai ka punuar me kompaninë për shumë vite dhe se me një pjesë të punëve të kompanisë merrej ai. Në shoqëri babai i tij ka qenë administrator dhe ortak i vetëm. Në vitin 2006 ai ka punuar në shoqëri. Për stafin që punonin, paguheshin sigurime shoqërore dhe kontribute. Objekti i shoqërisë ishin ndërtime civile, pallate, antena celularësh, tender ujësjellës. Babai i dëshmitarit aktualisht nuk është më drejtues, sepse nuk është më i aftë. Lidhur me këshillat juridike në periudha të ndryshme, shoqëria ka funksionuar me njerëz të ndryshëm. Një nga ata ka qenë noterja Mimoza Shehu, pak a shumë atje ku bënë kontratat merrnin edhe asistencë. Nga aktet që janë administruar gjatë hetimit ka rezultuar një vërtetim, i lëshuar në muajin korrik 2006, i cili është nënshkruar për Shoqërinë "{...}", nga administratori Th.K., të cilin dëshmitari e pohon se është nënshkrimi i babait të tij. Logon dëshmitari nuk e mban mend, nuk e di mund të ketë përdorur dy ose tre, kurse koka i ngjan si e shoqërisë.

Pyetjes së të pandehurës E.Ç., nëse dëshmitari ka qenë në pozicion drejtues në vitin 2006 dhe nëse ishte i autorizuar për të firmosur angazhime që kishte shoqëria, dëshmitari iu përgjigj "jo, nuk ka pasur asnjë të drejtë firme". Dëshmitari deklaroi se e njeh të pandehurën, pasi zyrat e shoqërisë dhe të të pandehurës ishin ngjitur. Ata kanë punuar për një kohë të gjatë, pasi zonja E. zgjidhte problemet që kishin antenat, të cilat ishin me leje të ndryshme. Zakonisht dosja kopsitej dhe ata bënë një pjesë të fundit, por bashkëpunonin herë pas here, sepse e kërkonte puna. Dëshmitari shkonte nëpër antena dhe ndiqte një pjesë të punimeve, betone, rrugë dhe se e pandehura dhe ai kanë komunikuar kur ka pasur probleme me banorët ose me dikë tjetër. Aty ka lindur dhe njohja e E. me babain e dëshmitarit. Dëshmitari deklaroi se janë takuar me të pandehurën më mbapa, kur ata kanë transferuar zyrën dhe aty dhe ka parë që E. vinte vazhdimisht tek zyrat. Kjo njohje ka vazhduar dhe ajo bashkëpunonte vazhdimisht me babain e tij dhe e ka parë që vinin vazhdimisht bashkë me babain. Periudha kur vinte në zyrat e tyre ka qenë pak më mbapa dhe nuk mund ta thotë fiks dëshmitari funksionin. Dëshmitari ka dijeni që e pandehura ofronte bashkëpunim dhe shërbim, por nuk ka dijeni për formën që ka qenë, di që babai e paguante diçka, por nuk di të them. Dijeni në lidhje me pagesën që i është kryer të pandehurës dëshmitari ka marrë kur është pyetur herën e parë nga Prokuroria, sapo ka dalë nga zyra, pasi nuk bënte dot lidhjen me mbiemrin e zonjës, se nuk i kujtohej mbiemri, se e njihnin me emrin, kryesisht e thërrisnin me emrin "L.". Sapo ka dalë nga zyra e prokurorit, pas dy-tre minutash ka kujtuar emrin dhe ka marrë menjëherë zotërinë që e ka marrë në pyetje në telefon, oficerin e policisë dhe i tha dua të vij në këtë proces, sepse u kujtua që është filania dhe e njihte.

Prokurorja kërkoi të procedohet me një kundërshtim të pjesshëm në lidhje me dëshminë e dhënë në seancë gjyqësore nga dëshmitari, pikërisht në lidhje me dijeninë e tij, nëse shtetasja E.Ç. është paguar apo jo nga shoqëria "{...}" dhe pozicioni i punës që pretendohet që shtetasja E.Ç. ka pasur pranë shoqërisë, duke përdorur procesverbalet e deklarimeve të datës 10 maj 2022, para oficerit të policisë

gjyqësore, hetuesit B.S.. Gjykata, referuar nenit 362, pika, 1, të K.Pr.Penale pranoi kundërshtimin e pjesshëm të dëshmisë së dëshmitarit, duke u përdorur dekarimet e tij në fazën e hetimit⁷. Dëshmitari është shprehur: “*Shtetasja në fjalë bashkëpunonte me kompaninë “{...}”, por unë nuk kam dijeni për pozicionin e saj. Kemi patur komunikim me shtetasen në fjalë dhe gjykoi nga ky raport bashkëpunimi, im at mund të ketë kërkuar shërbim apo ndihmë të shtetasës E.Ç., në lidhje me vërtetimin e lëshuar dhe me pagesën e deklaruar, informacion më të saktë mund të jepte babai im Thanas {...}*”.

37. Dëshmitarja M.Xh., rezultuar vajza e shtetasit R.K., i cili rezulton palë në kontratën e sipërmarrje në vitin 2003, me Shoqërisë “{...}” shpk. Dëshmitarja deklaroi se babai i saj, që ka vdekur, ka pasur një shtëpi rreth 70 m² dhe e kishte për ta blerë. Kishte bërë parapagime deri në një periudhë kohe, por nuk ishte bërë dorëzimi. Lidhur me pagimin e lekëve, dëshmitarja deklaroi se përveç një kësti të fundit, ishin paguar këstet e tjera. Kësti i fundit ka qenë rreth 4000 e pak euro. Pas ndërrimit të jetës së babait të saj, trashëgimtarët që ishin katër fëmijët e tij dhe njerka, trashëgimia u nda në pesë pjesë. Pasi doli trashëgimia shtëpinë, trashëgimtarët menduan që ta shisnin. U gjet një blerës, që ka qenë E., kolege tek firma “{...}” ku dëshmitarja shprehet se ka qenë kontabiliste dhe janë njohur në këtë firmë. E. ka qenë juriste e shoqërisë dhe në bisedë e sipër dëshmitarja i ka thënë se do të shiste shtëpinë e babait. E. e kishte parë dhe i ka thënë do presësh pak se donte ta blente. E. duhet ta priste, sepse nuk i kishte lekët gjendje dhe E. i kishte thënë se donte të merrte kredi dhe të bëjë shlyerjen. Ajo është pritur për të marrë këtë kredinë dhe sa ka bërë plotësimin e kredisë që zgjat disa muaj. Si vit ka qenë viti 2006, atë vit që i ka vdekur babai, mbas trashëgimisë është bërë kjo vendimmarrje, pra, për shitjen e shtëpisë.

Më pas, shpjegon dëshmitarja, shtëpia iu shit. Kanë bërë kontratën dhe më pas kanë marrë lekët, mbasi E. kishte marrë kredinë. Lidhur me distancën mes datës ose muajit, kur është bërë kontrata dhe data ose muajit kur janë marrë paratë, dëshmitarja u shpreh se nuk e mban mend, sepse palët kanë bërë kontratën, ngaqë banka kërkonte kontratën përpara dhe pastaj disbursonte kredinë, mbasi shqyrtohej si çështje. Edhe sot ekziston po e njëjta situatë që ata marrin kontratën dhe shqyrtojnë kredinë mbrapa. Shtëpia nuk ishte e regjistruar në zyrë të regjistrimit, pasi ishte në ndërtim e sipër, e pambyllur njëqind për qind, prandaj u bë akti, domethënë është bërë prishja e kontratës me shoqërinë dhe shoqëria e ka kaluar pronën tek E.. Dorëzimi është bërë nëpërmjet shoqërisë për të qenë më të sigurt.

E pandehura për apartamentin ka paguar rreth 42 mijë dollarë, një gjë e tillë, sepse nuk kishte qenë me dollarë atëherë. Referuar kontratës së sipërmarrjes së babait të dëshmitares kësti i katërt në shumën prej 4464 dollarë, do të paguhej me marrjen e çelësave, por kësti i fundit nuk ishte paguar, E. ka blerë atë detyrim që ata kishin me shoqërinë, se ishte i papërfunduar apartamenti domethënë pjesën e papaguar ndaj shoqërisë, do ta shlyente E.. Dëshmitarja nuk e mbante mend që çmimi i shitjes së apartamentit ishte dyzetë e dy mijë dollarë e tetë qind e gjashtëdhjetë e katër dollarë, por ajo pohoi në seancë që aq ka qenë. Domethënë pala shitëse (dëshmitarja dhe bashkëpronarët) kanë futur ndërmjetëse shoqërinë për të marrë të njëjtën shumë. Në përgjigje të pyetjes së prokurores dëshmitarja deklaroi se paratë nga e pandehura janë dhënë *cash* dhe duke qenë se rezultojnë pesë trashëgimtarë, paratë i janë dhënë të gjitha vëllait. Dorëzimi i lekëve i është bërë vetë dëshmitares nga e pandehura. E pandehura E. e kishte vënë në dijeni dëshmitaren për ekzistencën e një kredie, pasi sipas dëshmitares, ajo ishte me mirëbesim, domethënë që dëshmitarja do të priste sa të merrej kredia nga e pandehura.

⁷ referuar procesverbalit “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” mbajtur më datë 10.05.2022

38. Dëshmitari **I.K.**, rezultuar djali i shtetasit R.K., i cili rezulton palë në kontratën e sipërmarrje në vitin 2003, me Shoqërisë “{...}” shpk. Dëshmitari u shpreh se ishte në dijeni se, në vitin 2003 është lidhur një kontratë për një apartament ndërmjet të ndjerit R.K., të atit të dëshmitarit dhe Shoqërisë “{...}” shpk. Apartamentin, pasi i ati vdiq e kanë shitur dhe blerësin e ka gjetur motra që ka qenë e madhe, M. dhe më shumë me dokumentacionin është marrë ajo. Blerësi e pagoi vlerën e apartamentit, me dakordësinë e tyre, pas lidhjes së kontratës. Lekët e shitjes i ka marrë dëshmitari, por nuk e mban mend sa lekë ka marrë. Fakti se pse lindi nevoja për dakordësi dhe nuk u pagua çmimi në momentin e lidhjes së kontratës, dëshmitari deklaroi se nuk e mban mend mirë dhe nuk është se është marrë shumë me këtë pjesën e kësaj, vetëm ai di se palët kanë lidhur kontratën dhe pastaj mbrapa kontratës me dakordësinë e tyre janë marrë lekët.

39. Dëshmitarja **M.K.**, bashkëshortja e shtetasit R.K., u shpreh se ishte në dijeni të kontratës të sipërmarrjes të lidhur në vitin 2003 ndërmjet shoqërisë “{...}” shpk dhe bashkëshortit. Ajo kontratë bënte fjalë për një shtëpi banimi, por s’kishte përfunduar tamam. Pagesa në lidhje me këtë shtëpi në drejtim të shoqërisë është bërë sipas kësteve që jepeshin. Dëshmitarja vetë nuk ka dijeni sa lekë janë paguar. Vlera në total sipas dëshmitares rezultoi të jetë 40-45 afërsisht, nuk e mban mend, pasi kanë kaluar shumë vite. Bashkëshorti i dëshmitares ka ndërruar jetë në datë 09 mars të vitit 2006 dhe kur ai ka ndërruar jetë punimet në këtë apartament nuk kishin përfunduar. Pas vdekjes së bashkëshortit apartamenti u shit. Për faktin si u shit dhe kush e gjeti blerësin, dëshmitarja nuk ka dijeni pasi është marrë djali dhe vajza e madhe e bashkëshortit të saj, I. dhe M.. Pasi u shit ose u gjet blerësi, dëshmitarja nuk e mban mend, nëse u lidh kontratë me blerësin dhe nëse ai pagoi paratë për apartamentin. Dëshmitarja deklaroi se nuk ka marrë lekë nga shitja e apartamentit dhe nuk ka dijeni ku shkuan lekët nga shitja e tij. Dëshmitarja deklaroi se lekët nga shitja e tij vendosi t’ia japë djalit të bashkëshortit, Ismailit, se ku i çuan pastaj nuk e di. Dëshmitarja deklaroi se ka dëgjuar të paktën se lekët nga blerësi janë dhënë mbas një muaji derisa u bënë letrat, dokumentat pasi sipas dëshmitares kontrata është hartuar pas një muaji, jo në moment.

40. Dëshmitarja **V.H.**, rezultuar vajza e shtetasit R.K., i cili rezultoi palë në kontratën e sipërmarrje në vitin 2003, me Shoqërinë “{...}” shpk. Edhe kjo dëshmitare, sikurse dëshmitarët I., M. dhe Minire, deklaroi ndër të tjera se di që motra M. është marrë me shitjen e shtëpisë dhe ajo thjesht pohonte veprimet që motra e saj kryente lidhur me shitjen. Dëshmitarja nuk ka dijeni, nëse babai saj e kishte paguar vlerën e apartamentit, ajo di që motra e shiti shtëpinë dhe i mori lekët të cilat ia dha vëllait. Ajo di se paratë janë paguar *cash* nga blerësi dhe jo nëpërmjet bankës. Ajo nuk ka dijeni se sa ka qenë fiks shuma, sepse është marrë motra e saj e madhe me këtë. Pyetjes së gjykatës, nëse përputhet momenti i lidhjes së kontratës me marrjen e lekëve nga blerësja dhe se kur u morën lekët në raport me lidhjen e kontratës dëshmitarja deklaroi se lekët janë marrë mbrapa, saktësisht nuk e di. Ajo di me siguri se motra e saj e ka vënë në dijeni që shtëpinë do ta shesin edhe lekët do i marrin dhe do ia japin vëllait.

41. E pandehura **E.Ç.**, ka paraqitur shpjegime pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila është protokolluar më datë 15.10.2021 me Nr.8184 Prot. Referuar këtyre shpjegimeve:

41.1. Lidhur me shpjegimet në ILDKPKI është shprehur: “ Jam paraqitur më datë 18.09.2017 dhe më janë bërë prezent pyetjet dhe dokumentacioni i kërkuar dhe u ra dakort që në datë 02.10.2017 do të paraqitem për të dhënë shpjegime dhe paraqes dokumentacion justifikues. Më konkretisht, më janë kërkuar sqarime se përse kam deklaruar që toka në {...} me sipërfaqe 3440 m² është blerë në

masën 35 000 euro nga kredia e marrë nga {...}Bank, kur kjo bankë në përgjigjen e saj datë 8.8.2017, ka konfirmuar se kredia 35 000 euro është marrë në datë 29.09.2006 për blerje apartamenti.

41.2. Në përgjigje të ILDKPKI-së kam paraqitur dhe sqaruar: [...] *kjo tokë ishte e babit tim dhe që të vihej kolateral duhej të bëhej një kontratë shitblerje në emrin tim si blerës që pastaj ta përdorja si kolateral për marrjen e kredisë. Pra, kjo tokë nuk është blerë realisht nga unë, pasi kredia është marrë për apartamentin. Dhe toka e dytë me sipërfaqe 1450 m² nuk është blerë, por që ta regjistrohej në emrin tim, duhet të lidhja një kontratë shitblerje me tim atë që ishte pronar i kësaj toke. Dhe për këtë tokë nuk kam paguar asgjë. Babai im e ka përfituar këtë tokë njësoj si tokë e parë, nga ligji 7501.[...]*

41.3. “.....Kam prezumuar të sqaruar/ndrequr deklarinimin tim në DPDFD të 17.07.2017, në referencë dhe të nenit 24 të ligjit nr.9049 të datës 10.04.2003”.

41.4. “Në të gjithë deklarinimin tim para fillimit të detyrës, i jam referuar dokumentacionit ligjor që unë disponoja dhe që kisha depozituar në Bankën {...} për marrjen e kredisë. Pra, unë kisha firmosur një kontratë me 50,000 euro me prindërit dhe vëllain tim, me qëllim që ta vendosja kolateral për marrjen e kredisë dhe banka për këtë kërkonte që kjo pronë të kalonte me kontratë shitje, pas një sërë veprimesh që kishte kryer në lidhje me vlerësimin e kësaj prone...”.

41.5. “Për sa kohë që qëllimi im i vetëm ishte marrja e një huaje për të blerë apartamentin, isha e detyruar të zbatoja të gjitha kërkesat dhe procedurat e përcaktuara nga Banka...”.

41.6. “Më tej, pasi banka me konfirmoi që plotësoheshin kushtet për aplikim, atëherë unë duhet të plotësoja kushtet për garancinë apo kolateralin, në të cilin përfshiheshin: (1) *Dokumenti i plotë i pronës që ofrohet si garanci (origjina e pronës dhe kartelë e rifreskuar nga Hipoteka) dhe pronave që zotëroni; (2) Kontrata e blerjes së pronës së re (ose Kontrata sipërmarrjes); (3) gentplanin e pronës ; (4) kopje të lejes së ndërtimit dhe vendimit për dhënie të sheshit të ndërtimit....”*

41.7. “Pasi u konsultova me përfaqësuesit e bankës në lidhje me apartamentin që kisha zgjedhur dhe i paraqita dokumentacionin përkatës, më njoftuan se nuk mund të lihej kolateral apartamenti, pasi nuk plotësonte kushtet e lënies kolateral në favor të bankës, duke qenë se ishte i paregjistruar në ZVRPP dhe për këtë arsye do të duhet të paraqesësh një kontratë blerje të një prone tjetër, e cila plotëson kushtet e kërkuara nga banka...”.

41.8. “Në këto kushte, babai im filloi procedurën për regjistrimin e dy pronave tokë arë në ish-ZVRPP Kavajë dhe prona, të cilët plotësonin kushtet për kolateral sipas kërkesave të bankës, u paraqita pranë noterit, e cila ishte dhe noteri i Bankës {...} dhe kërkova të kaloj pronat e regjistruara nga babai im në emrin tim, pasuritë me nr.131/54 me sipërfaqe 3440 m² dhe pasurinë me nr. 35/50, për shkak të kërkesave të bankës, e cila kërkonte një pronë të regjistruar në regjistrat hipotekar për dhënien e shumës së kërkuar kredi...”

41.9. “Referuar shumës së kërkuar nga ana ime prej 35 000 eurosh kredi dhe duke qenë se banka kërkonte kolateral, i cili të ishte i vlerësuar me çmim në shitje në tregun e lirë dhe pastaj të jepte 70% të çmimit të vlerësuar, ajo kërkoi vlerësimin e pasurisë me nr.131/54 me sipërfaqe 3440 m², pasuri e cila plotësonte kushtet e bankës për të vendosur kolateral. Kjo pronë vlerësohej në vlerën 48 000 euro, si vlerë e tregut të lirë të pronave dhe vlera e likuidimit në shumën 38.500 euro, sipas raportit të vlerësimit kryer nga studio "{...}" sh.p.k, angazhuar nga vetë banka. Gjithashtu, iu paraqit bankës si alternativë për vënie kolaterali apartamentin e prindërve të bashkëshortit, me sipërfaqe 67 m², rruga “Bajram Curri” në Tiranë, i cili u vlerësua gjithashtu, por nuk u përdor si kolateral, duke

qenë se çmimi i vlerësuar për shitje në treg të lirë i pronës tokë arë me sipërfaqe 3440 m², ishte më i përshtatshëm nga analiza e riskut të bërë nga Banka...”

41.10 “Referuar rekomandimeve të bankës {...} u hartuan kontratat e shitjes me familjarët e mi (babai, nëna dhe vëllai), respektivisht : (i) kontratën e shitblerjes me nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, midis shitësave (R., S. dhe E.K.) dhe unë në pozicionin e blerësit, për blerjen e pronës prej 3440 m², me nr.pasurie {...}, lloji pasurisë arë, në **shumën 50,000 euro**, duke e lënë të lirë nga ky moment (pronë e cila do të vihej kolateral); (ii) kontratën e shit-blerjes me nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, midis shitësave (R., S. dhe E.K.) dhe unë në pozicionin e blerësit, për blerjen e pronës prej 1450 m², me numër pasuri 35/30, lloji pasurisë arë, në shumën 300,000 lekë, duke e lënë të lirë nga ky moment”.

41.11 “Gjatë shqyrtimit të aplikimit për kredinë nga komiteti i miratimit të kredive në bankë, u informova se Banka {...} nuk ishte plotësisht e bindur për kolateralin tokë arë, për shkak të llojit tokë bujqësore dhe kërkonte që të formalizohej kontrata e sipërmarrjes midis palëve, për apartamentin për të cilin kërkohet kredia”.

41.12 “Për këtë arsye, në datë 8.09.2006 (i) u nënshkrua zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2003 të lidhur nga R.K. (fillimisht ky apartament është porositur nga shtetasi R.K. me kontratë sipërmarrje me nr.3247/732, datë 21.08.2003, midis tij dhe firmës “{...}” sh.p.k. Zoti R.K. ndërron jetë në mars të vitit 2006 dhe trashëgimtarët e tij donin ta shisnin këtë apartament) nga trashëgimtarët ligjorë të R.K. dhe firmës {...} sh.p.k; (ii) pas zgjidhjes së kontratës dhe kalimin e të drejtave tek unë dhe bashkshorti im, ne firmosëm kontratën e sipërmarrjes me firmën “{...}” sh.p.k, po në të njëjtën datë 08.09.2006, (pra, u zëvendësua porositësi)”.

41.13. “Për më tej, unë nuk e posedoja apartamentin nga data 08.09.2006, pasi nuk ishte disbursuar akoma kredia e miratuar nga {...} Bank. Unë kam filluar të banoj në këtë apartament në muajt tetor-nëntor të vitit 2006, ç’ka vërtetohet nga regjistrimi i kontratës me OSHEE për lidhjen e kontratës së funizimit me energji elektrike, e cila ka filluar në datë 29 nëntor 2006”.

41.14. “Lidhur me kontratën shitblerjes me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, me palë shitëse R.K., S.K., E.K. dhe me palë blerëse E.Ç., për pronën me sipërfaqe 3440 m², unë kam qenë në cilësinë e blerësit në këtë kontratë të cilën e kam firmosur në datë {...}, para noterit Luljeta Kongoli, me çmim 50,000 euro. Kjo kontratë ka si shitësa familjarët e mi (babain, nënën dhe vëllain) dhe është bërë kontratë shitje sipas kërkesave të bankës {...}, **me qëllim që të vihej kolateral për marrjen e një shume kredie prej 35 000 eurosh pranë kësaj banke**”.

41.15. “Në lidhje me kontratën e cila rezulton e dorëzuar pranë ZVRPP Kavajë, me të njëjtin numër repertori, kolektori, date, palë, objekti, por me një çmim të ndryshëm nga kontrata që disponoj unë të noterizuar nga i njëjti noter, Luljeta Kongoli dhe që i është depozituar dhe Bankës {...} për marrje kredie, duket që mund të jetë një ngatërrësë e paqëllimtë në faqosjen e kontratës dhe dokumentat bashkalidhur, duke vendosur gabimisht fletën e dytë të kontratës shitblerjes së pronës me sipërfaqe 1450 m², e cila ka çmimin 300 000 lekë dhe që është nënshkruar në të njëjtin moment”.

41.16. “Në momentin e firmosjes së të gjitha kopjeve të përgatitura nga noterit, kam prezumuar që të gjitha kopjet ishin njëjloj, pa kontrolluar vetë secilën faqe të çdo kopje...”

41.17. “Duke qenë se aplikimi në ish-ZVRPP Kavajë për regjistrimin e kontratës, nuk është bërë personalisht nga ana ime, nuk i është kushtuar rëndësi dokumentacionit të dorëzuar. [...]”.

42. Mbi faktet e mësipërme dhe gjendjen e provave, Prokuroria e Posaçme e akuzon të pandehurën E.Ç. (shih njoftimin e akuzës):

42.1. Për veprën penale të “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, duke i atribuar: elementin e *deklarimit të rremë* në deklaratën e vitit 2017, para fillimit të detyrës, në rubrikën “*Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit*”, në lidhje me burimin e blerjes së apartamentit të banimit, duke deklaruar se ka burimin nga paga. *Ajo nuk ka pasur mundësi financiare për ta blerë këtë apartament bashkë me pronat e tjera të deklarara të blera po në këtë vit. Sipas akuzës, kjo ndërthuret me deklarimin e rremë lidhur me burimin e blerjes së tokës arë, në të njëjtën rubrikë “*Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit*”, lidhur me burimin e blerjes së tokës arë me sipërfaqe 1450 në shumën 300,000 lekë, të deklaruar si të ardhur nga paga dhe të pasurisë tjetër tokë arë, me sipërfaqe 3440 m², në shumën 50000 euro, të deklaruar si të blerë me burim një kredi të marrë dhe pjesa tjetër me të ardhurat nga paga. Gjithashtu, deklarimi i rremë, sipas akuzës ka vijuar në deklarimin e pasurisë në vitet 2018, 2019 dhe 2020 në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, ku ka pasqyruar se ka marrë kredi për blerje toke me sipërfaqe 3440 m², pasi në fakt sipas akuzës, qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë për blerjen e apartamentit, duke e çuar kështu në përputhje me deklarimin e vitit 2017.*

42.2. Për veprën penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Sipas akuzës, e pandehura e ka kryer veprën penale në formën e *përdorimit* të dokumentit, kontratës së shitblerjes nr.{...} rep, nr.{...} kol, datë {...} (data 10 e korigjuar), për shitblerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, si *falsifikim intelektual*, në lidhje me çmimin e blerjes dhe faktin që kjo tokë është blerë. Kjo vepër, sipas akuzës, qëndron e shkëputur nga deklarimi i rremë, pasi është kryer në një moment të mëvonshëm nga bërja e deklarimit, pra, më datë 17.07.2017. Kjo kontratë është e falsifikuar, për shkak se nuk përputhet me ato të dorëzuara në ASHK dhe të ruajtura në arkivën e noteres, për sa i përket çmimit të vendosur në të, si dhe në lidhje me faktin se tokat në fakt nuk janë blerë. Në vijim, në aktin e njoftimit të akuzës, parashtrohet se: “*Deklarimi i rremë dhe falsifikimi në rastin konkret, siç mund të konstatohet konfigurohen si pasojë e falsitetit ideologjik, duke pasqyruar në akte publike, një situatë të ndryshme nga realja, ku subjekti për shkak të funksionit, ka pasur detyrimin për të deklaruar të vërtetën*”.

IV. Vlerësimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

IV.A Në lidhje me mungesën e rrethanave të parashikuara nga neni 428, pika 1, shkronja “ç” të K.Pr.Penale, në vështrim të rrethanave specifike të çështjes dhe shkaqeve të ankimit.

43. Duke qenë se: (i) në gjykimin në shkallë të parë dhe në seancë paraprake nuk është thirrur (SH.A.A.SH), mbi kallëzimin e të cilës është regjistruar procedimi penal; (ii) meqenëse mosthirrja në seancën e parë gjyqësore të kallëzuesit, nëse rezulton edhe viktimë, sipas nenit 58, pika 1 shkronja “h” të K.Pr.Penale⁸, passjell pavlefshmërinë absolute të aktit procedural, vendimit përfundimtar,

⁸ Neni 58, pika 1 shkronja “h” e K.Pr.Penale: “Viktima e veprës penale ka të drejtë: të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore”

në referim të nenit 128/a, pika 1, shkronja “c” të K.Pr.Penale⁹; (iii) meqenëse kjo rrethanë përbën një ndër rastet e përfshira në nenin 428, pika 1, shkronja “ç” të K.Pr.Penale¹⁰ për prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë, pasi një dispozitë e veçantë procedurale (neni 128/a, pika 1 shkronja “c” në lidhje me nenin 58, pika 1 shkronja “h” të K.Pr.Penale) ka parashikuar pavlefshmërinë absolute të aktit procedural, vendim gjyqësor, rrethanë kjo që përfshihet në “*për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht*”, sipas nenit 425, pika 1 të K.Pr.Penale¹¹; (iv) meqenëse ky moment lidhet edhe me disponimin e këtij kolegji në seancën gjyqësore të datës 25.11.2022 për moslegjitimin si palë edhe në gjykimin në apel të (paragrafi 8.1. i këtij vendimi), *atëherë ky kolegji arsyeton, në vijim, se pse pala kallëzuese nuk rezulton të jetë viktimë në procesin penal në fjalë.*

44. Fillimisht, vihet në dukje fakti se njoftimi i SH.A.A në gjykimin në apel u bë për shkak të faktit se kishte paraqitur ankim ndaj vendimit nr.48, datë 16.09.2022, edhe nga ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit u disponua, sikurse u përshkrua në paragrafët 8.1; 8.2, 8.3 të këtij vendimi¹².

44.1. Në Kodin e Procedurës Penale nuk jepet përkufizimi *i viktimitës*, por jepen vetëm të drejtat e viktimitës, të drejtat e viktimitës së mitur dhe të drejtat e viktimitës së abuzuar seksualisht dhe të viktimitës së trafikimit të qënieve njerëzore (përkatësisht në nenet 58, 58/a dhe 58/b të K.Pr.Penale). Sipas Direktivës 2012/29 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012 “Për vendosjen e standarteve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit” (që zëvendësoi Vendimin Kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave ne procedimet penale), “*viktimitë e veprës penale*” konsiderohet, *personi fizik që ka pësuar një dëm fizik, mendor, ose emocional ose humbje ekonomike nga një veprë penale dhe anëtarët e familjes së një personi, vdekja e të cilit është shkaktuar direkt nga një veprë penale dhe që ka pësuar një dëm për shkak të vdekjes së atij personi* (neni 2, pika 1 shkronja “a”, pikat i dhe ii.). Direktiva respekton të drejtat themelore dhe merr parasysh parimet e njohura nga Karta për të Drejtat Fundamentale të Unionit Evropian. Ajo respekton të drejtat themelore dhe merr parasysh parimet e njohura nga Karta për të Drejtat Fundamentale të Unionit Evropian.

Ndërsa sipas Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit, e vitit 1985: “... *viktimat nënkuptojnë personat të cilët, individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar lëndime, duke përfshirë këtu edhe lëndimet fizike apo mentale pësimet emocionale, humbjet ekonomike apo keqësimin substancial të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo moskryerjes së tyre, të cilat paraqesin shkelje të ligjeve penale në fuqi në kuadër të shteteve anëtare, duke përfshirë edhe ligjet të cilat ndikojnë në keqpërdorimin e pushtetit*”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (Gjykata e Luksemburgut), gjatë shqyrtimit të çështjeve paraprake për interpretim, ka konfirmuar se koncepti i viktimitës për qëllime të Direktivës së BE-së, nuk

⁹Neni 128/a, pika 1 shkronja “c” e K.Pr.Penale: “Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: c. **thirrjen** e të pandehurit, **viktimitës** ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme.

¹⁰Neni 428, pika 1, shkronja “ç” e K.Pr.Penale: “Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos: Ç. prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimitës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, **si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit**”.

¹¹Neni 425, pika 1 i K.Pr.Penale: “Kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në apel”: “Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtpandehurve që nuk kanë bërë apel.

¹² Shih dhe vendimin e arsytuar.

përfshin personat juridikë që kanë pësuar dëm direkt nga shkeljet e ligjit penal të një Shteti Anëtar (C-467/05, Dell’Orto, C-205/09, Eredics). Pra vendimi Kuadër prek vetëm detyrimet për personat fizikë të cilët janë viktime të veprave penale, ndërsa personat juridikë si viktime përjashtohen nga fushëveprimi i Vendimit Kuadër dhe rrjedhimisht nga ligji i Bashkimit Evropian¹³ (Direktiva 2012/29 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012 zëvendësoi Vendimin Kuadër të 15 marsit 2001).

Megjithatë, sipas Udhëzuesit të Komisionit Evropian për zbatimin e kësaj direktive, shtetet anëtare mund të zgjedhin të zbatojnë edhe për personat juridikë standartet e përcaktuara në Direktivë.

44.2. Në vendimin unifikues nr.2, datë 02.06.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë mbajtur këtë qëndrim:

“Një kriter dallues, ekzistenca e të cilit duket se zgjeron të drejtat e personave që legjitimohen për të bërë ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës është, pikërisht, dallimi ndërmjet figurës së kallëzuesit dhe asaj të të dëmtuarit. Kallëzimi është një akt i një natyre të ndryshme nga ajo e kërkesës ankimore e të dëmtuarit nga vepra penale, jo vetëm për shkak të subjektit, por edhe për objektin dhe qëllimin që kanë këto dy institute të procedurës penale. Kallëzuesi është një person, i cili jo domosdoshmërisht është i prekur apo i cenuar nga vepra penale, prandaj i dëmtuari mund të jetë kallëzues, por nuk është gjithmonë e vërtetë e anasjellta. Kallëzimi mund të paraqitet nga një rreth më i gjerë personash, shtetasish privatë, personash juridikë, zyrtarësh publikë, madje edhe nga vetë personi i dyshuar si autor dhe në disa raste ai është i detyrueshëm. Nëpërmjet kallëzimit raportohet vetëm dijenia rreth ndodhjes së një veprë penale që ka ngjarë dhe që kallëzuesi ka rënë në dijeni për shkaqe të ndryshme rreth saj. Ndërsa, nëpërmjet kërkesës (ankimit) së të dëmtuarit, përveç njoftimit të faktit të veprës penale, shprehet vullneti i të dëmtuarit për të proceduar me gjykimin e personit autor të veprës penale, si dhe manifestohet vullneti i tij për ushtrimin e ndjekjes penale. Vetëm të dëmtuarit nga vepra penale kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit, duke u “ankuar” në organet që ushtrojnë ndjekjen penale ose duke paraqitur “kërkesë në gjykatë” për rastet e parashikuara nga neni 59 i K.Pr.Penale. Në bazë të nenit 283 të K.Pr.Penale, çdo person që merr dijeni për një veprë penale që ndiqet kryesisht ka detyrimin për ta kallëzuar atë, pavarësisht se është i dëmtuar ose jo nga vepra penale. Po kështu, në bazë të neneve 281- 282 të K.Pr.Penale, është parashikuar detyrimi i nëpunësit publik dhe personelit mjekësor për të bërë kallëzim kur vihen në dijeni rreth një veprë për shkak të detyrës që ata kryejnë.

*30. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke qartësuar arrijnë në konkluzionin njësoj se: **të drejtën për të paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes penale, e ka vetëm personi i dëmtuar nga vepra penale, subjekt ky që mund të jetë njëherazi edhe kallëzues, por kallëzuesit që nuk janë të dëmtuar nga vepra penale nuk legjitimohen nga ligji procedural penal të ushtrojnë të drejtën e ankimit sipas nenit 329 të K.Pr.Penale... ”.***

Gjithnjë sipas vendimit unifikues nr.2, datë 02. 06.2013 (paragrafi 26):

*“...**personi i dëmtuar** është titullari i interesit juridik të mbrojtur nga norma penale, në vartësi të llojit të veprës penale, marrëdhënies dhe të mirës juridike që mbrohet nga e drejta penale... (...) **...I dëmtuari** është personi fizik i cili është i lënduar në trupin e tij, i dëmtuar në shëndetin e tij, i dëmtuar për shkak të cenimit të së drejtave dhe lirive themelore, prekja dhe kufizimi i të cilave, mbrohet nga norma penale, i cenuar në moralin e tij dhe të familjes, etj....*

¹³ Shih dhe: “OPINION OF ADVOCATE GENERAL KOKOTT delivered on 1 July 2010 (1) Case C-205/09”.

...I dëmtuar mund të jetë edhe personi juridik, të cilit vepra penale ika cënuar interesa pasurore të drejtpërdrejta në raport me veprimtarinë që ai ushtron».

44.3. Marrë në konsideratë jurisprudencën unifikuese të mësipërme të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimin nr.02, datë 20.06.2013), Direktivën 2012/29 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012 “Për vendosjen e standarteve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit”, praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë mbi këtë Direktivë dhe vendimin Kuadër që e ka zëvendësuar atë, si dhe faktin që legjislacioni procedural penal nuk e përjashton në mënyrë të shprehur personin juridik nga mundësia e të qënurit viktimë në një proces penal, **ky kolegji vlerëson**, fillimisht, se personi juridik edhe mund të ketë këtë status. Megjithatë, për t’u konsideruar një person juridik “viktimë” duhet t’i referohemi situatës së pranuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pra, që *subjektit juridik t’i jenë cënuar nga vepra penale interesa pasurore të drejtpërdrejta në raport me veprimtarinë që ai ushtron dhe njëherazi, të jetë titullari i interesit juridik të mbrojtur nga norma penale, në vartësi të llojit të veprës penale, marrëdhënies dhe të mirës juridike që mbrohet nga e drejta penale.*

44.3.1. Nga ana tjetër, referuar vendimit unifikues nr.2, datë 02. 06.2013, rezulton se të drejtën për të paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes penale, e ka **vetëm** personi i dëmtuar nga vepra penale, subjekt ky që mund të jetë njëherazi edhe kallëzues, por kallëzuesit që nuk janë të dëmtuar nga vepra penale, nuk legjitimohen nga ligji procedural penal të ushtrojnë të drejtën e ankimit sipas nenit 329 të Kodi i Procedurës Penale. Ky kolegji konstaton se, edhe ndryshimet që janë bërë në K.Pr.Penale me ligjin nr.35/2017 lidhur me ridimensionimin e rolit të të dëmtuarit, duke e konsideruar tashmë me emrin “viktimë”, nuk e kanë barazuar statusin e tij me atë të kallëzuesit. Në vështrim të nenit 280 “Marrja dijeni për veprën penale”; nenit 281 “Kallëzimi nga nëpunësit publikë”, nenit 282 “Kallëzimi nga personeli mjekësor”, nenit 283, “Kallëzimi nga ana e shtetasve”, kallëzuesi është një person, i cili jo domosdoshmërisht është i prekur apo i cënuar nga vepra penale. Kallëzimi mund të paraqitet nga një rreth më i gjerë personash, shtetasish privatë, personash juridikë, zyrtarësh publikë, madje edhe nga vetë personi i dyshuar si autor. Nëpërmjet kallëzimit raportohet vetëm dijenia rreth ndodhjes së një vepre penale që ka ngjarë dhe që kallëzuesi ka rënë në dijeni për shkaqe të ndryshme rreth saj.

44.4. Ky kolegji merr në konsideratë edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr.64, datë 03.06.2022, ku paraqitet një situatë e ngjashme (që i përket periudhës kohore kur kishin hyrë në fuqi ndryshimet në K.Pr.Penale që zëvendësuan dispozitat mbi të dëmtuarin nga vepra penale me viktimën), ku kallëzuesi F.D kishte kallëzuar një sërë subjektësh, gjyqtarë e prokurorë, ndër të tjera (vepra penale që ndiqen kryesisht nga organi procedues) edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 257 shkronja “a” të Kodit Penal (sikurse e pandehura E.Ç.). Konkretisht, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se:

I. “Kërkuesi ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) për 20 subjekte, ish-gjyqtarë dhe ish-prokurorë për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, shkronja “a”, pika 6, 180, 181, 248 dhe 257 shkronja “a” të Kodit Penal (KP).

II. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në jurisprudencën e saj, ka garantuar të drejtën e çdo individi për t’iu drejtuar asaj në rast se pretendon që është viktimë e shkeljes së të drejtave të parashikuara nga KEDNJ-ja. Ajo e ka përkufizuar nocionin e “viktimës” si individi që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga një shkelje që shkakton një dëm ose ka një interes personal për riparimin e saj (shih vendimin Vallianatos dhe të tjerë kundër

Greqisë [DHM], § 47, të GJEDNJ-së). GJEDNJ-ja nuk ka pranuar legjitimimin ratione personae të individit, nëse ai nuk ka arritur të provojë statusin e tij si viktimë, si për shembull në rastin kur ky i fundit nuk ka arritur të vërtetojë se “është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë” nga masa të cilën kundërshton (shih vendimin për papranueshmëri Katai kundër Hungarisë, 18 mars 2014 dhe vendimin Trivkanović kundër Kroacisë, 6 korrik 2017 të GJEDNJ-së).

44.5. Në tërësi të sa më lart, koncepti “viktimë” dhe “kallëzues” nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë. Vetëm viktimës i garantohen të drejtat e përcaktuara në K.Pr.Penale dhe jo kallëzuesit që nuk ka veçoritë e viktimës. Në rastin konkret, statusi i kallëzuesit, Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptar, që ka paraqitur kallëzim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 186, 257/a dhe 287, vepra këto që ndiqen edhe kryesisht nga organi procedues, nuk ndryshon nga ai i çdo individit që paraqet një kallëzim penal për një vepër penale për të cilën nuk preket në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo shoqatë nuk përfaqëson një person juridik, të cilit i është shkelur ose i është rrezikuar çfarëdo e drejte pasurore lidhur me faktet e kallëzuara dhe, më tej, në kuadër të ushtrimit të ndjekes penale nga prokurori, është marrë e pandehur e kallëzuara/e pandehura E.Ç. dhe aq më pak kjo shoqatë të jetë *titullari i interesit juridik të mbrojtur nga norma penale në fjalë*, sikurse argumentojnë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. nr.2, datë 02.06.2013 (paragrafi 44.2. i këtij vendimi).

44.6. Gjatë gjykimit në apel, në seancën gjyqësore të datës 11.11.2022, në funksion të kërkimi për t’u legjitimuar në gjykimin në apel dhe në funksion të legjitimitimit të Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptar për të paraqitur ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, përfaqësuesi i kësaj shoqate, duke iu referuar një seance pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku ai kishte qenë avokati i një subjekti rivlerësimi, u shpreh se ish-in kryer ndaj tij veprime të paligjshme duke u nxjerrë jashtë avokatët forcërisht në ditën e shpalljes së vendimit dhe se fyerja e avokatëve nuk ishte trajtuar nga organi i akuzës. Në fakt, referuar kallëzimit penal të paraqitur në emër të shoqatës (nënshkruar nga avokati si përfaqësues i saj me vulën e Shoqatës), protokolluar në Prokurorinë e Posaçme me numër kallëzimi 21, datë 30.06.2021, rrethana të tilla, të parashtruara nga përfaqësuesi i shoqatës, nuk rezultojnë të kallëzuara.

44.7. Në konkluzion, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk janë shkelur dispozitat e përmendura në paragrafin 43 të këtij vendimi të lidhura ngushtësisht me garantimin e të drejtave të viktimës në një proces penal, rrethanë kjo që do të çonte në pavlefshmërinë e vendimit përfundimtar me nr.48, datë 16.09.2022 dhe, për pasojë, në prishjen e tij dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë.

45. Në lidhje me shkaqet e ankimit të prokurorit të posaçëm, që në mbështetje të nenit 17, gërma “ë”, 427, 428 gërmat “b”, “ç” të K. Pr. Penale, kërkon ndryshimin e vendimit nr.315, datë 17.07.2022, duke u pranuar kërkesa e prokurorit me objekt përjashtimi i gjyqtarit Erjon Bani, nga shqyrtimi në seancë paraprake të kërkesës për dërgimin çështjes për gjykim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë dhe, për pasojë, në respektim të nenit 428 gërma “ç”, prishjen e vendimit përfundimtar nr.48, datë 16.09.2022 dhe kthimi për rigjykim i çështjes, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë.

45.1. Ky kolegji arsyeton fillimisht se, mospasja e kushteve për të qenë gjyqtar në një çështje konkrete, përbën një ndër rastet e përfshira në nenin 428, pika 1, shkronja “ç” të K.Pr.Penale, me pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë kështu, ankimi ndaj vendimit të gjyqtarit që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit (ndaj të cilit

bëjet ankim së bashku me vendimin përfundimtar sipas nenit 22, pika 4 të K.Pr.Penale), **përbën pjesë integrale të qëndrimit që duhet të mbajë ky kolegji mbi shkaku e ankimit për prishjen e vendimit përfundimtar me nr.48, datë 16.09.2022**, për rrethanën “nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete”. Për pasojë, nuk është e nevojshme që ky kolegji të shprehet veçmas në një pikë të dispozitivit mbi vendimin nr.315, datë 17.07.2022, vendim të cilin e gjen të mirëargumentuar dhe në përputhje me dispozitat procedurale penale që rregullojnë shkaqet dhe rrethanat e papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në një procedim.

45.2. Në vendimin nr.315, datë 17.07.2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, ndër të tjera, ka arsyetuar:

“Çështja në fjalë ka të bëjë, pikërisht, me vënien në diskutim të paanshmërisë së gjyqtarit për shkak se e pandehura në këtë rast, çështjen e së cilës ka për gjykim gjyqtari Erjon Bani në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, më herët ka qenë anëtare e trupës së KPK-së që ka konfirmuar atë në detyrë (në unanimitet) në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Në vlerësim të kërkesës, Prokurorisë së Posaçme, gjyqtari Erjon Bani duke qenë gjyqtar i çështjes në fjalë cenon parimin e gjykimit nga një gjyqtar i paanshëm, për shkak se në dukje ai nuk mund të jetë i paanshëm, për sa kohë e pandehura e ka "gjykuar" atë më parë lidhur me tre kriteret e vlerësimit, përfshirë edhe atë të pasurisë, sikurse sot është sjellë për gjykim vetë e pandehura E.Ç. lidhur me deklaratimet e bëra nga vetë ajo në ILDKPKI.

Në vlerësim të Gjykatës, shkaku i referuar nga ana e kërkesës, duke pretenduar se në këtë rast gjyqtari Erjon Bani nuk garanton paanshmërinë në dukje të gjyqtarit për shkak se ka një konflikt interesi në dukje për gjyqtarin, nuk gjendet i bazuar nga ana e Gjykatës, pasi nuk është i tillë që të kualifikohet në rrethana të rëndësishme njëanshmërie, referuar gërmës "ë" të nenit 17 të K.Pr.Penale.

Rezulton e provuar se, procesi i rivlerësimit kalimtar ndaj gjyqtarit Erjon Bani, është finalizuar me vendimin nr.390 vendimi, datë 24.5.2021 të KPK-së, i cili është bërë përfundimtar më datë 07.07.2021, pa iu nënshtruar ankimit nga ana e Institucionit të Komisionerit Publik. Ky vendim rezulton të jetë marrë në unanimitet nga ana e trupës së komisionerëve të KPK-së.

*Në këto rrethana, Gjykata çmon se gjyqtari Erjon Bani nuk gjendet në konflikt interesi për të gjykuar çështjen në fjalë, pasi ai nuk ka asnjë interes personal ndaj të pandehurës E.Ç. në këtë gjykim, për sa kohë e pandehura ka kryer një detyrë kushtetuese ndaj tij në kohën kur e ka pas një detyrim të tillë. Gjyqtari në fjalë i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në respektim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore e tashmë për të ka një vendim përfundimtar i cili nuk mund të vihet në diskutim, **vendim që është bërë përfundimtar rreth 1 (një) vit më parë.** Në vlerësim të Gjykatës, të pranosh një shkak të tillë si përjashtim për gjyqtarin sikurse shkaku që parashtron Prokuroria e Posaçme, minon pikërisht shtetin e së drejtës dhe perceptimin e besimit të njerëzve tek drejtësia, e mbi të gjitha edhe tek reforma në drejtësi, nëpërmjet procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Secila nga palët, në ushtrim të funksionit që ka, duhet të respektojnë Kushtetutën dhe ligjin. Ushtrimi i funksionit bëhet marrë në konsideratë faktin se secili mban përgjegjësi personale para ligjit dhe të gjithë janë të barabartë para ligjit. Pra, ushtrimi i funksionit dhe i detyrave të ngarkuara nga ligji në një moment të caktuar nga ana e një subjekti, pale apo e gjyqtarit, nuk vlerësohet nga kjo Gjykatë si një rrethanë që ngre pikëpyetje lidhur me paanshmërinë e palëve në një proces, pa u lidhur dhe pa u shoqëruar me ndonjë rrethanë apo sjellje tjetër të evidentuar ose të dyshimtë. Për sa kohë, shkaku në fjalë nuk është personal, aktual dhe as i tillë për nga rëndësia që të vendosë në dyshim objektivitetin e paanshmërinë e gjyqtarit Erjon Bani, kërkesa për përjashtime paraqitur ndaj tij rrëzohet nga Gjykata si e pabazuar në ligj e në prova. [...]*

45.3. Duke mbështetur arsyetimin e mësipërm dhe duke gjetur të pabazë shkakun e ankimit të prokurorit të posaçëm se nga ana e gjykatës nuk është arsyetuar përse tek prokurori apo publiku nuk perceptohet ekzistenca e konfliktit të interesit në dukje të gjyqtarit Erjon Bani me të pandehurën E.Ç., ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit e kthen vëmendjen në dispozitave procedurale penale që parashikojnë papajtueshmëritë dhe konkretisht: neni 15 i K.Pr.Penale, parashikon shkaqet e papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim; neni 16 i K.Pr.Penale, shkaqe të papajtueshmërisë për arsye lidhje familjare, gjinie apo krushqije dhe neni 18 i K.Pr.Penale që parashikon përjashtimin e gjyqtarit, pika 1, shkronja “b” parashikon: “kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet dhe rrethanat objekt procedimi”. Ndërsa në nenin 17 i K.Pr.Penale parashikohen situatat kur gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete. Në shkronjën “ë” të nenit 17 është parashikuar se, një ndër shkaqet kur gjyqtari duhet të heqë dorë është “kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie” dhe, pikërisht, në rastin konkret, konflikti në dukje i interesit, sipas prokurores, është një shkak i rëndësishëm njëanshmërie në kuptim të këtij parashikimi.

45.4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e konsoliduar të saj ka elaboruar se “Gjykata e caktuar me ligj”, në kuptim të nenit 6 pika 1, lidhet jo vetëm me legjislacionin e brendshëm për krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore (*Lavents* kundër Letonisë, 28 nëntor 2002; *Richert* kundër Polonisë, 25 tetor 2011; *Jorgic* kundër Gjermanisë nr.74613/01, GJEDNJ 2007-III), por edhe me çdo dispozitë tjetër të së drejtës së brendshme, mosrespektimi i së cilës e bën të parregullt pjesëmarrjen e një apo disa gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjes (*Pandjigidzé* e të tjerë kundër Gjeorgjisë nr.30323/02, 27 tetor 2009). Shprehja “e krijuar me ligj” ka të bëjë jo vetëm me bazën ligjore të vetë ekzistencës së “gjykatës”, por edhe me respektimin nga gjykata të normave të posaçme që rregullojnë funksionimin e saj, si edhe me përbërjen e trupit gjykues në secilën çështje (*Posokhov* kundër Rosisë nr. 63486/00, GJEDNJ 2003-IV; *Fatullayev* kundër Azerbajxhanit nr.40984/07, 22 prill 2010; *Kontalexis* kundër Greqisë nr.59000/08, 31 maj 2011). Kjo praktikë e GJEDNJ-së është reflektuar dhe vendimin nr.2, datë 24.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që kanë arritur në përfundimin unifikues se: “... Duke qenë se çënojnë drejtpërdrejt dhe në thelb parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës) dhe të drejtën e njeriut për t’u gjykuar nga një gjykatë “e caktuar me ligj” (nenet 15 dhe 42/2), përbën cënim të procesit të rregullt ligjor thjesht dhe vetëm shkëlja e rregullave normative që parashikohen nga ligji për mënyrën e formimit të rregullt të përbërjes nominative të gjykatës në çështjen konkrete. Në kuptim të zbatimit të drejtë të nenit 128, pika 1, shkronja “a” të K.Pr.Penale, aktet e nxjerra nga ajo gjykatë dhe vendimet e dhëna prej saj janë absolutisht të pavlefshme....” (citim).

45.5. Koncepti i “gjykatës së paanshme dhe të pavarur” në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, apo nenit 6 pika 1 të Konventës, duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit, nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa nuk ka provë të kundërt (përmendet këtu vendimi i GJEDNJ-së, *Hauschildt* kundër Danimarkës 24 maj 1989, seria A). Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se, veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet, nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (vendimet nr.7, datë 11.03.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese të RSH).

45.6. Në vlerësim të Gjykatës së Posaçme të Apelit, të qënurit e gjyqtarit, subjekt rivlerësimi kalimtar nga komisionerët e KPK-së (në përbërje të kolegjit) apo anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilët përmbushin detyrat në përputhje me Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, **nuk vë në dyshim apriori** paanshmërinë e gjyqtarit për të gjykuar gjatë gjithë fazave të procedimit penal çështjet/procedimet, kur subjekt i kallëzuar/i hetuar/person që i atribuohet vepra penale/i pandehur, është një ndër ta dhe kjo nuk e vendos gjyqtarin (automatikisht) në gjendjen e konfliktit të interesit në dukje.

45.7. Në këndvështrimin e të qënurit të gjyqtarit në konflikt interesi të parashtruar si shkak ankimi, kjo gjykatë vlerëson t’i referohet vendimit nr.2 datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë çështjes, objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese ishte ligji nr.84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku për efekt të zbatimit të tij, ky ligj shtrihej edhe tek anëtarët e kësaj gjykate. Kjo gjykatë ka ngritur kryesisht vlerësimin, nëse pjesëmarrja e tyre në shqyrtimin e kësaj çështjeje konsiderohet si një rast i konfliktit të interesave dhe është shprehur se: “9. Në çështjen për vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr.10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, Gjykata është shprehur se sipas nenit 133/2 të Kushtetutës ajo vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, ndërsa sipas nenit 32/1 të ligjit organik në seancë plenare duhet të jenë të pranishëm jo më pak dy të tretat e anëtarëve (6 anëtarë). Për rrjedhojë, përjashtimi i gjyqtarëve do të çonte në mosarritjen e numrit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare (kuorumit) nga Gjykata dhe ajo do të bllokohej për të vazhduar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit të kundërshtuar (shih vendimin nr.9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

10. Gjykata vlerëson se në raste të tilla duhet të sigurohet që ajo të vazhdojë të funksionojë si një institucion demokratik dhe se mundësia e mosmarrjes pjesë në gjykim e gjyqtarëve nuk duhet të rezultojë në pamundësinë e Gjykatës për të marrë një vendim. Për sa kohë që ligjvënësi nuk parashikoi një zgjidhje për të tejkaluar një bllokim të tillë të mundshëm, i cili mund të sillte si pasojë që ligji i kundërshtuar të mos i nënshtrohej kontrollit të kushtetutshmërisë së tij, si edhe në kushtet kur ekziston prezumimi se gjyqtarët e Gjykatës veprojnë në mirëbesim, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka asnjë pengesë ligjore për marrjen në shqyrtim të pretendimeve të paraqitura para saj...”.

45.8. Duke vijuar arsyetimin, për analogji të sa më lart, të pranuarit *apriori* të konfliktit të interesit të gjyqtarit në gjykatat e posaçme, me subjektet e hetuar, apo kallëzuar, komisionerë të KPK-së (në përbërje të kolegjit) apo anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA) që kanë marrë pjesë në procesin e rivlerësimit kalimtar të magjistratit, vetëm për këtë fakt, në kushtet kur vetë dispozita procedurale penale, neni 75/a i K.Pr.Penale, ka përfshirë në juridiksionin e gjykatave të posaçme **edhe këtë kategori subjektesh**, kjo do të sillte shmangie nga qëllimi i ligjit. Pra, do të sillte shmangie nga shtrirja e juridiksionit të posaçëm të këtyre subjekteve, pasi e kundërta shpesh mund të sillte bllokim të punës në këtë gjykatë. Njëherazi, vetë ligjvënësi ka kapërcyer një rrethanë të tillë, pasi ka qenë i vetëdijshëm që edhe magjistratët e këtyre strukturave të posaçme duhet të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe (sërish) një kompetencë të tillë për gjykimin e këtyre subjekteve, ua ka kaluar gjykatave të posaçme, duke marrë parasysh se (edhe këtu) *ekziston prezumimi i pranuar se gjyqtarët veprojnë në mirëbesim* (Opinion i Amicus Curie i Komisionit të

Venecies për ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”¹⁴), pra, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet.

45.9. Shkaqe e ngritura në ankim nga prokurorja, në funksion të kundërshtimit të vendimit gjyqësor që ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit dhe, për pasojë, në funksion edhe të shkakut të ankimit për prishjen së vendimit përfundimtar, si:

i. Mënyra e zhvillimit të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kriteret mbi të cilat mbështetet ky proces, krijojnë konflikt interesi në dukje, referuar sjelljes së kryer nga e pandehura, të lindura si pasojë e funksionit të saj si anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në ndërthurje me faktin se në kuadrin e këtij funksioni ajo ka hetuar edhe gjykuar vetë gjyqtarin Erjon Bani, ndër të tjera dhe deklaratimet e tij të pasurisë;

ii. E pandehura, ndër të tjera, është sjellë për gjykim, pasi është akuzuar për veprën penale të “Refuzim për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë i K.Penal. Subjektet e rivlerësimit, janë hetuar dhe gjykuar nga KPK, pikërisht, gjithashtu edhe për pasuritë e tyre referuar deklaratave që ata, ashtu si e pandehura, tashmë kishin dorëzuar në ILDKPKI, qoftë në kuadrin e procesit të rivlerësimit, ashtu edhe të deklaratave vjetore;

iii. Perceptimi tek të tretët i faktit se i gjykuari (pra, gjyqtari Erjon Bani), gjykon gjykuesen e vet, pra, të pandehurën E.Ç.”;

gjenden nga ky kolegji të pabazuara (pikat e mësipërme *i*, *ii*, *ii*) dhe të pamundura për të sjellë konkluzionin se gjyqtari gjendet në rrethanën e shkronjën “ë” të nenit 17 të K.Pr.Penale: “*kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie*”. Ato janë vetëm një përqasje apo krahasim ndërmjet procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve (procesin Vetting) me procesin penal të të pandehurës/komisioneres E.Ç., meqenëse, sipas palës ankuese, kanë të bëjnë me deklaratat e deklarimit të pasurisë, që, si e pandehura dhe gjyqtari, kanë dorëzuar në ILDKPKI dhe nuk silltet asnjë argument se pse rrethana e pretenduar përfshihet në rastet e nenit 5, pika 1 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në funksionet publike”, dispozitë ku reflektohen situatat ku përmbahen, bazohen ose burojnë interesat privatë të zyrtarit.

45.10. Të konsideruarit të gjyqtarit në konflikt interesi në dukje në rastin konkret, nuk përputhet me përkufizimin e dhënë në nenin 3, pika 1 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në funksionet publike”, për gjendjen e konfliktit të interesit. Sipas këtij parashikimi, konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike. Sikurse u parashtrua edhe më lart, është neni 5, pika 1 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në funksionet publike” që jep situatat që përmbajnë, bazohen ose nga ku burojnë e interesat privatë të zyrtarit dhe rrethana në fjalë nuk përfshihet në asnjë nga këto interesa¹⁵. Nga ana tjetër, rrethana e konsideruar nga prokuroria e posaçme që e ka vënë

¹⁴ CDL-AD(2016)036 English 12/12/2016 - Public Albania - Amicus Curiae Brief for the Constitutional Court on the Laë on the Transitional Re-evaluation of Judges and Prosecutors (The Vetting Laë), adopted by the Venice Commission at its 109th Plenary Session (Venice, 9-10 December 2016); [http://ëëë.venice.coe.int/ëëbforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](http://ëëë.venice.coe.int/ëëbforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

¹⁵ **Neni 5 Interesat privatë:** 1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata

gjqqtarin në gjendje konflikti interesi në dukje, **tashmë** nuk lidhet me **ndonjë interes** të gjyqtarit si zyrtar, pasi procesi i rivlerësimit kalimtar të tij ka përfunduar (prej më shumë se një viti e gjysëm) dhe nuk rezulton asnjë nga rrethanat nga shkronja “a” në shkronjën “dh” të pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës; d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare” (shkronja “e” e këtij neni referon tek paraardhëset: “angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni).

Elementi “**kohë**”, në verifikimin e ekzistencës së interesave që mund të konsiderohen privatë, në vlerësim edhe të këtij kolegji (sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë¹⁶), është shumë i rëndësishëm dhe, së bashku me elementë të tjerë, është përcaktues për të konkluduar në ndërthurjen e këtij interesi (interesi privat) me ushtrimin e një funksioni publik, ndërthurje që në rastin konkret, referuar analizës në mësipërme, nuk ekziston.

45.11. Ndër referencat që prokurorja e posaçme bën në mbështetje të argumentave se gjyqtari që ka gjykuar çështjen gjendet në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, janë dhe Parimet e Bangalores për Etikën Gjyqësore. Vihet re se, në ankim nuk jepet përkufizimi i dhënë në Komentarin e këtyre Parimeve për konfliktin e interesit, por referohet vetëm një situatë e dhënë në këtë komentari që nuk përkon aspak me situatën në fjalë.

45.12. Ky kolegji, duke iu referuar Komentarin të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësor (miratuar nga Grupi për Integritet Gjyqësor, Koment mbi Parimet e Bangalorit për Etikën Gjyqësore, mars 2007¹⁷) konstaton se nëpërmjet Parimeve të Bangalores synohet ruajtja dhe respektimi i vlerat kryesore integritetit gjyqësor si, pavarësia, paanësia, barazia, sjellja e duhur, integriteti personal, kompetenca dhe përkushtimi/zelli profesional. Në kuadër të paanshmërisë, si një ndër vlerat bazë të integritetit gjyqësor, në këtë komentari përcaktohet detyrimi që çdo gjykatës duhet të sillet, për aq sa është e arsyeshme, në mënyrë të tillë që të minimizojë rastet për të cilat do të jetë e nevojshme që gjykatësi të skualifikohet nga dëgjimi apo vendosja mbi çështjet. Pra, ky moment lidhet me sjelljen e gjykatësit, marrëdhëniet personale të gjykatësit ose familjarit me njërin nga palët, pra, me integritetin personal të tij, që natyrisht nuk lidhet me situatën në fjalë. Në vijim, po ky Komentari, paragrafi 67, përcakton: “Potenciali për konflikt interesi krijohet kur **interesi personal i gjykatës, apo i të afërmeve të tij përplasat me detyrën e gjykatësit**. Në punët gjyqësore, prova për konflikt interesi duhet të përfshijë konflikte reale mes interesit vetjak të gjykatësit dhe detyrës për gjykim të paanshëm dhe rrethanat në të cilat një vëzhgues i arsyeshëm do të (ose mund të) dallonte me arsye një konflikt”. Pra, edhe sipas këtij përkufizimi, konkluzioni për të pasur konflikt interesi për

fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

¹⁶ Citim nga vendimi: “Gjyqtari në fjalë i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në respektim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore e tashmë për të ka një vendim përfundimtar i cili nuk mund të vihet në diskutim, **vendim që është bërë përfundimtar rreth 1 (një) vit më parë**”.

¹⁷ http://www.judicialintegritygroup.org/images/resources/documents/BP_Commentary_Engl.pdf.

gjykatësin lidhet me ekzistencën e “*interesit personal*” dhe ky interes personal duhet vendosur në një përballje reale me detyrën e tij. Duke iu kthyer rastit konkret, sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë¹⁸, nuk rezulton **tashmë** asnjë interes privat i gjyqtarit në “rezultatit” e gjykimit ndaj të pandehurës E.Ç. (trajtuar ky moment edhe në paragrafin 45.10 të këtij vendimi në kuadër të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në funksionet publike”).

45.13. Pala ankuese, Prokuroria e Posaçme, pretendon se gjykata i është referuar dhe arsyeton rreth kriterit *subjektiv*, ndërkohë nga ana e saj pretendohet cënimi i kriterit *objektiv* (kuptimin e tyre ky kolegji u dha në paragrafin 45.5 të këtij vendimi, sikurse është dhënë edhe në vendimin gjyqësor që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit). Në fakt, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë është ndaluar dhe ka arsyetuar gjerësisht rreth konceptit të paanshmërisë së gjyqtarit në drejtim testit objektiv (pra, paanshmërisë në dukje të gjyqtarit) dhe ka arsyetuar se paanshmëria në dukje mund ta kategorizohen në dy drejtime, në paanshmërinë funksionale dhe në atë personale. Gjykata, në vështrim të këtij testi (*objektiv*), i është referuar, sikurse i referohet edhe ky kolegji, Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Driza kundër Shqipërisë (nr.ankimi 33771/02), datë vendimi 13.11.2007, ku ndër të tjera është arsyetuar se: “74. Gjykata pohoi se ka rëndësi themelore, që në një shoqëri demokratike gjykata të përcjellë besim tek qytetarët (shih *Padovani v. Italy*, vendimi i dt.26 shkurt 1993, Seria A nr.257-B p.20). Neni 6 kërkon, që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme. Paanshmëri do të thotë mungesë paragykyimi, apo anësie dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Kështu, Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, **dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm** (shih *Piersack v. Belgium*, vendimi i datës 1 tetor 1982, Seria A nr.53, § 30 dhe *Kyprianou v. Cyprus* [GC], nr. 73797/01, § 118-119, ECHR 2005-...).

45.14. Duke iu referuar praktikës së GJENJ-së, thekson ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit se vlerësimi objektiv ka të bëjë edhe me lidhjet hierarkike ndërmjet gjyqtarit dhe aktorëve të tjerë të procedurës, lidhje të cilat përlligjin objektivisht dyshimin për sa i përket paanshmërisë së gjykatës dhe frikës se mos gjykata do ta linte veten të udhëhiqej padrejhtësisht nga konsiderata të anshme. Në këtë këndvështrim, përmendet praktika e GJEDNJ-së: ngritja pranë juridiksioneve ushtarake e akuzave penale kundër ushtarakëve nuk është në parim e papajtueshme me dispozitat e nenit 6 (Cooper k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], § 110). *Megjithatë, kur anëtarët e gjykatës ushtarake janë nga pikëpamja hierarkike të gjithë vartës të oficerit që ngre padinë dhe nën urdhrat e tij, dyshimet që shfaq paditësi për sa u përket pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës mund të shihen si objektivisht të përlligjura* (Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar, 25 shkurt 1997, Përmbledhje e Vendimeve 1997-I, § 76; Miller me të tjerë k.Mbretërisë së Bashkuar, nr. 45825/99 dhe 2 autres, 26 tetor 2004, §§ 30-31).

45.15. Duke e përqasur këtë moment të kriterit *objektiv* (ku fokusohet ndër shkaqet e ankimit prokurorja e posaçme) të vlerësimit të paanshmërisë së gjyqtarit, me situatën konkrete, natyra e lidhjes së pretenduar nga Prokuroria e Posaçme, e gjyqtarit me të pandehurën E.Ç., lidhje e krijuar për shkak të përmbushjes më herët të një funksioni kushtetues nga kjo e fundit, nuk konsiderohet

¹⁸ Citim nga vendimi: “... Gjykata çmon se gjyqtari Erjon Bani nuk gjendet në konflikt interesi për të gjykuar çështjen në fjalë, pasi ai nuk ka asnjë interes personal ndaj të pandehurës E.Ç. në këtë gjykim, për sa kohë e pandehura ka kryer një detyrë kushtetuese ndaj tij në kohën kur e ka pas një detyrim të tillë”.

nga ky kolegje e tillë, apo e ngjashme me ato të trajtuar nga GJEDNJ-ja në çështjet e mësipërme (apo dhe në praktika të tjera, ku janë analizuar “*lidhje të tjera*” ndërmjet gjyqtarit dhe personi tjetër në proces¹⁹). Kjo, përsa kohë procesi i rivlerësimit kalimtar tashmë ka përfunduar dhe nuk rezultojnë rrethana në vështrim të nenit 5, pika 1 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në funksionet publike” (analizuar më lart) dhe as rrethana apo situata të natyrës personale, që lidhen me sjelljen e gjyqtarit në vijim (moment tjetër ky lidhet me kriterin objektiv të vlerësimit të paanshmërisë së gjyqtarit). Në këtë mënyrë, nuk ka asnjë dyshim në këtë rast mbi prezumimin se *gjyqtarët veprojnë në mirëbesim* (Opiniononi Amicus Curie i Komisionit të Venecias për ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”²⁰), pra, të pavarur, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutën dhe ligjeve (neni 145, pika 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”). Për pasojë, në vlerësim të këtij kolegji, gjyqtari që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë dhe ka disponuar me vendimin përfundimtar nr.48, datë 16.09.2022, nuk gjendet në situatën e shkronjës “ë” të nenit 17 të K.Pr.Penale, “*shkak i rëndësishëm njëanshmërie*”.

45.16. Në përfundim, gjykimi i çështjes në fjalë, në ndryshim nga çfarë pretendon në ankim prokurorja e posaçme, është realizuar nga një trupë gjyqësore (monokratike) që **plotëson standardin e një gjykate të pavarur e të paanshme**, në kuptim të nenit 42 pika 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë²¹ dhe neni 6 pika 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut²², pasi nuk rezultojnë të shkelura dispozitat procedurale lidhur me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, në vështrim të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 428 të K.Pr.Penale.

IV.B Në lidhje me kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në gjykimin në apel në zbatim të neneve 425 dhe 427 të Kodit të Procedurës Penale

46. Ankimi i prokurorit i lidhur me prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, në vështrim të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 428 të K.Pr.Penale u analizua më lart dhe u gjet i pabazuar. Në vijim, në shqyrtimin e kësaj çështje në Gjykatën e Posaçme të Apelit objektin e përbën apeli i prokurorit ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë që ka disponuar duke e deklaruar të pafajshme të pandehurën E.Ç. për të dyja akuzat e ngritura, shkaqet e këtij ankimi, në funksion të kërkimit për ndryshimin e vendimit dhe dënimit e saj për të dyja akuzat (në vështrim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 428 të K.Pr.Penale).

47. Neni 425 i Kodit të Procedurës Penale parashikon shprehimisht:

“1. Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtepandehurve që nuk kanë bërë apel.

2. Kur apeluar është prokurori ose viktima akuzuese, gjykata e apelit:

¹⁹ Psh. Dorozhko e Pozharskiy k. Estonisë, nr. 14659/04 dhe 16855/04, 24 prill 2008;

²⁰ CDL-AD(2016)036 English 12/12/2016 - Public Albania - Amicus Curiae Brief for the Constitutional Court on the Laë on the Transitional Re-evaluation of Judges and Prosecutors (The Vetting Laë), adopted by the Venice Commission at its 109th Plenary Session (Venice, 9-10 December 2016); [http://ëëë.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](http://ëëë.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

²¹ Neni 42 pika 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm **nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj**”.

²² Neni 6 pika 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: “Çdo person **ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht**, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga **një gjykatë e pavarur dhe e paanshme**, e krijuar me ligj ...”

a) mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të marrë çdo masë tjetër që urdhëron ose lejon ligji;

b) mund t'i japë dënim atij që është deklaruar i pafajshëm, **t'i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar**, të marrë masat e treguara në shkronjën "a";

c) mund të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese ose dënimet alternative;

ç) mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë se ai i kërkuar nga prokurori kur çështja është në kompetencën e saj lëndore. Në këtë rast, gjykata riçel shqyrtimin gjyqësor dhe zbaton parashikimet e paragrafit 2, të nenit 375, të këtij Kodi.

3. Kur apeluar është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar dhe as t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë".

48. Në rastin konkret, lidhur me të pandehurën E.Ç., nga parashikimi i pikës 2 të nenit 425 të sipërcituar, rezulton se, Gjykata e Apelit të Posaçëm duhet të shqyrtojë apelin e prokurorisë të lidhur me: (i) disponimin mbi pafajësinë për veprat penale të parashikuara nga nenet 257/a/2 dhe 186 të Kodit Penal dhe (ii) drejtësinë materiale. Lidhur me situatën kur apeluar është prokurori, në vendimin unifikues nr.02, datë 06.02.2009, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur mbi zgjerimin e kufijve të gjykimit rishikues që vjen si pasojë e ushtrimit të ankimit nga prokurori. Sipas këtij vendimi, kur apeluar është (edhe) prokurori, gjykata e apelit **mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të japë lloj më të rëndë dënimi ose të rrisë masën e tij, apo në vend të pafajësisë ta deklarojë personin e akuzuar fajtor etj**, përcaktime këto, theksojnë Kolegjet e Bashkuara, të cilat janë zbatuar edhe në praktikën tonë gjyqësore (përfshirë edhe atë të Gjykatës së Lartë).

49. Ky kolegji vlerëson të ndalet edhe në zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të K.Pr.Penale, që ka pësuar ndryshime me ligjin nr.35/2017: "Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor". Fillimisht, ky kolegji, arsyeton se parashikimi i këtij neni është i zbatueshëm jo vetëm në rastin e shqyrtimit në apel të një çështje penale të përfunduar me vendim pafajësie përgjatë gjykimit të zakonshëm, por edhe në rastin e procedimit me ritin e gjykimit të shkurtuar. Kjo, për sa kohë vetë ligjvënësi, në pikën 4 të nenit 427 të K.Pr.Penale, nuk ka bërë dallimin e situatave të gjykimit në shkallë të parë me ritin të gjykimit të shkurtuar apo me gjykimin e zakonshëm.

49.1. Lidhur me këtë moment, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë (me legjislacion të ngjashëm në këtë pikë) ka konkluduar se zbatimi i normës ligjore që detyron gjykatën e apelit të riçelë shqyrtimin gjyqësor në rastet e apelit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë të gjykatës së shkallës së parë, kur është proceduar në këtë shkallë gjykimi me ritin e posaçëm të gjykimit të shkurtuar, nuk përbën në vetvete shkelje të parimeve të gjykimit të drejtë. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Italisë, pas një kontrolli incidental të pikës 3 të nenit 603 të K.Pr.Penale (dispozitë analoge e nenit 427, pika 4 të K.Pr.Penale) ka konkluduar se riti i posaçëm i gjykimit të shkurtuar nuk mund të dëmtojë interesat publike të dhënies së drejtësisë²³ (praktika e Seksioneve të Bashkuara të Gjykatës së Kasacionit të Italisë lidhur me këtë moment rezulton e pasqyruar edhe në praktikën e GJEDNJ-së në çështjen Martino dhe Molinari kundër Italisë, datë 21.03.2021).

²³ Vendimi nr. 124, datë 20 - 23 Mars 2019 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë.

49.2. Ky kolegji arsyeton se, edhe në rast ndryshimi të vendimit të pafajësisë dhe disponimi nga gjykata e apelit për një vendim dënimi, kjo nuk sjell humbjen e të drejtës së të pandehurit për uljen e dënimit për shkak të zbatimit të gjykimit të shkurtuar në gjykimin fillestar. Kjo e drejtë lidhet me ligjshmërinë e dënimit sipas nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së (qëndrim edhe i GJEDNJ-së në çështjen “Scoppola” kundër Italisë, Vendim i Dhomës së Madhe datë 17.09.2009). Ulja e dënimit për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar është një e drejtë e të pandehurit, që rrjedh prej ligjit penal dhe bën pjesë në konceptin e dënimit që duhet të formësohet dhe individualizohet në çdo rast sipas ligjit me të gjitha komponentët e tij²⁴. Në këto raste gabimi i organeve shtetërore në ritin e gjykimit dhe në gjykim nuk mund të justifikojë dënimin pa ligj të të pandehurit dhe nuk mund të dëmtojë kursesi pozitën juridike të tij (in peius).

49.3. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin nr.21, datë 16.04.2012 është shprehur se, përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjykata e apelit dhe, nëse kjo gjykatë vlerëson se është i pajustificueshëm refuzimi i gjykimit të shkurtuar, duhet të aplikojë dënim të reduktuar, edhe pse procedura e ndjekur nuk ka qenë ajo e gjykimit të shkurtuar. Nga interesimi i këtij vendimi rezulton se kjo jurisprudencë kushtetuese është e tillë që, edhe në rastet kur gjykata e shkallës së parë ka proceduar me gjykim të shkurtuar dhe ka konkluduar në pafajësinë e të pandehurit, gjykimi rishikues sipas ritit të zakonshëm në gjykatën e apelit mbi bazën e apelit të prokurorit, nuk mund dhe nuk duhet të ndikojë në përcaktimin e dënimit penal të të pandehurit, duke mos i hequr atij në këtë mënyrë uljen e një të tretën e dënimit penal për shkak të parashikimit të nenit 406, pika 1 të K.Pr.Penale.

49.4. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se fjalia e fundit e pikës 4 të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, nuk detyron gjykatën e apelit që, në çdo rast të apelit nga ana e prokurorit të vendimit të pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që të shqyrtojë apelin dhe të disponojë me vendim mbi të. Edhe duke mbajtur parasysh mundësinë e vendimmarrjes së gjykatës së apelit, sipas disponimeve të nenit 428 të Kodit të Procedurës Penale, konkludohet se vendimmarrjet e gjykatës së apelit në procesin penal janë të tilla që përjashtojnë *apriori* përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në çdo rast, por konkluzioni për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor në këto raste mbetet sërish kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë** mbi këtë çështje të shtruar për zgjidhje përmes kontrollit incidental të ligjit. Në këtë jurisprudencë kushtetuese (të përsëritur tre herë) është pranuar ndër të tjera se:

“...Sipas pikës 4 të kësaj dispozite, kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë. Në këtë vështrim, nga përmbajtja e dispozitës së kundërshtuar rezulton se është në diskrecion të gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Jo vetëm kaq, por edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon apriori në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimit, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP-së në lidhje me llojin e vendimmarrjes.

20. ...Nga mënyra se si është formuluar neni 427 i KPP-së gjykata nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj, si dhe ajo nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo

²⁴ Vendimi nr. 14, datë 26.03.2012 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. ...

21. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se institute të tilla, si deklarimi i fajësisë së të pandehurit apo individualizimi i veprave dhe dënimeve penale janë në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, gjatë shqyrtimit të çështjes cakton llojin dhe masën e dënimit. Për pasojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se rregulli procedural i parashikuar nga neni 427, pika 4, i KPP-së nuk kufizon hapësirën e nevojshme, të dhënë nga ligji, që gjykata referuese ka për zgjidhjen e çështjes konkrete²⁵.

49.5 Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.02, datë 19.03.2021 është shprehur rreth kuptimit që i duhet dhënë nenit 427, pika 4 të K.Pr.Penale: “... përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel”, ka pranuar se “riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel do të mbetet e nevojshme për t’u kryer vetëm në rastin e diktuar nga vlerësimi ndryshe i provave të gjalla. Kjo do të thotë që kjo mënyrë e të proceduarit në gjykimin rishikues në apel nuk do të jetë e nevojshme vetëm, kur fajësia e autorit dhe ekzistenca e faktit penal provohet ose nuk provohet në fashikullin e gjykimin nga materiali procedues që ka natyrën e provës së gjallë, konkretisht për dëshminë, deklaratimet e të bashkëpandehurve, ballafaqimet, pyetjet apo ripyetjet e drejtëpërdrejta të ekspertit...”.

49.6. Ky kolegji, gjithashtu, arsyeton se interpretimi i pikës 4 të nenit 427 të K.Pr.Penale duhet bërë mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi nenin 6 të KEDNJ në aspektin penal, jurisprudencë e cila ka ndikuar në krijimin e një rregulli të tillë në gjykimin penal rishikues. GJEDNJ në këtë jurisprudencë ka arsyetuar në mënyrë vazhduese se, në të gjitha rastet kur gjykata e apelit ka juridiksion rishikues fakti (sikurse në sistemin tonë juridik) dhe ato shqyrtojnë çështje të fajësisë apo pafajësisë në procesin penal, për hir të respektimit të nenit 6 të KEDNJ dhe të drejtës për proces të rregullt ligjor, ato nuk mund të konkludojnë dhe të vendosin mbi këto çështje pa një vlerësim të drejtëpërdrejtë të provave, duke nënkuptuar këtu provat e gjalla, në rastet kur ato janë vendimtare për të konkluduar mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit²⁶. Gjithashtu, GJEDNJ ka arsyetuar se besueshmëria ndaj provave me dëshmitarë është një çështje shumë komplekse, e cila nuk mund të realizohet drejtësisht vetëm duke lexuar në procesverbale përmbajtjen e thënieve të tyre që fashikulli i gjykimin ka.

Kjo çështje është shtruar për zgjidhje përpara GJEDNJ-së edhe në situatën kur gjatë gjykimin në shkallë të parë çështja ka përfunduar me ritin e gjykimin të shkurtuar dhe disponimi mbi pafajësinë i gjykatës së shkallës së parë është bërë objekt ankimi nga prokurori (sikurse në rastin konkret) dhe, konkretisht, në çështjen Martino dhe Molinari kundër Italisë, datë 25 mars 2021 (nr.15931/15 dhe 16459/15). Rasti paraqitet i tillë që GUP (gjyqtari i seancës paraprake) e ka liruar ankuesin për akuzat e bashkimit kriminal (grupit) me qëllim të trafikut të drogës dhe e ka dënuar vetëm për kultivimin e kërpit. Në këtë vendim Gjykata Evropiane ka bërë dallimin, në fokus verifikimin e një procesi të drejtë ligjor në kuptim të nenit 6, pika 3 shkronja d) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut²⁷, ndërmjet rasteve të shqyrtuara më parë prej saj, me rastin konkret që i paraqitej, kur as

²⁵ Vendimi nr. 6, datë 15.01.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vendimi nr. 29, datë 12.02.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

²⁶ çështja “Popovici v. Moldova”, ap. nos. 289/04 and 41194/04, paragrafi 68, Vendim i GJEDNJ datë 27 Nëntor 2007. Shih çështjen “Constantinescu v. Romania”, Ap. no. 28871/95, paragrafi 55, ECHR 2000-VIII. Shih çështjen “Marcos Barrios v. Spain”, ap. no. 17122/07, paragrafi 32, Vendim i GJEDNJ datë 21 shtator 2010; “Ignat kundër Rumanisë”, 9 nëntor 2021.

²⁷ Neni 6 §§ 1 dhe 3 d) i Konventës: “1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të shqyrtohet në mënyrë të drejtë (...) nga një gjykatë (...) e cila thirret të vendosë (...) mbi themelin e çdo akuze penale të ngritur kundër tij. (...)

3. Në veçanti, çdo i akuzuar ka të drejtë të: (...);

gjykata e shkallës së parë nuk kishte marrë prova me dëshmitarë dhe kjo për shkak se ishte proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar, zgjedhur nga vetë aplikuesit. Konkretisht, GJEDNJ-ja është shprehur:

“36. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, Gjykata vlerëson se, duke kërkuar zbatimin e aktgjykimit të shkurtuar, ankuesit, të cilët u asistuan nga avokatët, ranë dakord të bazonin mbrojtjen e tyre në dokumentet e mbledhura gjatë hetimeve paraprake, nga të cilat ata kishin lexuar, dhe për këtë arsye pa mëdyshje hoqën dorë nga e drejta e tyre për të siguruar thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve në gjyq. Nuk ka asgjë për të hedhur dyshime mbi faktin se heqja dorë nga e drejta e kërkuarve ishte e vetëdijshme dhe e informuar. Më tej, palët e interesuara pranuan që gjyqtarët e investuar në çështjen e tyre kanë përdorur transkriptet e depozitimeve të “të penduarve” E., P.G. dhe S., të fituara në dosjen e prokurës. Për më tepër, kërkuarët e dinin ose duhet ta dinin se, në rast të shpalljes së pafajësisë në shkallë të parë, gjykata e apelit ishte e autorizuar të gjykonte çështjen në bazë të të njëjtave prova.

....39. Gjykata vëren, ndër të tjera, se Gjykata italiane e Kasacionit ka interpretuar së fundmi gjerësisht nenin 603 të KPP-së, duke parashikuar detyrimin për gjykatat e apelit të urdhërojnë, qoftë edhe ex officio, dëgjimin e dëshmitarëve që kanë qenë vendimtarë për dënimin, si në procedurën penale të zakonshme ashtu edhe në rastet kur procedura e shkallës së parë është kryer sipas aktgjykimit të shkurtuar (shih paragrafin 16 më lart). Në lidhje me këtë, ajo thekson se Konventa nuk i pengon shtetet palë nga dhënia e të drejtave dhe lirive, ajo garanton një mbrojtje juridike më të gjerë se ajo që ofron, qoftë nëpërmjet ligjit të brendshëm, traktateve të tjera ndërkombëtare, ose nëpërmjet ligjit të Bashkimit Evropian. Siç keni pasur tashmë rastin të nënvizoni, me sistemin e saj të garancisë kolektive të të drejtave që ajo vendos, Konventa forcon, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, mbrojtjen e ofruar në nivel kombëtar. Asgjë nuk i pengon Shtetet Kontraktuese që të miratojnë një interpretim më të gjerë i cili garanton mbrojtje më të madhe të të drejtave dhe lirive në fjalë në sistemet e tyre ligjore përkatëse të brendshme (neni 53 i Konventës) (shih, mutatis mutandis, Partia e Bashkuar Komuniste e Turqisë dhe të tjerët kundër Turqisë, 30 janar 1998, § 28, Recueil 1998 I, Chamaïev dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë dhe Ruisë, nr.36378/02, § 500, GJEDNJ 2005 III, Krombach kundër Francës (dek.), nr. 39, 20 shkurt 2018 dhe Gestur Jónsson dhe Ragnar Halldór Hall kundër Islandës [GC], nr.68273/14 dhe 68271/14, § 93, 22 dhjetor 2020).

40. Si përfundim, duke pasur parasysh sa më sipër, ankuesit nuk mund të ankohen se e drejta e tyre për një gjykim të drejtë ishte penguar për shkak të dështimit të gjykatës së apelit për të dëgjuar dëshmitarët E., P. G. dhe S...”

Në vijim, po në këtë vendim, GJEDNJ-ja ka referuar në standarin e mëparshëm të saj se, që të kishte cënim të nenit 6, pika 3 shkronja d) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (e drejta për të dëgjuar dëshmitarët dhe termi ”dëshmitar” ka kuptim autonom në kuptimin e Konventës, “prova të gjalla”), duke arsyetuar se edhe në rastin kur Gjykata e Apelit nuk ridëgjon dëshmitarët dhe konkludon në ndryshim nga shkalla e parë në fajësinë e të pandehurit, jo gjithmonë kemi cënim të këtij neni, por vetëm në rastet kur peshat e provave të gjalla është vendimtare për vendimin e dhënë²⁸.

d) të marrë në pyetje ose të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të marrë thirrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij; (...)

²⁸ 43. Gjykata vëren se dënimi i ankuesve bazohej në prova të ndryshme, duke përfshirë shënimin informativ nga karabinierët e Napolit, të cilin gjykata e apelit i atribuoi rëndësi vendimtare (shih paragrafin 9 më lart). Ky element kishte të bënte kryesisht me aktivitetet kriminale të kërkuarëve dhe anëtarëve të familjes së tij, si dhe lidhjen e tij me klanin mafioz D.A. Kësaj i janë shtuar deklaratat e E., P.G. dhe S., ish-anëtarë të klanit "të penduar", dhe rezultatet e përgjimeve të ndryshme telefonike dhe mjedisore.

44. Gjykata vëren se, në këtë kontekst, dëshmia e B.S. nuk bëri gjë tjetër veçse konfirmoi deklaratat e dëshmitarëve të tjerë dhe vërtetoi të gjitha provat kundër tij. Në fakt, as GUP dhe as gjykata e apelit nuk i kanë dhënë një peshë vendimtare kësaj dëshmie, në një mënyrë ose në tjetrën, në vendimet e tyre në lidhje me përgjegjësinë penale të ankuesve (shih, përkundrazi, Dan, cituar më sipër,

49.7. Ky kolegji, vështruar parashikimin e nenit 427, pika 4 të Kodit tonë të Procedurës Penale me jurisprudencën e GJEDNJ-së; jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi këtë parashikim, këtë rregull ligjor i bëhet një interpretim pajtues²⁹ me nenin 33 dhe 42 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ dhe si përfundim: Zbatimi i këtij parashikimi nuk e bën automatikisht dhe apriori të detyrueshme për gjykatën me juridiksion rishikues që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor të faktit në rastet e shqyrtimit të apelit të prokurorisë ndaj vendimit të pafajësisë së të pandehurit.

49.8. Duke iu kthyer çështjes konkrete, rezulton se akuzat ndaj të pandehurës E.Ç. mbështetet në deklaratimet e dëshmitarëve, në gërshetimin me provat e tjera, përfshirë, dhe ato dokument. Për pasojë, sikurse u parashtrua edhe më lart në paragrafin 9.1 të këtij vendimi, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel, në referencë të pikës 4, në lidhje me pikën 1 të neni 427 të K.Pr.Penale, u vendosi për të gjitha provat. U lejuan për shqyrtim të njëjtat prova të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë me ritin e gjykimit të shkurtuar. Lidhur me provat me dëshmitarë, ato u pyetën gjatë gjykimit në apel, ndërsa lidhur me provat e tjera palëve iu dha mundësia (duke iu krijuar mundësitë dhe lehtësitë e duhura) t'i debatohet ato. Pra, iu dha mundësia të dyja palëve që **t'i kundërshtojnë** provat, në kuadër të procesit të rregullt ligjor, në përmbushje të standarteve të nenit 6, pika 1 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, nenit 42, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në harmoni edhe me parashikimin e nenit 427, pika 4 të K.Pr.Penale.

49.9. Pavarësisht konsideratave të mësipërme të këtij kolegji, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel edhe lidhur me provat “dokument” është në përputhje me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.175 datë 21.06.2022 (megjithëse jo njehsuese). Referuar kësaj praktike, *duket* që kolegji ka bërë një interpretim të pikës 4 të nenit 427, duke e shtrirë nevojën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor në apel (qoftë edhe në rastin kur në gjykimin në shkallë të parë është proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar) për të gjitha provat, pa bërë dallim ndërmjet provave “të gjalla” apo provave të tjera, duke konkluduar se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor lidhur me provat shkresore nuk nënkupton një përsëritje të shqyrtimit formal, nëpërmjet një procedure të ashtuquajtur “të administrimit të provave shkresore”, që sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është një rudiment procedural që nuk njihet në frymën e legjislacionit tonë të ri procedural³⁰.

49.10. Gjithsesi, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel, në rastin konkret duke u shtrirë atë edhe në provat e natyrës së ndryshme nga provat “e gjalla”, në vetvete është një garanci më shumë për të pandehurën E.Ç., për sa kohë një fakt i tillë i garanton asaj një mbrojtje juridike më të gjerë, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, duke iu dhënë mundësia e debatimit/kontradiktoritetit (real)

§ 31 , Lorefice, cituar më sipër, § 37, dhe Tondo, cituar më lart, § 42). Gjykata gjithashtu vëren se GUP-ja kishte urdhëruar thirrjen e B.S. duke besuar se dëgjimi i tij ishte i rëndësishëm në gjykimin e pozicionit të P.C., një prej të bashkëpandehurve të ankuesve.

²⁹ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 31.05.2010. Shih gjithashtu edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 24.06.2010.

³⁰ Pjesë nga vendimi nr. 175, datë 21.06.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: “103.....Në interpretim analogjik e drejta e përfitimit nga gjykimi i shkurtuar në rastet e shqyrtimit në apel e të rëndimit të pozitës së të pandehurit është në kushtet e ripërsëritjes së shqyrtimit gjyqësor duhet t'i njihet, **por ripërsëritja e shqyrtimit gjyqësor duhet të bëhet e plotë, me marrje prove në mënyrë të drejtëpërdrejtë, me debat dhe jo në mënyrë formale duke mos i garantuar të pandehurit të drejtën e dëgjimit e të kundërshtimit të akuzës që në këtë rast nënkupton një cilësim tjetër ligjor që rëndon pozitën e tij.**

104. Në të tilla kushte, në të kundërt të pretendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, **rezulton se nuk mund të deklarohet në shkallën e dytë të gjykimit, fajësia e të pandehurit Klodjan Jahaj, i deklaruar si i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të të njëjtave prova të marra sipas gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e të një përsëritje të shqyrtimit formal, nëpërmjet një procedure të ashtuquajtur “të administrimit të provave shkresore”, që është një rudiment procedural që nuk njihet në frymën e legjislacionit tonë të ri procedural”.**

mbi të gjitha provat, rezultuar të njëjta me ato të marra në gjykimin në shkallë të parë, por të marra dhe vlerësuara në atë shkallë gjykimi me ritin e gjykimit të shkurtuar.

IV.C Trajtimi i shkaqeve të ankimit, të përballura me arsyetimin e vendimit të apeluar

50. Në vështrim të shkaqeve të ankimit të Prokurorisë së Posaçme kundër vendimit nr.48, datë 21.06.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, vendim me të cilin e pandehura E.Ç. është deklaruar e pafajshme për veprat penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, i gjen këto shkaqe të pabazuara dhe vendimi duhet lënë në fuqi.

50.1. Lidhur me strukturën e mëposhtme, arsyetimi në vijim ndalet: (i) veçmas për secilën akuzë, (ii) në qëndrimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në vendimin objekt ankimi, dhe më tej në (iii) në vlerësimin e këtij kolegji të Gjykatës së Posaçme të Apelit mbi rrethanat e faktit që i rezultojnë të provuara, (iv) të përballura këto të fundit me elementët e secilës vepër penale dhe me shkaqet të ankimit.

Në lidhje me veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal

51. Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë ka arsyetuar, në funksion të elementëve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, se kjo dispozitë është blankete dhe i është referuar ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Gjykata i është referuar neneve 4 - “Afati dhe objekti i deklarimit” dhe nenit 5/1 të këtij ligji nën titullin “Deklarimi para fillimit të punës”³¹. Në vijim janë arsyetuar elementët e anës objektive të veprës penale, në harmoni me dispozitat e ligjit të posaçëm dhe, konkretisht, është arsyetuar se: “...Ndërkohë, sipas paragrafit të dytë të nenit 257/a i Kodit Penal vepra konsiderohet e konsumuar kur subjekti i deklarimit apo personi i lidhur me të, bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë kryejnë **fshehje të pasurisë** apo bëjnë **deklarim të rremë të pasurisë**. Do të kishim të bënim me kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal, **nëpërmjet fshehjes së pasurisë**, në rastin kur personi, ka kryer veprime të caktuara, si këmbim të pasurisë, transferim të saj, fshehje apo mbulim të natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, fitim të pronësisë, posedim apo përdorim, që do të çonin në moslidhjen dot të pasurisë me pronarin e vërtetë të saj, duke e vendosur atë në emër të një personi tjetër, të ndryshëm nga rrethi i personave për të cilët i pandehuri është i detyruar që të deklarojë pasurinë. Subjekti në këtë rast ndërmerr veprime të caktuara, shoqërisht të rrezikshme, për t’i humbur gjurmët e pasurisë, apo duke e gëzuar atë, me ndërmjetësinë e personave të tretë. **Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e një të pandehuri bëhen me një qëllim të mirëpërcaktuar, për t’u mos u evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI, sepse këto pasuri rrjedhin nga përfitime të paligjshme duke abuzuar me funksionin e tyre, pasi në**

³¹ 1. Të gjitha subjektet, që mbartin detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë para fillimit të punës: a) të gjitha pasuritë e grumbulluara, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë **burimet e krijimit të tyre**;

të kundërt nuk do të kishte sens logjik dhe juridik për t'u fshehur pasuritë që vijnë nga burime të ligjshme e të justifikuara” (citim).

51.1. Gjykata arsyeton se përfundimin, pra, mbi ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, e arrin duke bërë interpretimin historik, logjik dhe sistematik të legjislacionit që ka rregulluar deklarinimin e pasurive të të zgjedhurve dhe funksionarëve publikë ndër vite, duke referuar në nenet 8, 9 të ligjit nr.7903, datë 08.03.1995 “Për deklarinimin e pasurive të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, ligj i shfuqizuar me ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë dhe duke u shprehur: “...Pra, nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se masa administrative merret për deklarata të rreme me dashje dhe vetëm për **pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme**, sepse nuk ekziston logjika juridike që bëhet deklarata e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara apo edhe të padeklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë konkluzion arrihet duke bërë interpretimin gramatikor të nenit 9 të këtij ligji, konkretisht lidhësa “edhe” për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme, nënkupton që dënimi me gjobë shoqërohej gjithmonë me konfiskimin e pasurisë të fituar nga burime të paligjshme, për rrjedhojë, nuk mund të kemi deklarinim të rremë pa pasur pasuri të paligjshme...”.

51.2. Gjykata vijon arsyetimin dhe, për të nxjerrë në pah **qëllimin** e ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i referohet nenit 1 nën titullin “**Qëllimi**”, nen të cilin edhe ky kolegji vlerëson ta citojë: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarinimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta”.

51.3. Gjithashtu, gjykata i referohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin nr.16, datë 11.11.2004, për të nxjerrë qëllimin e ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

51.4. Gjykata është ndaluar dhe ka arsyetuar në lidhje me **deklarinimin e rremë** të pasurisë, si formë e anës objektive nëpërmjet të cilës akuzohet ta ketë kryer veprën penale e pandehura E.Ç., duke referuar në kuptimin e nenit 38 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Këtë nen, të titulluar “**Deklarimi i rremë**”, edhe ky kolegji vlerëson ta citojë: “*Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi*”.

51.5. Edhe lidhur me formën “**deklarinim i rremë**” të anës objektive të kësaj figure vepre penale, gjykata ka konkluduar se: “... kemi deklarinim të rremë kur paraqiten të dhëna të rreme me pasurinë e dekluar, **me qëllim** për të mbuluar një të ardhur të paligjshme nga burime të paligjshme e të pajustificuara...Të gjitha deklarinimet e rreme duhet të bëhen nga subjekti i deklarinimit **me qëllim futjen e pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklarinimit të interesave privatë duke përdorur forma të ndryshme justifikimi**. Pra, Gjykata thekson se deklarata e rreme e pasurisë bëhet me dashje dhe **vetëm** për pasuritë e deklaruara, të cilat janë fituara nga burime të paligjshme”. Në funksion të këtij konkluzioni,

konstatohet nga ky koleg j se gjykata interpreton nenin 257/a të Kodit Penal, në të dy paragrafët e tij dhe konkludon se: “...Kështu, sipas paragrafit të parë të këtij neni refuzimi për bërë deklarimin e të gjithë pasurisë apo mosdeklarimin e të gjithë pasurisë në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme (ku mund të përfshihen edhe pasuri të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e akteve korruptive apo abuzimit me detyrën), përbën kundërvajtje penale, ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni ku përfshihet dhe deklarimi i rremë i pasurisë përbën krim. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se nëse në deklarimin e rremë të pasurisë do të përfshihej dhe mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë të një ose disa nga interesat privat, burimet e krijimit apo detyrimet financiare, kjo do të binte në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësit, pasi do të sillte që një person që refuzon dhe nuk e paraqet fare deklaratën e pasurisë, ku mund të përfshihen edhe pasuri të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e akteve korruptive apo abuzimit me detyrën, të dënohet më pak se një person që deklaroi në mënyrë të saktë një pjesë të pasurisë dhe nuk deklaroi një pjesë tjetër, e cila vjen nga burime të ligjshme e që mund të justifikohet me dokumente ligjor nga subjektet e deklarimit. Nëse do të rezultonte se pasuria e padeklaruar në deklaratë dhe e konstatuar pas hetimit nga organet kompetente sikurse është ILDKPKI nuk justifikohet me burime të ligjshme, atëherë do të ishim përpara fshehjes së pasurisë dhe jo përpara deklarimit të rremë...”.

51.6. Në lidhje me anën subjektive, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka arsyetuar: “.....deklarimet e rreme në deklaratën e pasurisë duhet të bëhen nga subjekti i deklarimit me **qëllim** futjen e pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklarimit të interesave privat duke përdorur forma të ndryshme justifikimi. Pra, Gjykata thekson se si fshehja e pasurisë ashtu dhe deklarata e rreme e pasurisë bëhet me dashje për të fshehur pasuritë e padeklaruar dhe/ose për pasuritë e deklaruar, të cilat janë fituara nga burime të paligjshme e të pajustificuara, sepse nuk ka sens logjik dhe juridik që bëhet deklarata e rreme me dashje për pasuritë e deklaruar e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuar. Në këtë rast do të ishin përpara një deklarate pasurie të paplotë dhe të parregullt që korrigjohet në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji...”.

52. Ky koleg j, pas përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, për sa iu përket rethanave të faktit historik, pa dalë në përsëritje të tyre të atyre të përshkruara në pjesën “*III. Rrethanat e faktit dhe provat, faktet penale atribuuar të pandehurës E.Ç.*”, **gjen të provuara faktet:**

- E pandehura E.Ç. në lidhje me pasurinë, tokë arë me sipërfaqe 1450 m², përshkruar në kontratën e titulluar “Kontratës shitje”, çmimi 300.000 lekë, të deklaruar fillimisht në ILDKPKI me burim të ardhur nga paga dhe në lidhje me pasurinë tjetër, tokë arë, me sipërfaqe 3440 m², përshkruar në kontratën e titulluar “Kontratës shitje” çmimi 50.000 euro, e deklaruar kjo e fundit, më datë 17.07.2017, në ILDKPKI, fillimisht me burim kredinë e marrë në {...} Bank, **nuk iu ka paguar asnjë vlerë monetare familjarëve të saj dhe se kontratat në fjalë janë fiktive.**
- Qëllimi i finalizimit të këtyre kontratave ka qenë marrja e kredisë³² nga e pandehura E.Ç. në {...} Bank për blerjen e një apartamenti banimi, pavarësisht faktit se në kontratën me këtë institucionin financiar, përshkruhet sikur kredia është marrë për blerjen e tokës bujqësore, e cila është vendosur në vijim si garanci hipotekore.

Lidhur me këto momente të gjetura të provuara, **Gjykata e Posaçme e Apelit**, i referohet jo vetëm analizës së provave dokument të pasqyruara më lart dhe qëndrimit të të pandehurës E.Ç., por dhe: *i.*

³² Aplikuar më datë **16.08.2006** për Kredi Hipotekore pranë Emporiki Bank.

deklarimeve të dëshmitares, i noteres pranë të cilës janë realizuar kontratat në fjalë, **Luljeta Kongoli** (kjo notere ka realizuar edhe kontratën e huasë me institucionin financiar): “*në rastin konkret kontrata u bë formalisht me shitje, sepse ashtu e donte Banka {...} dhe nuk e donte me kontratë dhurimi dhe u bë me një çmim simbolik*”;

ii. Deklarimeve në fazën e hetimit paraprak i prindërve të të pandehurës E.Ç., të cilat vlerësohen si provë nga ky kolegji³³, meqenëse lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë. Këta shtetas janë shprehur: **R.K.**: “*Akt shit-blerja u bë tek noterja, ne firmosëm duke e ditur se kjo tokë e disponueshme i takonte vajzës në bazë të ligjit. Prona, toka bujqësore që është dhënë në bazë të ligjit nr.7501, ka kaluar në emrin e kryefamiliarit dhe sipërfaqja totale që kemi përfituar është rreth 25.000 m² për të cilat disponoj certifikatë pronësie. Siç e thashë më sipër, nuk kam marrë asnjë lek nga shitja e këtyre pronave, as me bankë as me para në dorë (cash)*”; **S.K.**: “*Pasuritë, sipërfaqet e tokës nuk i janë shitur E., pasi asaj i takonte në bazë të ligjit nr.7501, ne si prindër nuk kemi shitur as nuk kemi marrë para, por e bëmë për të mbështetur gocën të merrte kredi... Pronat, sipërfaqet e tokës janë në emrin e R.it, bashkëshortit tim, vajza jonë E. kishte nevojë të merrte kredi dhe kjo ishte arsyeja që i dhamë pjesën e vet, pronat që do t’iu jepen fëmijëve të tjerë janë në emër të R.it, aktualisht nuk iu janë kaluar fëmijëve të tjerë*”.

- Institucioni kredidhënës, banka, ka qenë në dijeni të faktit se po financonte në blerjen e një apartamenti banimi.

Verifikimet e ILDKPKI-së kanë provuar faktin se ky institucion është njoftuar nga banka se kredia është marrë për blerje apartamenti³⁴. Ky fakt vështrohet nga ky kolegji në harmoni me deklaratimet e dëshmitares Luljeta Kongoli, noteres, që ka realizuar, përveç kontratave të shitblerjes së tokës bujqësore, edhe kontratën e huasë me institucionin financiar (cituar më lart, po në këtë paragraf), si dhe faktin se në përmbajtje të kontratës së huasë me institucionin huadhënës, destinacioni i huasë, si kusht kontraktor: “*për financimin e nevojave të tij për blerjen e një toke me sipërfaqe 3,440 m²*”, është synuar të anashkalohet nga pala huadhënëse/banka, duke e konsideruar monitorimin e përdorimit të huasë të drejtë, por jo detyrim për bankën (“*...Banka ka të drejtën, po jo detyrimin të monitorojë, kontrollojë përdorimin e fondeve të huasë nga huamarrësi...*”).

- Me disbursimin e kredisë më datë 29.09.2006, e pandehura E.Ç. e kalon për llogari të shtetases, nënës së saj S. Ç., shumën prej 34,000 euro me përshkrimin "Për shlyerje detyrimi për blerje toke", por në fakt provohet se vlera i është rimarrë nga e pandehura nënës së saj dhe i është dhënë palës shitëse në apartamentit të të banimit të blerë.

Lidhur me këtë moment, dëshmitarët e pyetur gjatë shqyrtimit gjyqësor në apel M.Xh., I.K., M.K., V.H.³⁵, provuan faktin se për marrjen e lekëve të shitjes së apartamentit, në mirëkuptim, kishin qëndruar ***në pritje të marrjes së kredisë*** nga pala blerëse. Në fakt vlera e lekëve ishte marrë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, ndërkohë që data e kontratës së sipërmarrjes me sipërmarrësin shoqëria “{...}” sh.p.k dhe porositësit E. dhe D.Ç. është 08.09.2006, rrethanë që konfirmon dëshminë e këtyre dëshmitarëve, por dhe faktin se vlera e marrë kredi është përdorur nga e pandehura E.Ç. si burim të ardhurash për të shlyer vlerën e blerjes së apartamentit të banimit.

³³ Nenit 362, pika 3 i K.Pr.Penale: “Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore **mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre**”.

³⁴ Shih procesverbalin e dokumentimit të shpjegimeve të subjektit deklarues E.Ç. datë 02.10.201, fq. 2, pyetja 2.

³⁵ Trashëgimtarë të shtetasit Ramadan Kamberi, i cili rezulton palë në kontratën e sipërmarrje në vitin 2003, me shoqërisë “Halili” shpk, kontratë e zgjidhur për t’u rilidhur e njëjta kontratë, pra sipërmarrje, me të pandehurën dhe bashkëshortin e saj.

- Pasi është thirrur nga ILDKPKI, me shkresën nr.3058/28 Prot, datë 31.08.2017, me lëndë: “Ftesë për t’u paraqitur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me deklarinimin e interesave private, e pandehura E.Ç., në procesverbalin e datës 02.10.2017 “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues” pranë ILDKPKI-së ka dhënë shpjegime duke cituar saktësisht burimet e pasurive të mësipërme, sikurse ka rezultuar në përfundim të hetimit të bërë nga prokuroria. Lidhur me tokat arë, ajo është shprehur ndër të tjera se: “*E gjithë sipërfaqja që u regjistrua në emrin tim ishte në respekt të ligjit 7501, që çdo pjestar i familjes bujqësore të merrte 5 000 m² nga toka në pronësi dhe regjistrimi në emrin tim mund të kryhej, vetëm nëse kryetari i familjes bujqësore i shiste këto toka me kontrata shitblerje (siç vepruam ne)..... Pra, kjo tokë ishte e babait tim dhe që të vihej Kolateral duhej të bëhej një kontrate shitblerje në emrin tim si bleres që pastaj ta përdorja si kolateral për marrjen e kredisë. Pra, kjo tokë nuk është blerë realisht nga unë, sepse kredia është marrë për apartamentin....e gjithë sipërfaqja që u regjistrua në emrin tim ishte në respekt të ligjit 7501, që çdo pjestar i familjes të merrte 5000 m² nga toka në pronësi dhe regjistrimi në emrin tim mund të kryhej, vetëm nëse kryetari i familjes bujqësore i shiste këto toka me kontrata shitblerje, siç vepruam ne...”.*

52.1. Nga faktet e mësipërme të rezultuara të provuara, edhe për Gjykatën e Posaçme të Apelit, rezulton se e pandehura E.Ç. **nuk ka përdorur burime financiare për finalizimin e regjistrimit të tokave bujqësore në emër të saj**, pasi kontratat e titulluara kontrata shitjeje kanë qenë me elementë fiktiviteti³⁶. Ato janë lidhur duke mos pasur si qëllim palët të sjellin pasoja juridike në lidhje me çmimin, element parësor (thelbësor) i një kontrate shitjeje, por vetëm në shërbim të përfitimit të kredisë që do të mbulonte çmimin e apartamentit që synohej të blihej. Thekson ky kolegji që, **nuk mund të konkludohet, sikurse pretendon akuza**, në faktin se “*vërtetohet se e pandehura nuk ka pasur mundësi ekonomike për të blerë të tre pasuritë, pra, dy tokat arë dhe apartamentin në vitin 2006 me të ardhurat e deklaruara*”, kur ndërkohë vetë akuza pranon faktin që nuk janë përdorur burime financiare për pasuritë e llojit tokë bujqësore, objekt i kontratave të shitjes ndërmjet të pandehurës dhe familjarëve të saj.

53. Në funksion të analizës juridike të veprës penale, në përballje me shkaqet e ankimit, citohet nenin 257/a i Kodit Penal: “*Refuzimi për deklarinimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.* **Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet**”.

54. Së pari, **ky kolegji** ndan të njëjtin qëndrim me Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë që në mënyrë korrekte shprehet se neni 257/a i Kodit Penal është një dispozitë blankete. Pra, **në vlerësim edhe të këtij kolegji**, bëhet fjalë për një dispozitë penale, kuptimi i elementëve të përcaktuara në trup të së cilës dhe integrimi në tërësi i saj, mundësohet vetëm nga përdorimi i burimeve të tjera normative. Konkretisht, duhet t’i referohemi referuar ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Edhe duke iu referuar *aspektit historik* të parashikimit për herë të parë në Kodin Penal të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a, rezulton se kjo dispozitë është shtuar për herë të parë në Kodin Penal me ligjin nr.9030, datë 13.3.2003 dhe brenda një harku kohor më pak se një muaj, më datë

³⁶ Neni 92 i Kodit Civil parashikon: “[...] Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)”.

10.04.2003, është miratuar ligji i posaçëm “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”³⁷. Ky moment paraqet rëndësi edhe në kuadër të interpretimit të elementëve përbërës të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal dhe *interpretimi historik* mundëson përcaktimin dhe kuptimin e drejtë të normës penale-juridike në fjalë, duke u mbështetur në historikun e lindjes së saj, duke përcaktuar shkaqet dhe rrethanat që kanë kushtëzuar nxjerrjen e normës.

55. Ky koleg i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson të ndalet hollësisht në faktin nëse *deklarimi i rremë*, si element i anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal (për të cilën akuzohet e pandehura), duhet të kryhet *në funksion të mbulimit të të ardhura nga burime të paligjshme*, sikurse ka arsyetuar Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë (në raportet me elementët objekt, ana objektive, ana subjektive të figurës së veprës penale), apo sikurse pretendon ndër shkaqet e ankimit Prokuroria e Posaçme se, *qëllimi nuk është element i kësaj vepre penale* dhe se, për pasojë, për ekzistencën e kësaj vepre penale atribuar të pandehurës E.Ç., *mjafton fakti që ajo ka deklaruar natyrë të ndryshme burimi financiar* për blerjen e apartamentit të banimit. Të trajtuarit e këtij momenti për këtë koleg paraqet shumë rëndësi, pasi në vetvete mundëson që të analizohen edhe kompetencat që vetë ligji i posaçëm i ka dhënë edhe institucionit, ILDKPKI-së, në referim të dispozitave konkrete, neneve 24 “Përpunimi paraprak” dhe 27 “Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime” të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (analizuar rreth tyre në vijim).

55.1. Ky koleg vlerëson të analizojë, fillimisht, *nocionin e përgjithshëm të veprës penale*, sipas legjislacionit tonë penal. Në mungesë të përkufizimit të këtij nocioni në Kodin Penal, iu referohemi dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal dhe rezulton se *elementët themelorë* kumulative për ekzistencën e veprës penale janë:

a. Fakti tipik, ku përfshihen *veprimi, pasoja dhe lidhja shkakësore* dhe që ka gjetur rregullim në përmbajtje të nenit 13 të Kodit Penal. Sipas këtij elementi formues të veprës penale, sipas të cilit askush nuk ka përgjegjësi penale, kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore;

b. Kundërligjshmëria, ku përfshihet dhe *përcaktueshmëria*. Sipas këtij elementi, veprat penale duhet të jetë e parashikuara nga ligji si e tillë. Ky element i veprës penale është mekanizëm i parimit të ligjshmërisë dhe ka gjetur rregullim në nenin 1 të Kodit Penal, sipas të cilit ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve. Vepra, jo vetëm parashikohet me ligj si vepër penale, por me ligj *përcaktohen dhe elementët e sjelljes/elementët e posaçëm së dënueshëm penalisht*. Pra, ligjvënësi, me rastin e parashikimit dhe formulimit të veprave penale, përcakton saktësisht, në mënyrë sa më të qartë, figurat e veprave penale dhe elementët e posaçëm të secilës. Secila dispozitë penale, e pjesës së posaçme të Kodit Penal, ka në përmbajtje të saj përkufizimin e sjelljes së ndaluar dhe, nëse është dispozitë blankete, këto rregulla, mosrespektimi i të cilave do të sillte përgjegjësi penale, duhen të jenë të specifikuar qartësisht në një ligj të ndryshëm nga Kodit Penal, apo aktet nënligjore në zbatim të tij.

c. Faji, i rregulluar sipas nenit 14 të Kodit Penal. Sipas këtij elementi formues të veprës penale, askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj dhe se me faj quhet personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi. Faji përbën elementin subjektiv të veprës penale.

³⁷ Shpallur me dekretin nr.1042 datë 20.3.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

55.2. Mbi analizën e mësipërme të **nacionit të përgjithshëm të veprës penale** referuar dispozitave konkrete të Kodit Penal, nuk rezulton që **qëllimi** të jetë element formues i saj. Ndërsa, **koncepti i figurës së veprës penale**, nënkuptohet gjithashtu **tërësia e elementeve apo tipareve të posaçme, objektive apo subjektive**, që krijojnë individualitetin e figurës së veprës penale, **pra, që e bën të dallueshme atë nga figurat e tjera të veprave**. Referuar edhe praktikës gjyqësore dhe teorisë së të drejtës penale, një ndër elementët e **figurës së veprës penale** (përveç anës objektive, subjektive dhe subjektivit) është objekti i veprës penale. **Objekti i veprës penale** është **e mira juridike**, kundër së cilës është e drejtuar vepra penale. Pikërisht, **parimi i cënueshmërisë së nevojshme të marrëdhënies së mbrojtur (nullum crimen sine iniuria)** parashikon që vepra penale, përveçse një shkelje ligjore e normës, duhet të konsistojë edhe në një cënim ose tentim të cënimit të marrëdhënies juridike që mbrohet si një e mirë juridike nga objekti i normës penale. Ky kolegji arsyeton se të përcaktuarit saktësisht të objektit të veprës penale, pra, të përcaktuarit së **çfarë është synuar të mbrohet** me një dispozitë penale-juridike, bën të mundur kuptimin e dispozitës penale materiale dhe elementëve të tjerë të figurës së veprës penale. **Përcaktimi i objektit të veprës penale është një pikënisje për çdo shpjegim, interpretim të normës së ligjit penal, në të cilin parashihet vepra penale.**

55.2.1. Në të njëjtën linjë si më lart, pra mbi domosdoshmërinë e interpretimit të normës sipas kuptimit të marrëdhënies juridike të mbrojtur dhe sulmit ndaj saj, ka arsyetuar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.24, datë 09.02.2017, duke u shprehur është shprehur: **“Kolegji vëren se vepra penale, përveçse përbën një shkelje formale të ligjit penal material, në të njëjtën kohë, ajo duhet të përbëjë edhe një cënim real të marrëdhënies juridike të qenësishme që mbrohet nga objekti i veprës penale. Pra, për konfigurimin e një vepre penale konkrete, nuk mjafton vetëm shkelja e përcaktimit ligjor, thjeshtë si komandë ligjore, por kërkohet edhe prania e një cënimi, domethënë të një sulmi që i bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale inkriminuese si pasojë e kryerjes së një fakti penal. Pikërisht, parimi i cënueshmërisë së nevojshme të marrëdhënies së mbrojtur (nullum crimen sine iniuria) parashikon që vepra penale, përveçse një shkelje ligjore e normës, duhet të konsistojë edhe në një cënim të marrëdhënies juridike që mbrohet si një e mirë juridike nga objekti i normës penale. Ky parim buron nga parimi i materialitetit (nullum crimen nulla poena sine actione) në të drejtën penale, sipas të cilit një vullnet kriminal që nuk manifestohet dhe materializohet në botën e jashtme nuk mund të ndëshkohet. Prandaj edhe është e rëndësishme që cilësimi ligjor i veprës penale të jetë në përputhje me faktin e kryer materialisht dhe marrëdhënia konkret të jetë e cenuar apo e vendosur në një rrezik real, në të kundërt nuk mund të kemi ndëshkim. Kolegji vlerëson se parimi i cënueshmërisë së nevojshme në të drejtën penale, kërkon që ligji penal substancial duhet të interpretohet vetëm sipas kuptimit kur marrëdhënia juridike e mbrojtur nga objekti i normës penale cënohet efektivisht nga sjellja e njeriut (veprim a mosveprim), pasi ky parim përbën një garanci substanciale për individin përballë zbatimit të ligjit penal material nga organet shtetërore kompetente”** (interpretimi i parimit “*nullum crimen sine iniuria*”- në latinisht dhe në italisht: “*Il principio di offensività*”, si kriter interpretues që i është besuar gjyqtarit, është bërë dhe nga Gjykata Kushtetuese Italiane³⁸).

55.3. Mbi konkluzionet e mësipërme, ky kolegji i referohet dispozitave materiale penale të Kodit Penal dhe konstaton se, **të mospërcaktuarit e qëllimit specifik, si cilësues i veprës i penale, nuk do**

³⁸ n. 265/2005: “parimi i ofendimit vepron në dy nivele, përkatësisht të dispozitës rregullative, në formën e një urdhërese drejtuar ligjvënësit për të parashikuar rastet që shprehin në mënyrë abstrakte një përmbajtje të dëmshme, ose në çdo rast rrezikimin, të një të mire ose të një interesi që i nënshtrohet mbrojtjes penale dhe të zbatimit juridik, **si kriter interpretues-zbatues që i është besuar gjyqtarit, i cili kërkohet të konstatojë se fakti ka dëmtuar ose rrezikuar të mirën ose interesin e mbrojtur**”.

të thotë që qëllimi i autorit mungon. Shembuj të tillë gjenden tek figura e veprës penale të vjedhjes, qëllimi është që *ta përvetësojë* sendin në mënyrë të kundërligjshme, tek figura e veprës penale të falsifikimit, qëllimi është të *mashtrojë* nëpërmjet falsifikimit apo përdorimit të një dokumenti që paraqet rrethana të pavërteta si të vërteta. Në fakt në asnjërën prej dispozitave përkatëse, neneve 134 dhe 186 të Kodit Penal, nuk rezulton qëllimi i pasqyruar në përmbajtje të dispozitës. Pra, çdo veprë penale që kryhet me dashje, supozohet se është kryer *me një qëllim të caktuar* dhe autori i veprës që vepron me dashje (tashmë) është i qartë se me veprimin apo mosveprimin e tij do të arrijë këtë qëllim (ndaj zgjedh këtë sjellje). Në këtë rast qëllimi ka të bëjë me qëllimin final, qëllimin e përgjithshëm që udhëheqës veprimtarinë e autorit të veprës penale. Pikërisht, qëllimi i autorit duhet kuptuar në funksion të të interpretuarit dhe të kuptuarit drejt ***të objektit juridik***, pra, të qëllimit të ligjvënësit (*ratio legis*) në parashikimin e veprës penale konkrete. E thënë ndryshe, në konkretizimin e të mirës juridike që legjislatori ka synuar të mbrojë. E njëjta gjë, edhe elementi i dashjes, si formë e fajit (elementi subjektiv i veprës penale), apo elementët e përmendur të anës objektive në vetë dispozitën penale, sikurse është termi “*deklarimi i rremë*” në nenin 257/a/2 të Kodit Penal, duhen vështuar dhe interpretuar në ***funksion të objektit juridik, pra, të mirës juridike që legjislatori ka synuar të mbrojë.***

55.4. Pas analizës së mësipërme, duke iu rikthyer rastit konkret, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, duke u ndaluar tek objekti i figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 257/a të Kodit Penal, gjen të drejtë konkluzionin e arritur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe vlerëson se objekti/e mira juridike që synohet të mbrohet nëpërmjet kësaj veprë penale është *legjitimiteti i burimeve të pasurisë dhe i detyrimeve financiare të personave të zgjedhur ose nëpunësve publike*, të mbrojtura posaçërisht nëpërmjet ligjin nr.9049 date 10.04.2003, marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit; rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore. Transparenca mbi pasuritë e zyrtarëve publikë, është konsideruar si një instrument i rëndësishëm që synon rritjen e rolit të publikut në luftën kundër korrupsionit dhe veprave të lidhura me të. Për të nxjerrë objektin dhe të mirën juridike që synohet të mbrohet, edhe ky kolegji i referohet nenit 1 të ligjit nr.9049 date 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” që parashikon se *qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta.*

55.5. Ligji nr.9049 date 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” është bërë objekt i kontrollit nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr.16, datë 11.11.2004, është shprehur: “...Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr.9049 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” **ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore.** Këto fenomene të dëmshme pengojnë zhvillimin e vendit, mirëqenien e përgjithshme dhe ndërtimin e një shteti të lirë e demokratik. Prandaj ligjvënësi ka synuar që në këtë betejë të rëndësishme për fatet e demokracisë në Shqipëri t’i sigurohet një pjesëmarrje aktive dhe publikut. Kjo pjesëmarrje garantohet përmes transparencës, njohjes dhe vlerësimit të publikut të gjerë edhe me të dhënat mbi deklarinmet e pasurisë së personave të zgjedhur apo zyrtarë. ... Në ushtrimin e detyrave dhe

funksiioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridike, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Deklarimi dhe regjistrimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, verifikimi i tyre si dhe mundësia e bërjes publike të të dhënave që kanë këto deklarime ndikojnë pozitivisht në identifikimin ose shmangien e rasteve të konfliktit të interesave, pra edhe të rasteve korruptive.... Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Pikërisht për këtë arsye, në jurisprudencën e vendeve të ndryshme demokratike është deklaruar se “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose kuazi – publike... ”.

55.6. Ky kolegji vlerëson të ndalet dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, ratifikuar me ligjin nr.9492, datë 13.03.2006, në nenin 8, pikat 1, 2 dhe 5 “Kodet e sjelljes për nëpunësit publikë “ parashikohet taksativisht: “**1. Me qëllim që të luftohet korrupsioni, secili shtet palë nxit, ndërmjet të tjerash, integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjësinë e nëpunësve të tij publikë, në përputhje me principet themelore të sistemit të tij ligjor.**

2. Secili shtet palë përpiqet, në veçanti, të zbatojë, brenda sistemeve të tij institucionale dhe ligjore, kodet ose standardet e sjelljes për ushtrimin korrekt, të ndershëm dhe të përshtatshëm të funksioneve publike.

5. Secili shtet palë, kur është e përshtatshme dhe në pajtim me principet themelore të ligjit të brendshëm, përpiqet të caktojë masa dhe sisteme që u kërkojnë nëpunësve publikë të bëjnë deklarata tek autoritetet e duhura, ndërmjet të tjerash, në lidhje me aktivitetet e jashtme, punësimin, investimet, pasuritë dhe dhuratat ose privilegjet e mëdha nga të cilat mund të lindë një konflikt interesash për shkak të funksioneve të tyre si nëpunës publikë”.

55.6.1. Duke marrë parasysh këtë parashikim të kësaj Konvente, nxitja që ky akt ndërkombëtar iu bën shteteve anëtarë është që nëpërmjet sistemit të deklarimit të pasurive të angazhohen strukturat shtetërore me qëllim parandalimin dhe kontrollin e korrupsionit dhe veprave të tjera penale të lidhura me detyrën shtetërore, prej të cilave përfitohen të ardhura të paligjshme.

55.7. Në konkluzion të sa më lart, bazuar në interpretimin sipas qëllimit të ligjit (*ratio legis*) - *interpretimin teleologjik*, pra, në kuptimin e normës penale-juridike sipas qëllimeve sociale që janë pretenduar të arrihen; në *interpretimin historik*, pra, kuptimit të normës penale-juridike sipas qëllimeve sociale që janë pretenduar të arrihet, së fundmi në *interpretimin logjik*, dhe ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, pranon se qëllimi i ligjvënësimit, apo objekti/marrëdhënia/e mira juridike në parashikimin e veprës penale, “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”, sipas paragrafit të dytë të nenit 257/a të Kodit Penal, është për të luftuar korrupsionin dhe veprat e lidhura me detyrën dhe për të kontrolluar pasuritë e vëna në mënyre abuzive, pra jo me burime të ligjshme. Pra, nga ana e funksionarëve të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, të cilët mund të vënë pasuri që rrjedhin nga përfitime të paligjshme, duke abuzuar me funksionin e tyre, si dhe për të parandaluar që persona që kanë vënë pasuri në mënyrë të jashtëligjshme, të mund të fillojnë punë në administratën e lartë shtetërore.

55.8. Gjithashtu, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit mbështet referencën e bërë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë në zbatimin e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe interpretimin në praktikë të komponentëve të kontrollit të pasurisë të subjekteve të rivlerësimit kalimtar. **Ky kolegji arsyeton** se, neni 33 i këtij ligji³⁹, i cili rregullon mënyrën dhe procedurën se si organi i ILDKPKI-së kryen kontrollin e pasurisë e verifikimin e deklarimeve të subjektit në deklaratat e pasurisë, në pikën 5 të tij parashikon se në çfarë forme dhe në çfarë opsionesh ky organ mund të shprehet në lidhje me deklarinë e bërë nga subjekti. Kjo procedurë kryhet bazuar në deklarinë e pasurive ndër vite dhe në një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, si dhe me *ligjin “Për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”*, ligjin *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”* dhe Kodin e Procedurave Administrative (pika 1). Pikërisht, në pikën 5 të këtij neni⁴⁰ përcaktohet se shtyllat e kontrollit të pasurisë lidhen, veç të tjerash edhe me verifikimin e situatave *“deklarimi i rremë”* dhe *“fshehjen e pasurisë”*, terma që gjenden edhe në paragrafin e dytë të nenit 257/a të Kodit Penal dhe në nenin 38⁴¹ të ligjit nr.9049 datë 10.04.2003. Kjo do të thotë se jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si Kolegji pranë Gjykatës Kushtetuese⁴², si organ gjyqësor⁴³, **mund të përdoret** në funksion të interpretimit të këtyre termave. Në këtë rast vlen *analogia juris*, si metodë interpretimi e termave në fjalë, që nënkupton se domethënia e normës del nga tërë sistemi juridik (analogjia në të drejtën penale është e lejuar, kur nuk është në kundërshtim me kuptimin dhe funksionin e *parimit të ligjshmërisë*, parim që ka gjetur rregullim në nenin 2 të Kodit Penal⁴⁴, nenin 29, pikat 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁴⁵ dhe nenit 7 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁴⁶).

³⁹ Në vazhden e parashikimeve të: Neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës përcakton qëllimin e procesit të verifikimit e kontrollit të pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit, për të identifikuar ato subjekte që kanë në pronësi më shumë pasuri nga sa mund të **justifikojnë ligjërisht**; Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës që parashikon parimin kushtetues të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të provuar **burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tij**; neni 30 i ligjit nr. 84/2016: Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij; neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve *për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*; Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin **për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit**.

⁴⁰ **Neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016**: “Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti i interesit; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d. subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

⁴¹ Neni 38 të ligjit nr.9049 datë 10.04.2003: “Deklarata dhe të gjithë dokumentet që e shoqërojnë atë janë dokumente zyrtare, rrjedhimisht dhe paraqitja në to e rrethanave të rreme përbën veprë penale”.

⁴² **Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës**: “ Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga **Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese**. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare **Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje**”.

⁴³ **Neni F, pika 1 i Aneksit të Kushtetutës**: “**Kolegji i Apelimit** përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është **organi i vetëm gjyqësor** që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjyqëse me pesë anëtarë secili.

⁴⁴ **Neni 2 i Kodit Penal**: “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj”.

⁴⁵ Neni 29, pikat 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “ Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, me përjashtim të veprave, të cilat në kohën e kryerjes së tyre, përbënin krime lufte ose krime kundër njerëzimit sipas së drejtës ndërkombëtare”.

⁴⁶ Neni 7 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: “ Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbente veprë penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi për një veprim ose mosveprim, i cili, në momentin kur është kryer, quhej veprë penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara”.

55.9. Në rrjedhën e arsytimit të mësipërm, ky kolegji i referohet praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit:

Vendimi nr.12, datë 06.07.2020: “58.Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka qenë i qartë dhe në dijeni të plotë të sipërfaqes reale të shtëpisë së banimit në pronësi të tij, të regjistruar në regjistrat publikë, por në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar një sipërfaqe ndërtimi, **e cila nuk i përgjigjet së vërtetës, me qëllim evidentimin e kontributit të pretenduar të babait të tij, kontribut i cili do të justifikonte burimin e krijimit të kësaj pasurie**, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit të shprehur në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë se subjekti i rivlerësimit ndodhet **në kushtet e deklaramit të rremë**, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016”.

Vendimin nr. 37, datë 24.11.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit: “10.12. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me faktin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar shumën prej 18.000 eurosh në vitin 2004, nuk është i saktë. Pavarësisht deklaramive jo të plota të subjektit në vitet 2003-2004 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklaramive të bëra prej tij qoftë në DPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast, subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në versionin e pranuar prej Komisionerit Publik se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi”.

55.10. Pikërisht, në rrjedhën e arsytimit të mësipërm mbi objektin juridik/të mirën juridike të mbrojtur nëpërmjet nenit 257/a/2 të Kodit Penal, që është pasuria dhe legjitimiteti i burimeve financiare të krijimit të saj për një kategori zyrtarësh të përcaktuar në këtë ligj, të cilët rezultojnë në shumë të ekspozuar ndaj korrupsionit, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, pasi ka konkluduar mbi të këtë (objektin/të mirën juridike), pranon dhe mbështet logjikën e arsytimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, lidhur me elementët e tjerë, ana objektive dhe ana subjektive të figurës së veprës penale, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Kjo gjykatë ka mbajtur qëndrimin e saj dhe ka interpretuar drejt mbi elementët e kësaj figure veprës penale, objekt, ana objektive dhe ana subjektive. **Si konkluzion, në vlerësim të këtij kolegji, deklarimi që të konsiderohet “i rremë” duhet, jo vetëm të mos i përgjigjet së vërtetës, por kjo të ketë ardhur si justifikim për të mbuluar burimin e krijimit ose financimit të pasurive, pasuri të cilat në fakt nuk mbulohen me burime të ligjshme.**

55.11. **Si konkluzion**, në vlerësim të këtij kolegji, shkaku i ankimit të prokurorit të posaçëm se për ekzistencën e kësaj veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal mjafton vetëm fakti që deklaruesja (e pandehura E.Ç.) ka deklaruar, fillimisht, më datë 17.07.2017 një natyrë të ndryshme burimi për blerjen e apartamentit të banimit (ndërturur me deklarimin e rremë lidhur me burimin e blerjes së tokës arë), pra, në thelb, pa qenë e nevojshme, verifikimi real i ligjshmërisë së burimeve financiare në vendosjen e pasurive për të cilat ajo efektivisht kishte përdorur burime financiare, nuk qëndron (koncepti “ligjshmëri e burimeve të krijimit” trajtohet në vijim).

56. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson të ndalet hollësisht në faktin, nëse dispozitat e ligjit të posaçëm me nr.9049 date 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të

detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” i japin mundësi strukturës kompetente, ILDKPKI-së, të ftojë subjektin deklarues vetëm për të ndrequr **gabime materiale ose plotësime të gabuara**, apo edhe më tej, të ftojë subjektin deklarues, në rastet kur konstatojnë se **deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruarat nuk identifkohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruarat**. Rikujtojmë këtu që shkaku i ankimit të prokurorit të posaçëm konsiston në faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabim material dhe se thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime (thirrja e të pandehurës E.Ç.) nuk mund të justifikojë pasqyrimin e deklarimit të rremë në momentin e deklarimit të pasurive.

56.1. Lidhur me këtë moment, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka konkluduar se: “... nuk konsiderohet deklarimi i rremë i pasurive, kur kemi të bëjmë me gabime materiale, parregullsi ku futen dhe mosplotësimi i të gjitha rubrikave të deklaratës, duke lënë pasuri të ligjshme të padeklaruarat apo plotësime të gabuara të deklaratës së pasurisë lidhur me burimin apo vlerën e pasurisë, për të cilat subjekti i deklarimit thirret nga ILDKPKI-ja për t’i ndrequr ato...”.

56.2. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se, referuar dispozitave të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, ligjvënësi ka dalluar dy momente: **a)** thirrjen e subjektit deklarues në fazën e përpunimit paraprak të deklarimeve për të ndrequr **gabime materiale, parregullsitë** dhe **b)** thirrjen e subjektit deklarues brenda vitit kalendarik për të dhënë shpjegime më të hollësishme dhe argumentet përkatëse. Më konkretisht, momenti i parë sqarohet në nenin 24, “Përpunimi paraprak”, dispozitë që parashikon se:

“Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimin të deklaratës dhe të ankeseve të saj.

*Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen **gabime materiale ose plotësime të gabuara**, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato. Deklaratat e interesave private pas dorëzimit dhe regjistrimit kalojnë menjëherë në skanimin fizik dhe ruhen në sistemin e programuar elektronik të ILDKPKI-së.*

Vetëm pas skanimit deklaratat e interesave private kalojnë në përpunimin paraprak, kontrollin aritmetik e logjik dhe më pas në kontroll të plotë.

Procedurat e pranimit, skanimit dhe përpunimit paraprak miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm”.

Nga përmbajtja e këtij neni rezulton, se qëllimi i thirrjes së subjektit në fazën e përpunimit paraprak, është ndreqja prej subjektit deklarues e gabimeve materiale dhe e plotësimeve të gabuara dhe po nga ky nen dhe nenet në vijim, sqarohen fazat tjera të kontrollit, **kontrollin aritmetik e logjik** dhe **kontrolli i plotë**. Nenet në vijim sqarojnë dhe rolin e ILDKPKI-së në këtë fazë për të thirrur subjektin deklarues dhe hapësirën ligjore që i është njohur këtij institucioni në funksion të saktësisë të deklarimit.

56.3. Në nenin 25 të këtij ligji nën titullin “Llojet e kontrollit”, parashikohet se: *“1. Kontrolli i deklarimeve përfshin kontrollet, aritmetik e logjik, dhe verifikimin e miratimit të të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë). Kontrollet, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklarim për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruarat dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruarat”.*

56.4. Neni 25/1 “Kontrolli i plotë i deklarimit të pasurive dhe interesave private”, pika 4 parashikon se: *“Kontrolli ose rikontrolli i plotë i deklarimit kryhet çdo herë që gjykohet e nevojshme nga*

Inspektori i Përgjithshëm, kur ai ka të dhëna, nga burime të ligjshme, që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarinimin e një zyrtari, si dhe kur ka mospërputhje, që rezultojnë nga kontrolli aritmetik e logjik, të cilat tregojnë se burimet nuk mbulojnë ose nuk justifikojnë të drejtat pasurore të deklaruesit”.

56.5. Neni 27 “Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime” parashikon se: “Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklarimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit”.

56.6. Nga interpretimi gramatikor i dispozitave të sipërcituara, nenet 25, 25/1, 27 të ligjit, rezulton se thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime në kuptim të nenit 27 tejkalon gabimet materiale ose plotësime të gabuara të përmendura në nenin 24, “Përpunimi paraprak”, pasi përfshin edhe situatën kur burimet e deklaruara nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara apo deklarimet nuk janë të sakta. Ky dallim ndërmjet thirrjes së subjektit në kuadër të përpunimit paraprak (neni 24) dhe thirrjes së subjektit në kuptim të nenit 27 dhe neneve 25 dhe 25/1, nxjerr në pah edhe një herë qëllimin e ligjvënësit, që nëpërmjet këtij ligji të posaçëm dhe kjo nëpërmjet tagrave që i janë dhënë ILDKPKI-së, të verifikojë, veç të tjerash, edhe ligjshmërinë e burimeve financiare të pasurive të deklaruara (arsyetuar më lart) në raport me pasuritë, si dhe mundëson kuptimin e termit “deklarim i rremë” në kuptim të këtij ligji, neni 38, por edhe të nenit 257/a/2 të Kodit Penal, pikërisht në mënyrën e analizuar edhe më lart nga ky kolegji (konkluzion i dhënë në paragrafin 55.10).

56.7. Të fokusuarit e Prokurorisë së Posaçme ndër shkaqet e ankimit vetëm në parashikimin e nenit 24 të ligjit të posaçëm, duke arsyetuar, në logjikën e ankimit në tërësi, si të vetmen mundësi të të përjashtuarit nga “Deklarimi i rremë”, si element i anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, ndreqjen e gabimeve materiale, situatë në të cilën nuk është gjendur e pandehura, në vlerësim të këtij kolegji bie ndesh me qëllimin e ligjit. Edhe ky kolegji vlerëson se situata e fakteve të të pandehurës E.Ç. në thirrjen nga ILDKPKI-ja për të dhënë shpjegime më datë 02.10.2022 nuk lidhet me parashikimin e nenit 24, por përfshihet në ato të nenit 27 të ligjit. Referuar edhe procesverbaleve ku janë dokumentuar këto shpjegime, pikërisht, kjo është dhe referenca ligjore e përdorur: “...**bazuar në nenin 27 të ligjit**....mbaj këtë procesverbal për të dokumentuar shpjegimet dhe marrjen e dokumentave...**U paralajmërua për përgjegjësinë që ka në bazë të nenit 38 në rast deklarimi të rremë**”.

56.8. Nga ana tjetër, ky kolegji mbështet konkluzionin e arritur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, se deklarata e pasurisë në rastin konkret konsiderohet e saktësuar me shpjegimet që ka dhënë subjekti deklarues në procesverbalin e mbajtur nga Inspektorët e ILDKPKI-së e që i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë, për sa kohë rezultojnë legjitimiteti i burimeve financiare të krijimit të pasurive, për të cilat e pandehura rezultojnë të ketë vënë... Për pasojë, akuza penale do të qëndronte vetëm nëse në përfundim të hetimit do të provohej e kundërta e asaj që ka shpjeguar e pandehura pranë ILDKPKI-së më datë 02.10.2017”. Megjithatë ky kolegji vlerëson se, sikurse është pasqyruar dhe në përmbajtje të procesverbaleve ku janë dokumentuar shpjegimet, por edhe referuar rrethanave të faktit lidhur me subjektin deklarues/të pandehurën E.Ç., deklarata e saj para fillimit të detyrës konsiderohet e saktësuar në kuadër të shpjegimeve të marra në përputhje me nenin 27 të ligjit, dokumentuar me procesverbal (dhe jo në lidhje me nenin 24).

56.9. Si konkluzion, shkaku i ankimit të prokurorit të posaçëm që konsiston se në rastin konkret, pavarësisht dokumentimit të shpjegimeve të subjektit deklarues, të pandehurës E.Ç., shpjegimet nuk mund të justifikojë pasqyrimin e deklarimit të rremë në momentin e deklarimit të pasurive, pasi vepra penale quhet e kryer në momentin e deklarimit, **gjendet nga ky kolegji i pabazuar**.

57. Edhe ky kolegji vlerëson se paraqet shumë rëndësi të vlerësuarit se cilat konsiderohen **burime financiare të ligjshme/legjitimimi i burimeve financiare**. Analiza që i është bërë këtij momenti nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë vlerësohet e drejtë dhe pjesa e cituar në vijim bëhet pjesë e qëndrimit edhe të këtij kolegji: “...Gjykata çmon të sqarojë kuptimin e togëffalëshit “burimi i ligjshëm i krimit të pasurive”, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi. Për të përcaktuar se kush do të konsiderohet burim i ligjshëm i të ardhurave në legjislacionin shqiptar, duhet t’i referohemi Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenit 4 të këtij ligji nën titullin “Burimi i të ardhurave”⁴⁷**Parashikimi i rasteve të përshkruara në këtë nen, lehtësisht lexohet si një mënyrë për të përshkruar në terma të përgjithshëm e përshkruar çdo aktivitet ligjor të lejuar në territorin e vendit, i cili, i normuar me rregulla të posaçme, do të konsiderohet si burim i krijimit të të ardhurave, të cilat do të jenë objekt i tatimit mbi të ardhurat personale. Përcaktimi i këtyre burimeve do të duhej të kuptohej si përcaktimi i aktiviteteve të ligjshme apo burimeve të ligjshme të cilat krijojnë të ardhura të ligjshme për subjektin e rivlerësimit. Në kuptim të dispozitave të mësipërme, subjekti deklarues duhet të provojë se si burim i krijimit të të ardhurave që do të konsiderohen të ligjshme, duhet të jetë një nga marrëdhëniet e përshkruara në nenin 4 të ligjit nr.8438/1998 ose ndonjë formë tjetër, e cila jo vetëm nuk është e ndaluar nga legjislacioni, por duhet njëkohësisht të ketë një parashikim ligjor për lejimin e atij lloj aktiviteti”**.
.....gjatë gjykimit u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm se si burim për krijimin e pasurisë **Apartament banimi me sipërfaqe 70.80 m²**, {..., është kredia e marrë pranë {...} Bank, që sipas kuadrit ligjor konsiderohet **burim i ligjshëm** për krijimin e pasurive. Po ashtu, gjatë gjykimit u provua se kredia është paguar rregullisht duke i likujduar përpara afatit të parashikuar në Kontratën e Kredisë” (citim).

Ky kolegji shton se përdorimi i të ardhurës nga kredia, si një e ardhur që nuk është e ndaluar nga legjislacioni (njëkohësisht është i bazuar në një parashikim ligjor për lejimin e atij lloj aktiviteti), **në**

⁴⁷ “**Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:**

a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë; **b)** të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; **c)** të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; **d)** të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; **dh)** të ardhurat nga: **i)** pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë; **ii)** të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave; Të drejtat dhe informacioni i përmendur në nënndarjet “i” dhe “ii”, më sipër, për qëllime të këtij ligji, trajtohen si pasuri e paluajtshme. **e)** të ardhurat nga tjetërsimi i: **i)** pasurisë, të drejtave dhe informacionit të përmendur në shkronjën “dh” të këtij neni; **ii)** aksioneve ose interesave të ngjashëm, të tillë si interesat në ortakëri ose truste, sipas përkufizimeve në legjislacionet përkatëse, kudo që ndodhen, në qoftë se, në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 për qind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, të përmendura në shkronjën “dh” të këtij neni. **ë)** të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident; **f)** të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente; **g)** të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qëndrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jo rezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; **gj)** të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfitozoza; si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit. **h)** të ardhurat e një personi joresident, të përfuara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person resident. **i)** të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.”

një destinacion de facto të ndryshëm nga ai de jure/që përshkruhet në kontratën me institucionin financiar kredidhënës, nuk e kthen këtë burim në burim të paligjshëm të ardhurash.

57.1. Në konkluzion, ky kolegji vlerëson se nga e pandehura E.Ç., nuk është konsumuar elementi objektiv **“deklarimit të rremë”**, në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 257/a/2 të Kodit Penal, në deklaratën (DPV-në) e vitit 2017, para fillimit të detyrës, në rubrikën **“Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”**, në lidhje me burimin e blerjes së apartamentit të banimit, përderisa **e pandehura e ka saktësuar këtë deklaram** në bazë të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 **“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”**, si dhe rezulton që **ka burime financiare të ligjshme** për ta blerë këtë apartament.

58. Lidhur me tokat bujqësore, sikurse u analizua më lart nga ky kolegji, rezulton e provuar se pandehura E.Ç. **de facto nuk ka kryer shpenzime, megjithëse ka mundësuar** regjistrimin në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme të tyre (tokave) në emër të saj nëpërmjet kontratave të titulluara kontratë shitje, të lidhura me qëllim marrjen e kredisë (dhe vendosjen më pas si kolateral të tokës bujqësore), **pasi veprimi juridik i paraqitur si kontratë shitblerje me familjarët e saj, de jure ka qenë fiktiv.** Lidhur me këto pasuri ajo, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 **“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”** e ka saktësuar deklarin dhe **në konkluzion,** ky kolegji vlerëson se nga e pandehura E.Ç., nuk është konsumuar elementi objektiv **“deklarimi të rremë”**, as në lidhje me këtë pasuri në rubrikën **“Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”**.

58.1. Ky kolegji vlerëson se vlefshmëria në aspektin civil i veprimeve juridike **“Kontrata shitjeje”** të tokave bujqësore për sa i përket vullnetit të palëve kontraktore, nuk paraqet rëndësi në kuadër të akuzës penale atribuar të pandehurës E.Ç.. Në linjën e arsytimit të mësipërm, në këtë drejtim i rëndësishëm paraqitet fakti se **burimet financiare të ligjshme të** deklaruara në kuadër edhe të saktësimeve të kryera janë të mjaftueshme për të mbuluar **pasuritë për të cilat ajo ka investuar me burime financiare.**

58.2. Të fokusuarit në një analizë financiare (përgatitur nga hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit) dhe në një përlllogaritje të vlerës së shpenzimeve, mbi pamundësinë financiare dhe diferencat negative të të pandehurës për të investuar me burime të ligjshme për të gjitha pasuritë e vitit 2006, sipas deklaratës së pasurisë së dorëzuar fillimisht (pa marrë parasysh thirrjen për shpjegime nga ILDKPKI-ja), pra, duke përfshirë dhe marrë të mirëqenë dhe investim real për tokën bujqësore, paraqitet në kundërshtim me faktet e rezultuara jo vetëm gjatë gjykimit në apel, por të rezultuara edhe gjatë fazës së hetimit dhe pranuar po kështu edhe nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë. Gjithsesi, ky kolegji, duke marrë parasysh: **(i)** aktin e njoftimit të akuzës, ku pasqyrohen faktet historike atribuar të pandehurës si **“Deklarim i rremë”** (fq.29 e këtij akti të njoftimit të akuzës), përmbledhur në paragrafin 42.1. të këtij vendimi, **(ii)** qëndrimin e vetë prokurores së posaçme në përgjigje të memories së të pandehurës E.Ç. në raport me këtë analizë financiare: **“...në lidhje me pretendimet mbi analizën financiare, sjellim në vëmendje se përveçse ajo nuk ndikon në akuzën e ngritur, është kryer në përputhje me të dhënat e administruara...”**, **(iii)** shkaqet e ankimit të prokurores së posaçme, **(iv)** qëndrimin e saj në analizën mbi provat shkresore gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, ku pranon se **“qëllimi i analizës financiare është të provuarit e pamundësisë ekonomike e të pandehurës për të blerë të treja pasuritë në vitin 2006”**, kur ndërkohë pranon edhe faktin se për pasuritë tokë bujqësore familjarët nuk janë paguar nga e pandehura, **edhe ky kolegji,** sikurse ka pranuar dhe vetë akuza në përgjigje të memoris së paraqitur nga e pandehura,

ajo ç'ka synohet të provohet nga akuza nëpërmjet kësaj analize financiare, nuk ka asnjë ndikim në akuzën e ngritur/faktet e konsideruara nga akuza si “Deklarim i rremë” në deklaratën e deklarimit të pasurisë para fillimit të detyrës së të pandehurës E.Ç., në raport edhe me faktet e rezultuara të provuara edhe për këtë kolegji.

58.3. Ky kolegji konstaton se pas saktësimit të DPV-së së vitit 2017, e pandehura E.Ç. në vitet 2018, 2019 dhe 2020 në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ajo ka pasqyruar “kredi për blerje toke arë”, ndërsa në DPV-në e vitit 2021, e pandehura në këtë kolonë përshkruan vetëm natyrën e kredisë si detyrim. Sipas akuzës, kjo e çon deklarimin e saj në përputhje me deklarimin e vitit 2017. Këtë pjesë të deklarimit, akuza e konsideron pjesë të të njëjtit fakt penal “deklarim i rremë” me karakter vazhdues.

58.4. Ky kolegji arsyeton se dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private”, përfshirë edhe atë të plotësuar nga e pandehura E.Ç., **para fillimit të detyrës**, është miratuar me “Urdhër Nr.223, datë 09.05.2017 nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI, “Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave private”. Secila rubrikë ka një qëllim më vete. Rubrika “Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” ka vetë të përshkruar në formatin e saj se objekti i deklarimit janë pasuritë dhe burimi i krijimit, vlera në lekë apo valutë, çmimi i blerjes etj. Pra, në këtë rubrikë synohet të evidentohen pasuritë dhe legjitimiteti i burimeve. Ndërsa rubrika “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka vetë të përshkruar në të: detyrimet financiare, qëllimin e detyrimit etj. Këto rubrika të deklaratës detajojnë detyrimet për zbatim të nenit 4 të ligjit nr.9049/2003 dhe gërma “dh” parashikon: [...] *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) **detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në leke ose në valutë të huaj [...]**.*

Në vitet 2018, 2019 dhe 2020 e pandehura E.Ç. ka plotësuar deklaratën e kontrollit periodik vjetor si subjekt deklarues, pra, në detyrë. Referuar formatit të kësaj deklarate⁴⁸, në përshkrimin e seksionit “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” në deklaratën e interesave private periodikë kërkohet nga deklaruesit të deklarohen **ndryshimet** nga deklarimi paraardhës në secilën nga rubrikat, pra, në rubrikat “*Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit*” (shtesa pakësime) dhe në rubrikën “*Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*”, pra, detyrimet e lindura gjatë vit të deklarimit dhe detyrimet e mbetura ende pa u shlyer, por të deklaruara më parë. Fakti që në kolonën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” e pandehura ka vijuar ta përshkruajë kredinë me termat e përmbajtjes së kontratës së huasë/kredisë, **e cila në fakt deklarohej jo si detyrim i lindur gjatë periudhës së deklarimit, por për efekt të pjesës së mbetur pa shlyer nga deklarimi i mëparshëm**, nuk tregon dashjen e saj për deklarim të rremë për sa i përket përdorimit të kredisë, rrethana të sqaruara më herët prej saj në kuadër të deklarimit fillestar, atë para fillimit të detyrës, përfshirë edhe shpjegimet e dhëna në kuadër të nenit 27 të ligjit, dokumentuar me procesverbal.

Në këtë kontekst, e pandehura E.Ç. nuk ka synuar “deklarimin e rremë” në kuptimin juridik të dhënë nga ky kolegji për këtë element të anës objektive të nenit 257/a/2 të Kodit Penal në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi (përfshirë të gjithë analizën) dhe nuk qëndron argumenti i akuzës se ky fakt e çon deklarimin e saj në përputhje me deklarimin e vitit 2017, deklarim të cilin, sikurse u arsyetua, e ka saktësuar me shpjegime (këto deklarime që përkojnë me deklarimet e viteve 2018,

⁴⁸ Shih deklaratës periodike vjetore në: <http://www.ildkpkj.al/formulare-e-deklarimit/>.

2019 dhe 2020 janë trajtuar nga akuza si "deklarim i rremë" vazhdues me deklarinimin e rremë në deklaratën para fillimit të detyrës, duke u formalizuar në një figurë vepre penale).

58.5. Nisur nga fakti që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka arsyetuar, referuar një sërë dispozitash të Kodit Civil dhe praktikës gjyqësore lidhur me veprimet juridike fiktive dhe të simuluar, duke konkluduar se: *"i është kaluar⁴⁹ të pandehurës E.Ç. nëpërmjet **veprimit juridik të mbuluar** që është **dhurimi**, pasi Kontrata e Shitjes me Nr.{...} Rep, dhe Nr.{...} Kol., datë {...}, si dhe kontrata e shitblerjes me Nr.{...} Rep, dhe Nr.{...} Kol., datë {...}, janë veprime juridike simuluese, për të gjitha arsyet që përmenden në paragrafët 37.4.3, 37.4.4, 37.4.5, 37.4.6, 37.4.7, 37.4.8 dhe 37.5.1 të këtij vendimi. Pra, burimi për krijimin e këtyre pasurive është dhurimi dhe jo shitblerja. Kjo për shkak të marrëdhënies së posaçme të të pandehurës me familjarët e saj. Familjarët e të pandehurës e kanë fituar pronësinë mbi këto pasuri bazuar në Ligjin 7501 "Për tokën", fakt i cili bën që mos të vihen në dyshim mënyra e fitimit të pronësisë"* (citim), prokurorja e posaçme ka ngritur në ankim një sërë rrethanash kundërshtuese si:

"- Veprimi që palët kanë dashur të fshehin, nuk ka qenë ai që konkludon gjykata e shkallës së parë, pra, "dhurimi", por ka qenë marrja e një kredie për blerje apartamenti....regjistrimi (pra regjistrimi në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dikur Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës) në emër të të pandehurës është në kundërshtim me ligjin, pasi nuk mund të regjistroheshin me kontratë shitje. Ndërkohë që e pandehura ishte bashkëpronare, kontratat nuk mund të konsiderohen as dhurim.

- Veprimi juridik i shitjes që arsyeton gjykata se fsheh veprimin juridik të dhurimit, nuk qëndron, pasi e pandehura është bashkëpronare në këto prona dhe ka marrë gati 1/5 tokë sa i takon. Rruga e duhur ligjore, nëse e pandehura nuk dëshironte të ishte më në bashkëpronësi, do të kishte qenë pjestimi i sendit. Dy sipërfaqet e tokave të të pandehurës E.Ç., janë fituar në mënyrë të kundërligjshme, pasi përveçse nuk është ndjekur rruga e duhur ligjore, rezulton se një prej bashkëpronarëve nuk ka nënshkruar. Sidoqoftë, e pandehura nuk është sjellë në gjykim për falsifikim në lidhje me këto dy kontrata, që gjenden tek noteri dhe në ASHK, por për një kontratë të falsifikuar që paraqet të dhëna të ndryshme nga njëra prej kontratave që gjendet tek noteri dhe në ASHK, konkretisht, për një kontratë ku ndryshon dukshëm çmimi, shumë herë më i lartë.

- Në mashtrim me ligjin në praktikat e shitjes së tokës nuk është administruar çertifikata familjare e vitit 1991, që tregonte se e pandehura dhe motra e saj ishin bashkëpronare, por është administruara çertifikata familjare e vitit 2006.

-Tokat bujqësore vijnë të jenë të regjistruara në kundërshtim me ligjin në emër të të pandehurës".

58.6. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit arsyeton se, interpretimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë mbi sa më lart paraqitet i panevojshëm në kuadër të trajtimit akuzës së parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, deklarim i rremë i pasurisë, lidhur me deklarinimin e të pandehurës E.Ç. para fillimit të detyrës (deklarim i vitit 2017), të saktësuar konform nenit 27 të ligjit (mbi këtë moment në kuadër të akuzës "Falsifikimi i dokumentave", analizohet edhe në vijim).

58.7. Nga ana tjetër, është fakt që e pandehura E.Ç. do të mundësonte regjistrimin në regjistrat publik të sipërfaqes ideale që i përkiste asaj si bashkëpronare duke formalizuar marrëveshje për ndarjen në natyrë (reale) të sipërfaqes takuese ndërmjet bashkëpronarëve, familjarë. Ky regjistrim në regjistrat publik i pronës në emër të të pandehurës i ka shërbyer bankës si mjet për të garantuar përmbushjen e ekzekutimit të detyrimit, si hipotekë në dhënien e kredisë, *de fakto* për blerjen e apartamentit të

⁴⁹ Toka bujqësore

banimit, regjistrim që në fakt u mundësua në regjistrat publik, por nëpërmjet rrugës së veprimit juridik/kontratës së shitblerjes fiktive. Këto veprime janë kryer të gjitha nisur nga fakti se apartamenti që do të blihej nga e pandehura nuk ishte i regjistruar në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (as në emër të vetë shoqërisë ndërtuese, palës shitëse⁵⁰, pasi regjistrimi në emër të saj daton 21.04.2010) dhe për pasojë i paaftë për t'i shërbyer institucionit kredidhënës si mjet për të garantuar përmbushjen e ekzekutimit të detyrimit, pra të kredisë⁵¹. Gjithsesi, në kuadër të pretendimeve të ngritura në ankim mbi kundërligjshmëritë e veprimeve juridike/kontratave të shitjes së tokës bujqësore të lidhura nga e pandehura E.Ç. dhe familjarët e saj (që u ricituan në paragrafin 58.5 të këtij vendimi, por në mënyrë të detajuar u dhanë në shkaqet e ankimit, paragrafi 10 i këtij vendimi) apo mënyrën e duhur ligjore në aspektin civil sesi e pandehura E.Ç. do të mund të regjistronte në emër të saj në regjistrat publikë të regjistrimit të pronave të paluajtshme, pronën e fituar me ligjin “Për tokën”, pronare në pjesë ideale të barabartë me familjarët e saj⁵² (pra, të finalizonte me regjistrim në regjistrat e pasurive të paluajtshme të drejtat reale që ajo gëzonte mbi pasurinë tokë bujqësore të regjistruar në emër të kryefamiljarit/babait të saj), **ky kolegji e vë theksin tek dallimi ndërmjet kundërligjshmërisë penale dhe kundërligjshmërisë civile apo të formave të tjera të kundërligjshmërisë.** Kundërligjshmëria penale përbën vullnetin e ligjvënësit që, për shkak të rëndësisë së të mirës juridike që çënohet, shkelje të caktuara t'i përfshijë në kundërligjshmërinë penale dhe në dispozitat përkatëse materiale penale. E drejta penale është masa e fundit për t'u ndërmarrë nga ligjvënësi për ato çënime serioze që iu bëhen të mirave juridike, në kuptimin e atyre marrëdhënieve juridike të mbrojtura nga rendi juridik. Pikërisht, jo pa qëllim ky kolegji më lart (në paragrafin 55.1. të këtij vendimi) arsyetoi gjerësisht si një ndër elementët formues të veprës penale, referuar dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, *kundërligjshmërinë në aspektin penal*, që nënkupton se veprat duhet të jenë të parashikuara nga ligji si të tilla, pra, si vepra penale (në kohën e kryerjes).

58.8. Në këtë rrjedhë arsyetimi, konsideratat e mësipërme të karakterit ngushtësisht civil të palës ankuese, të lidhura me pavlefshmërinë juridiko-civile të këtyre kontratave (duke pranuar që, edhe në aktin ankim, se *e pandehura nuk është sjellë për gjykim për fiktivitetin*, por është sjellë për gjykim përse ka nënshkruar dhe në vijim ka përdorur një kontratë të ndryshme nga ajo që gjendet tek noteri dhe në ASHK⁵³), konsiderata këto në funksion të kundërshtimit të linjës së arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë (mbi momente që nuk kanë asnjë ndikim në veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal dhe, për pasojë, të panevojshme), nuk janë të nevojshme të trajtohen nga ky kolegji. Procesi penal nuk ka për qëllim dhe nuk mund të sjellë zgjidhjen e pasojave të palëve pjesëmarrëse në veprime juridike fiktive. Palët e një marrëdhënie kontraktore janë të lira t'i zgjidhin pasojat e veprimeve juridike fiktive, të saktësojnë të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme dhe t'i reflektojnë ato në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

58.9. Në konsideratë të pretendimit të prokurorit të posaçëm se gjykata e shkallës së parë “*mund të shihet edhe pasurimin e paligjshëm që i ka ndodhur shtetas E.Ç., e cila tashmë rezulton të ketë regjistruar dy prona, sipërfaqe tokë arë...*”, pasi veprimet juridike janë të pavlefshme dhe nuk krijojnë pasoja juridike sipas nenit 92, gërma “a” të Kodit Civil, ky kolegji thekson se paraqet shumë

⁵⁰ Regjistrimi në emër të shoqërisë “Halili” i apartamentit të banimit është bërë më datë 21.04.2010.

⁵¹ Kontrata e shitblerje me Nr.2710 Rep, Nr.1424 Kol me shitës shoqëria “Halili” sh.p.k dhe blerës shtetasit Etleda dhe Dejvi Çiftja, daton 30.11.2016.

⁵² Sipërfaqe e përputhur me atë që është bërë objekt i kontratave të shitblerjes

⁵³ Fq.31 e ankimit

rëndësi të evidentohet fakti se regjistrimi i një prone në regjistrat publik, si rezultat i një veprimi juridik të pavlefshëm/kontratë shitblerje fiktive, në të cilën palët as kanë pasur si qëllim, dhe as është paguar çmim, nuk përbën *pasurim të paligjshëm* në konceptin e nevojës së penalizimit të shtruar për shtetet anëtare nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, ratifikuar me ligjin nr.9492, datë 13.03.2006. Në nenin 20 të saj, nën titullin “**Pasurimi i paligjshëm**” është parashikuar, “*Në përputhje me Kushtetutën dhe principet themelore të sistemit të tij ligjor, secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim pasurimin e paligjshëm, që është një rritje e madhe e pasurisë së një nëpunësi publik që ai ose ajo nuk mund ta justifikojë me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme*”. Megjithëse legjislacioni ynë penal rezulton se nuk ka parashikuar një vepër të tillë penale, pra, nuk është përqsaur ligji penal material në këtë pikë me parashikimin e Konventës, është e qartë se qëllimi i Konventës është të nxisë shtetet anëtare të penalizojnë *pasurimin e pajustificuar me të ardhura të ligjshme, duke synuar të luftohet korrupsioni dhe informaliteti në radhët e zyrtarëve publikë*, situatë që nuk lidhet me rrethanat e faktit material rezultuar në kuadër të procedimit penal të të pandehurës E.Ç..

59. Në konkluzion, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme e Apelit, ka qëndrim të njëjtë me atë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë se, fakti i rezultuar i provuar nuk përbën veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, rrethanë kjo e parashikuar nga neni 388 pika 1, gërma “b” i K.Pr.Penale, pra, një ndër rastet kur gjykata merr vendimin e pafajësisë. Në vlerësim të këtij kolegji mungojnë elementëve formues të figurës së veprës penale, ana objektive dhe ana subjektive, dashja, si formë faji e kryerjes së kësaj vepre penale. Shkaqet e ankimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në kuadër të kërkimit për ndryshimin e vendimit nr.48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, duke e deklaruar të pandehurën fajore për këtë akuzës konsiderohen të pabazuara.

Në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal

60. Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë ka arsyetuar, në funksion të elementëve të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, dmth në kuptim të elementëve të sjelljes penalisht të dënueshme se: “...me falsifikim të dokumenteve kuptojmë paraqitjen në të të rrethanave të rreme ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, si dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara. Falsifikimi i dokumentit mund të bëhet në **dy mënyra**: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi të, duke bërë shtesa, korigjime, ndryshime dhe çdo veprim tjetër material (falsifikim material) ose duke falsifikuar përmbajtjen e tij, pa prekur formën e dokumentit (falsifikim intelektual). Ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se figura e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga ana objektive kryhet në dy forma: nëpërmjet “falsifikimit të dokumenteve” dhe nëpërmjet “përdorimit të dokumenteve të falsifikuara” nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Në formën e parë të kryerjes është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së falsifikimit dhe në pamundësi të saj përjashtimi nga kjo autorësi e pjesëmarrësve në proces. Po ashtu, që të arrihet në konkluzionin se jemi përpara kryerjes së veprës penale të parashikuara nga neni 186/1 i Kodit Penal në formën e përdorimit, do të duhet së pari të provohet përdorimi i aktit, por njëkohësisht të vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale se akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar...”.

60.1. Më tej, Gjykata e Posaçme së Shkallës së Parë, sikurse u arsyetua edhe më lart, ka bërë një analizë dhënë konsiderata thellësisht të natyrës civile mbi kuptimin e veprimeve juridike fiktive ose të simuluar dhe konkluzioni e arritur, i cituar në paragrafin 58.5. të këtij vendimi, ricitohet: “... i është kaluar⁵⁴ të pandehurës E.Ç. nëpërmjet **veprimit juridik të mbuluar që është dhurimi, pasi kontrata e shitjes me nr.{...} Rep, nr.{...} Kol, datë {...}, si dhe kontrata e shitblerjes me Nr.{...} Rep, dhe Nr.{...} Ko., datë {...}, janë veprime juridike simuluese, për të gjitha arsyet që përmenden në paragrafët 37.4.3, 37.4.4, 37.4.5, 37.4.6, 37.4.7, 37.4.8 dhe 37.5.1 të këtij vendimi. **Pra, burimi për krijimin e këtyre pasurisë është dhurimi dhe jo shitblerja.** Kjo për shkak të marrëdhënies së posaçme të të pandehurës me familjarët e saj. Familjarët e të pandehurës e kanë fituar pronësinë mbi këto pasuri bazuar në Ligjin 7501 “Për tokën”, fakt i cili bën që mos të vihen në dyshim mënyra e fitimit të pronësisë... ”.**

60.2. Pas referimit dhe analizës të dispozitave të Kodit Civil mbi veprimet juridike, pavlefshmërinë e tyre, veprimet juridike fiktive dhe të simuluar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë arsyeton se: “...kontratat janë produkt i vullnetit të palëve që nënshkruajnë atë. Prandaj, nëse një kontratë është apo jo origjinale, varet nëse ajo është e nënshkruar dhe është shprehje e vullnetit të palëve që janë pjesë e saj. Sipas doktrinës të së drejtës penale **karakteristikë e veprës penale falsifikimi i dokumentit është ajo se dokumenti nuk rrjedh nga personi i cili është shënuar në të si lëshues (dhënës) i tij.** Atë e bën të rremë fakti se ai i atribuohet personit, i cili nuk e ka lëshuar atë dhe tentohet që të krijohet përshtypja se, pikërisht, një person i caktuar është lëshues (dhënës) i tij (dokumentit), edhe pse në fakt ai nuk e ka lëshuar. **Dokument i rremë ekziston edhe atëherë kur përmbajtja e tij është e saktë, por atë nuk e ka lëshuar personi i cili në dokument është shënuar si lëshues (dhënës) i tij....** Dallimi mes përpilimit të dokumentit të rremë dhe ndryshimit të dokumentit origjinal (autentik) qëndron në atë se përpilimin e dokumentit e karakterizon fakti se ai nuk rrjedh nga personi i cili në dokument është shënuar si lëshues (dhënës) i tij, ndërsa ndryshimi i dokumentit autentik nënkupton ndryshimin e paautorizuar të përmbajtjes së dokumentit, i cili, pas kësaj, nuk shpreh më deklaratën e dhënësit”.

60.3. Vijon arsyetimi nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë: “... Mbështetur në sqarimin e kuptimit të falsifikimit të dokumenteve, Gjykata çmon se Kontrata e Shitblerjes me Nr.{...} Rep, dhe Nr.{...} Ko., datë {...}, si dhe Kontrata e Shitblerjes me Nr.{...} Rep, dhe Nr.{...} Ko., datë {...}, të lidhur përpara noterës Luljeta Kongoli, me palë: **Shitësit: R.K., S.K. dhe E.K.; Blerës: E.Ç., nuk futen në kategorinë dokumenteve të falsifikuara, pasi këto dokumente janë origjinale dhe shprehje e vullnetit të palëve.** Do të ishim përpara falsitetit të tyre, nëse ky dokument nuk do të rridhte nga palët. **Sipas nenit 659 të Kodit Civil, në rastin konkret, palët kanë të drejtë të krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.** Në rastin konkret, këto kontrata hyjnë në kategorinë e veprimeve juridike simuluese, pasi **qëllimi i vërtetë i palëve në lidhjen e këtyre kontratave ka qenë të mbulojë veprimin juridik të dhurimit, i cili përmbush të gjitha kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij, me qëllim sigurimin e një kredie bankare nga e pandehura E.Ç. për të financuar apartamentin e vetëm që ajo ka në pronësi...**”.

60.4. Në përfundim të analizës së anës objektive të veprës penale “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, për të cilën është akuzuar e pandehura E.Ç., konkludohet se veprimet juridike fiktive ose simuluese që janë absolutisht të pavlefshëm nuk përbëjnë vepër penale dhe hyjnë në kategorinë e dokumateve që sipas praktikës konsiderohen falsifikim i padëmshëm.

⁵⁴ Toka bujqësore

60.5. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë ka arsyetuar se: “... *vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, parashikon si formë faji, vetëm atë të dashjes, në kuptimin që autori i veprës penale, e parashikon dhe e dëshiron faktin e falsifikimit, apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar. Çka nënkupton se dashja konsiston në dijeninë e subjektit, jo vetëm për të falsifikuar, por edhe për të cënuar marrëdhënien juridike që dokumenti, objekt falsifikimi, ka për qëllim të kryejë. Në këto kushte, një qëllim i padëmshëm apo i ndryshëm, qoftë edhe i supozuar në mënyrë të gabuar se qëllimi i të vepruarit nuk ishte falsifikimi, nuk mund të përbëjë objekt inkriminimi nga norma penale për veprën e falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Rrjedhimisht, falsifikimi përjashtohet kur subjekti vepron për qëllime të tjera nga ato për të përfituar padrejtësisht (animus nocendi), duke synuar të veprohet në të mirë të institucionit, si dhe nëse subjekti nuk cenon funksionin konkret që dokumenti kryen. Pra, nuk mjafton vetëm dashja e krijimit të një dokumenti fals (intentio decipiendi), kur autori beson se po vepron me një qëllim jo penal, i udhëhequr nga mbarëvajtja e punës, qoftë edhe në mënyrë të gabuar, por kërkohet edhe cënimi konkret i funksionit të aktit. Nëse subjekti nuk është i ndërgjegjshëm për cënimin dhe kompromentimin e interesit që dokumenti luan në rastin konkret, atëherë nuk mund të ketë një qëndrim psikik në dashjen e anës objektive të kësaj vepre penale. Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se gjatë gjykimit u provua se nuk është konsumuar nga ana objektive kjo vepër penale. Në këto kushte, përderisa nuk ekziston ana objektive, pra, veprime të paligjshme në kuptimin penal, atëherë nuk kemi as faj, pasi mungon si elementi intelektual, ashtu dhe ai volutiv, që të ekzistojë faji si element thelbësor i përgjegjësisë penale... ”.*

60.6. Në përfundim, bazuar në nenin 388 pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë, ka konkluduar, në mungesën e elementëve të anës objektive dhe subjektive, duke e deklaruar të pafajshme të pandehura E.Ç. për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

61. Përsa iu përket **rrëthanave të faktit historik**, të lidhura ngushtësisht me akuzën e atribuar të pandehurës E.Ç. për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pa dalë në përsëritje të atyre fakteve të përshkruara në pjesën III “Rrëthanat e faktit dhe provat, faktet penale atribuar të pandehurës E.Ç.” dhe atyre të përshkruara në paragrafin 52 të këtij vendimi, në funksion të akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, **në vijim të tyre, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, pas përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, gjen të provuar, faktet si më poshtë:**

Në funksion të përfitimit të kredisë për blerjen e apartamentit, e pandehura E.Ç. ka kryer veprimet fiktive, kontrata shitblerje të tokave bujqësore. Ajo ka lidhur kontratat e shitblerjes me familjarët e saj, të cilët kanë qenë në përbërje të familjes në momentin e lidhjes së kontratave, pranë noteres Luljeta Kongoli, toka të përfituara me ligj, nëpërmjet aktit të marrjes së tokës në pronësi me nr.1128, datë 15.09.1995 me kryefamiljar shtetasin R.K., duke përfituar gjithsej familja 27191 m² tokë (në përbërje të familjes ka qenë edhe e pandehura në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit “Për Tokën”). Pikërisht, njëra prej sipërfaqeve të tokës bujqësore, objekti i njërës prej kontratave të shitblerjes më tej, do t’i shërbente kredimarrëseses/të pandehurës E.Ç. si mjet për garantimin e kredisë/huasë. Pra, rezulton se është hartuar kontrata e shitblerjes me nr.{...} Rep, nr.{...} Kol, datë 06.07.2006, e lidhur përpara noteres Luljeta Kongoli me palë: shitës R.K., S.K. dhe E.K.; blerës: E.Ç.. Objekti i kësaj kontrate është shitja e sipërfaqes së tokës arë prej 3440 m² në {...}, Kavajë që shitësat kanë në pronësi sipas certifikatës së pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Çmimi i kësaj kontrate është

300.000 (treqind mijë) lekë. Kjo kontratë ka pjesë të saj kartelën e pasurisë në emër të shitësit që daton {...}.

Kjo kontratë, pra, ajo me çmim 300.000 (treqind mijë) lekë, është paraqitur për t'u regjistruar në Z.V.R.P.Paluaajtshme Kavajë më datë 31.07.2006.

Ndërkohë, institucioni kredidhënës ka bërë vlerësimin e pasurisë me nr.131/54 me sipërfaqe 3440 m², në vlerën 48.000 euro, si vlerë e tregut të lirë të pronave, sipas raportit të vlerësimit kryer nga studio "{...}" sh.p.k, angazhuar nga vetë banka dhe vlera e likuidimit në shumën 38.500 euro. Data e raportit të vlerësimit rezulton dt.06.09.2006. Gjashtëmbëdhjetë (16) ditë pas regjistrimit të pronës/tokës bujqësore në emër të të pandehurës, kjo e fundit aplikon për kredi, dmth më datë 16.08.2006. Kontrata e huasë me institucionin bankar (me nr.{...} Rep, nr.{...} Kol) është lidhur më datë 29.09.2006, po pranë noteres Luljeta Kongoli (huadhënës, BANKA "{...} - SHQIPERI" sh.a. dhe huamarrës: E.Ç.; dhe dorëzanës D.Ç.), notere pranë të cilës ishin lidhur edhe kontrata fiktive të shitjes së tokës bujqësore të të pandehurës me familjarët e saj.

61.1. Në funksion të shkaqeve të ankimit të prokurorit (megjithëse jo determinante në mënyrën sesi ky kolegji do të arsyetojë në vijim), referuar të dhënave të përftuara nga këqyrja e faqes së regjistrimit të akteve noteriale të noteres Luljeta Kongoli, kontrata e shitblerjes së tokës bujqësore me nr.{...} Rep, nr. {...} Kol figuron e regjistruar më datë 06.07.2006. **Edhe në vlerësim të këtij kolegji, kontrata e huasë me nr.4480 Rep, Nr.2346 Kol, është lidhur më datë 06.07.2006 dhe, pikërisht, kjo është data e saktë e aktit e konfirmuar edhe nga deklaratimet e dëshmitares/noteres Luljeta Kongoli gjatë pyetjes së saj në seancë gjyqësore⁵⁵.** Nga ana tjetër, ndryshimi i datës së aktit noterial/kontratë, duke u korigjuar data "6" në "10", duke pasur palët, pra, e pandehura kontratën me datë 10, të korigjuar, është bërë nga noterja Luljeta Kongoli, kjo për ta përputhur me datën që mban kartela e pasurisë së paluaajtshme në emër të babit të të pandehurës, shtetasit R.K., e përmendur në kontratën e shitjes si pjesë përbërëse e saj. Në ndryshim nga çfarë pretendon dëshmitarja Luljeta Kongoli se data 10 e kontratës që palët kishin marrë dhe që ajo kishte në arkivë ishte thjesht një gabim material, **ky kolegji** vlerëson se nuk rezulton e provuar një rrethanë e tillë, referuar provave të tjera të shqyrtuara në këtë proces. Kontrata me këtë datë, pra, me datë 10 të korigjuar, i është dhënë nga noterja të pandehurës dhe rezulton të paraqitur në mbështetje të aplikim-Deklaratë për Kredi Hipotekore të bërë më datë 16.08.2006 pranë {...} Bank, si dhe është përdorur në aplikimin për regjistrimin e kontratës në hipotekë. Theksohet se në vetë përmbajtjen e kontratës shitblerjes së tokës bujqësore me nr.{...} Rep, nr.{...} Kol përshkruhet se është dhe kartela e pasurisë, e cila në fakt mban datën {...}, fakte këto të konfirmuara nga provat dokument të sekuestruara pranë këtyre institucioneve. Ndërkohë, noterja Luljeta Kongoli, në vijim të hetimeve të këtij procedimi penal, për të përputhur datën e kontratës fizike të gjendur në arkivën e saj, dt.{...}, me atë të rezultuar në regjistrimin fizik të regjistrimit të akteve noteriale, dt.06.07.2006, ka ndërhyrë vetë në kontratat e gjendura në arkivë, duke iu vendosur atyre datën 6, por tashmë Prokuroria e Posaçme kishte marrë një kopje të tyre, ku data e aktit/kontratë figuronte {...}⁵⁶.

Prokuroria ka argumentuar se data 10 në aktin noterial kontratë, dukshëm është e korigjuar, por ky falsifikim i ndodhur përballet me institutin e parashkrimit të ndjekjes penale.

⁵⁵ Dëshmitarja Luljeta Kongoli: "... data e vërtetë e lidhjes së kontratës është data 6, gabimi është data 10. Dëshmitarja shprehet nuk e mban mend pse është bërë ky gabim, kur e ka verifikuar numrin rendor i përket datës 6 në regjistër rendor".

⁵⁶ Me shkresën Nr.5263/1 Prot, datë 09.07.2021 të noterit Gjergj Kongoli është përcjellë (mbi kërkimin e prokurorisë së posaçme): Kontrata e Shitblerjes Nr.2938 Rep, Nr.1490 Kol, datë 10.07.2006 për shitblerjen e pasurisë me nr.131 /54, vol 4, faqe 100, sipërfaqe 3440 m² me shitës R. Kaja, S. Kaja dhe Ervin Kaja dhe blerës E.Ç., në vlerën 300,000 lekë.

61.2. Më tej, ky kolegji vijon arsyetimin se, duke u fokusuar në faktin tipik që i është atribuuar të pandehurës E.Ç. si vepër penale “Falsifikimi i dokumentave”: “*e pandehura e ka kryer veprën penale në formën e përdorimit të dokumentit, kontratës së shitblerjes nr.{...} rep, nr.{...} kol, datë {...} (data 10 e korrigjuar), për shitblerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, si falsifikim intelektual, në lidhje me çmimin e blerjes dhe faktin që kjo tokë është blerë. Kjo kontratë është e falsifikuar, për shkak se nuk përputhet me ato të dorëzuara në ASHK dhe të ruajtura në arkivën e noteres, për sa i përket çmimit të vendosur në të, si dhe në lidhje me faktin se tokat në fakt nuk janë blerë... ”.*

61.3. Sikurse rezulton nga provat dokument të pasqyruara në pjesën III, “*Rrethanat e faktit dhe provat, faktet penale atribuuar të pandehurës E.Ç.*”, e pandehura ka pasur në dispozicion një kontratë shitjeje të tokës bujqësore, që e ka përdorur në mbështetje të kërkesës për të përfutur kredinë, kontratë në të cilën çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, ndërkohë që në kontratat e të dorëzuara në Z.V.R.P.Palujtshme Kavajë, për efekt të regjistrimit të kontratës së shitjes dhe kontratat e ruajtura në arkivën e noteres, çmimi rezulton 300.000 lekë. Gjithashtu, këtë kontratë, dmth atë ku çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, e ka paraqitur edhe në ILDKPKI, kur ka dhënë shpjegime në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, më datë 02.10.201, kur është mbajtur dhe procesverbali “*Mbi shpjegimet e subjektit deklarues*”.

61.4. Në përgjigje të shkaqeve të ankimit të prokurorit të posaçëm, në raport me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë mbi momentin dhe rrethanat se si është vendosur në qarkullim një kontratë e tillë me çmim të ndryshëm, pra, me çmim 50.000 euro, e disponuar nga e pandehura dhe e përdorur po prej saj në rrethanat si më lart, **ky kolegji përshkruan, fillimisht, se si i gjen të provuara faktet lidhur me këtë moment.** Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, ka gjetur bindëse dëshminë e dëshmitares për këtë fakt, të noteres Lulejta Kongoli, duke u shprehur se: “... Çmimi i kësaj kontrate fillimisht ishte 300.000 (treqind mijë) lekë. Më pas, sipas deklarimit të shtetas Lulejta Kongoli mbi kërkesën e {...} Bank, po këtë ditë është ndryshuar vlera e kontratës së shitjes nga 300.000 (treqind mijë) lekë në 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro. Sipas noteres çmimi 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro për pronën, u ndryshua po atë ditë, me mirëkuptim të palëve në kontratë të cilët e nënshkruan përsëri, dhe ky ndryshim u bë, sepse banka nuk ia pranonte, këtë pronë si kolateral me çmimin 300, 000 (treqindë mijë) lekë. Në deklarimin e saj, shtetasja Lulejta Kongoli thekson se ajo ka qenë notere e bankës {...} që nga themelimi i saj dhe këtë informacion e ka marrë nga banka... ”.

Vihet re nga ky kolegji se i njëjti qëndrim i mbajtur në fazën e hetimit paraprak (ku referon Gjykata e Shkallës së Parë, duke qenë se është proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar mbi aktet e hetimit paraprak), mbi momentin kur është korrigjuar çmimi i shitjes, u mbajtur nga dëshmitarja/noterja edhe gjatë pyetjes në kuadër të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në juridiksionin apeli, ku dëshmitarja/noterja u shpreh: “... **Po atë ditë është nënshkruar kontrata me 50 mijë (milion lekë) apo (mijë dollarë).** ish in dy kontrata të bëra në një ditë dhe kur janë hapur letrat, gabimisht ajo, me cilësinë e noteres, **mund të mos ketë zëvendësuar faqen e vlerës, pra, atë faqe të kontratës që kishte dhe çmimin.** Meqënëse është ndryshuar po atë ditë, dëshmitarja shprehet se kontrata e parë me vlerë 300 mijë lekë nuk është tërhequr në moment nga neglizhenca. Është bërë vetëm një kontratë urgjente për ta çuar tek Banka. Nga neglizhenca, dëshmitarja në cilësinë e noteres ka menduar që do t’i bëjë më pas. Dokumentet ish in të gjitha në zyrën e noteres, u rregullua dokumentacioni vetëm për Bankën, pjesa tjetër është në zyrë...” (deklarimet e dëshmitares të pasqyruara gjerësisht në paragrafin 32 e këtij vendimi).

61.5. Deklarimet e dëshmitares/noteres Luljeta Kongoli të vlerësuara si të vërteta nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, për sa i përket momentit të përpilimit të një kontrate tjetër (tashmë) me çmimin 50.000 (pesëdhjetë mijë) euro, që sipas saj është bërë brenda ditës, vlerësohen ndryshe nga ky kolegji. **Ky kolegji** nuk i gjen të vërteta këto deklarime, për shkak se bien ndesh me provat e tjera. Këto të fundit sjellin një tërësi indicjesh të përputhura ndërmjet tyre, që provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në kuptim të nenit 152/2 i K.Pr.Penale, se **krijimi i këtij akti/kontratë shitblerje me çmim të ndryshëm nga ai akti/kontratë që ishte krijuar fillimisht dhe gjendej edhe në Z.R.P.Palujtshme Kavajë, por dhe në vetë zyrën e noteres, është bërë më vonë.** Ky kolegji për të arritur në këtë konkluzion, merr në konsideratë këto rrethana: raporti i vlerësimit i kryer nga banka është i datës 06.07.2006; kontrata me çmimin 300.000 lekë, pra, ajo e gjendur dhe në arkivën e noteres, rezulton se në Z.V.R.Palujtshme Kavajë është regjistruar që më datë 31.07.2006, fakti që aplikimi për kredi është bërë që në muajin gusht 2006 dhe nuk mund të flitet për “*sugjerime të bankës*”, sikurse shprehet dëshmitarja/noterja **mbi çmimin** e sipërfaqes së tokës që do të vihej si garanci për shlyerjen e kredisë, më datë 06.07.2006, kur është lidhur kontrata fiktive e shitblerjes. Nga ana tjetër, ky kolegji për të konkluduar se kontrata me çmimin 50.000 euro është hartuar jo në të njëjtën një ditë me kontratën e parë, merr në konsideratë, edhe: (i) qëndrimin e të pandehurës, e cila shprehet se çmimi i ndryshëm në kontratën e gjendur në institucionin bankar **duhet të ketë qenë një ngatërresë faqesh me atë të kontratës së shitjes së pjesës tjetër të tokës bujqësore**, kur në fakt ka qenë e vetëdijshme, referuar provave dokument, por dhe deklarimeve të dëshmitares Luljeta Kongoli se ndryshimi i çmimit nga noterja është kryer gjithnjë në kuadër të plotësimit të kushteve që ajo (e pandehura E.Ç.) të merrte kredinë (“...kur e çoi Leda në bankë, nuk e pranoi, ata e kthyen përsëri, duke mos e pranuar pa i vënë një vlerë, duke kërkuar rritjen e vlerës, pra, të çmimit, kjo për të mundësuar marrjen e kredisë”); (ii) Deklarimet e shtetasës S.K.: “*Me sa mbaj mend, unë kam qenë dy ose tre herë te noterja, por saktësisht nuk mbaj mend*” (nëse të dyja kontratat me çmime 300.000 mijë lekë dhe 50.000 euro do ishin përpiluar në një ditë, nuk kishte pse shtetasja S.K. të shkonte tek noterja, përveçse një herë datë 06.07.2006).

61.6. Në konkluzion, ky kolegji gjen të provuar faktin se, nga ana e noteres Luljeta Kongoli, mbi interesimin e të pandehurës E.Ç. dhe në funksion të mundësimit të marrjes së kredisë, në një kohë më të vonë se data 06.07.2006, datë kur është lidhur kontrata e shitblerjes së tokës bujqësore me nr.{...} rep, nr.{...} kol, duke e regjistruar këtë datë edhe në regjistrin noterial (megjithëse kontrata mban datën datën {...}, ku data 10 është e korigjuar, pasi ka qenë 6, paragrafi 61.4. i këtij vendimi), është përpiluar një kontratë tjetër, ku i vetmi ndryshim është çmimi i shitjes, i shënuar 50.000 euro, ndërkohë që në kontratat e para ishte 300.000 lekë. Pra, edhe pse kontrata në origjinë ka qenë fiktive, pasi nuk ka pasur *si qëllim* të sjellë pasojat e një kontrate shitje dhe është bërë vetëm në funksion të përfitimit të kredisë nga e pandehura E.Ç., në vijim, gjithnjë në vazhden e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e kredisë, **është ndryshuar po nga noterja**, akti i parë/kontrata, vetëm në lidhje me çmimin, duke pajisur të pandehurën me të. Kjo kontratë duhet të ishte e njëjtë me atë që ishte depozituar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Kavajë (në funksion të regjistrimit publik) dhe me atë të gjendur në arkivën e noteres, ndërkohë ndryshon nga ato vetëm përsa i përket çmimit. Kontrata me çmim 50.000 euro është paraqitur nga e pandehura E.Ç. në mbështetje të kërkesës për të përfituar kredinë në vlerën e nevojshme, dhe është paraqitur po prej saj në ILDKPKI, kur ka dhënë shpjegime në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë” (më datë 02.10.2017 kur është mbajtur procesverbali “*Mbi shpjegimet e subjektit deklarues*”). Pikërisht, këtë *përdorim të fundit* (moment kohor që përfshihet brenda afatit të parashkrimit të ndjekjes penale), i atribuon të pandehurës Prokuroria e Posaçme si vepër penale

të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, në formën e përdorimit të dokumentit të falsifikuar. Ndërsa për përdorimin e kësaj kontrate në mbështetje të kërkesës për të përfitur kredi në vitin 2006, prokurorja ka argumentar se është parashkruar ndjekja penale.

62. Gjykata e Posaçme e Apelit, në funksion të analizës juridike të veprës penale, në përballje me shkaqet e ankimit, vlerëson të citojë nenin 186 të Kodit Penal:

“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.

Kur falsifikim bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet”.

63. Duke marrë në konsideratë arsyetimin e vendimit të ankimuar, shkaqet e ankimit të prokurorit të posaçëm, por dhe pretendimet e ngritura në apelin kundërshtues nga e pandehura E.Ç. (për sa këto të fundit ndikojnë dhe gërshetohen me ekzitencën e veprës penale dhe parimet themelore të ushtrimit të ndjekjes penale), **ky kolegji** vlerëson se paraqesin rëndësi për tu trajtuar këto momente:

së pari: Situata kur për falsifikimin e dokumentit, si formë e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nuk mund të ngrihet akuzë për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, a përbën pengesë që dikush të hetohet mbi formën tjetër të kryerjes së kësaj vepre penale, atë të përdorimit të dokumentit të falsifikuar në një kohë më të vonë, veprim/përdorim brenda harkut kohor të parashkrimit të ndjekjes penale?

së dyti: A konsiderohet në rastin konkret e falsifikuar kontrata e shitblerjes nr.{...} rep, nr.{...} kol, datë {...} (data 10 e korrigjuar), për shitblerjen tokës arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar nga noterja 50.000 euro, si falsifikim *intelektual*, në rrethanat e rezultuara të provuara për këtë kolegji sipas paragrafit 61 të këtij vendimi. Nëse po, falsifikimi konsiston (*i*) në lidhje me çmimin e blerjes, apo dhe (*ii*) në faktin se kjo tokë realisht nuk është blerë (akuza fokusohet tek të dy këto momente)?

së treti: Nëse ky akt do të konsiderohet i falsifikuar, paraqitja e tij nga e pandehura E.Ç. e kësaj kontrate në ILDKPKI, si praktikë e kontratës së kredisë/huasë me institucionin kredidhënës, kur ka dhënë shpjegime më datë 02.10.2017⁵⁷ në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, a përmban elementët e objektivë dhe subjektivë të kërkuar për ekzitencën e figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, në formën e **përdorimit**.

64. Lidhur me momentin e parë të shtruar për trajtim në paragrafin e mësipërm, ky kolegji konstaton qartësinë e dispozitës penale, nenit 186/1 të Kodit Penal, e cila ka specifikuar, sikurse ka analizuar edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë se, kjo vepër penale kryhet në dy forma, nëpërmjet *falsifikimit* dhe *përdorimit* të dokumentit të falsifikuar. Kjo do të thotë se, edhe nëse për *falsifikimin* si fakt penal është parashkruar ndjekja penale, duke qenë njëherazi i dënueshëm penalisht edhe përdorimi, kjo nuk e pengon organin procedues të hetojë, *së pari* për falsifikimin e dokumentit, megjithëse nuk mund të ngrihet një akuzë lidhur me këtë fakt, në kushtet e parashkrimit të nenit 66

⁵⁷ Më datë 02.10.2017 kur është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues”.

të Kodit Penal, “Parashkrimi i ndjekjes penale”⁵⁸ (sikurse mund të mos ngrihet akuzë edhe për ndonjë episod të përdorimit të dokumentit për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit), dhe në vijim për përdorimin e dokumentit, fakt penal për të cilin nuk është parashkruar ndjekja penale. Më tej, është gjykata ajo që, në rastin e ngritjes së akuzës penale për *përdorim të një dokumenti të falsifikuar*, kontrollon, **fillimisht** nëse dokumenti është i tillë, pra, i falsifikuar, megjithëse për faktin penal të falsifikimit është parashkruar ndjekja penale dhe, më tej, nëpërmjet vendimmarrjes, arsyeton nëse gjendet i provuar fakti penal i kryer brenda afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, pra, *fakti i përdorimit të dokumentit të falsifikuar*. Në këtë kontekst, qëndrimin e të pandehurës në apelin kundërshtues: “... në ngritjen e një akuze për “përdorim të dokumenteve të falsifikuara” prokurori i çështjes është në pamundësi të konfirmimit paraprak nga gjykata që dokumenti është i falsifikuar dhe e gjitha ngelet në rangun e një pretendimi...”, **ky kolegji nuk e gjen të pabazuar**.

64.1. Gjithashtu, i pabazuar gjendet nga ky kolegji edhe pretendimi i të pandehurës në apelin kundërshtues se prokuroria është konfuze lidhur me arsyen se përse është sjellë në gjykim e pandehura, për falsifikimin, i cili është parashkruar si fakt penal, apo për përdorimin e dokumenteve të falsifikuara. Fillimisht, **gjykata e apelit vlerëson** se duhet marrë në analizë kuptimi i termave “fakt penal”, “vepër penale”, “akuzë” dhe “cilësim juridik”. GJEDNJ në vendimmarrjen e saj ka theksuar se, “**akuza**” është njoftimi zyrtar nga ana e autoritetit kompetent, i faktit që lidhet me kryerjen e një vepre penale. Natyra e akuzës është cilësimi juridik që u bëhet fakteve në akt-akuzë. Shkaku i akuzës janë faktet materiale për të cilat akuzohet i pandehuri.⁵⁹ Në referim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, me rëndësi në funksion të garantimit të të drejtave kushtetuese dhe procedurale të pandehurit, është komunikimi i akuzës, me të gjitha elementet e saj të renditura më lart. Në të njëjtën linjë, në vlerësim të këtij kolegji, ka ecur edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (me fuqi detyruese *erga omnes*), e cila në lidhje me atribucionin e akuzës, në vendimin nr.24/2012, mes të tjerave ka argumentuar se: “... *E drejta e individit për t’u vënë në dijeni menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, është sanksionuar nga neni 31/a i Kushtetutës dhe nga neni 6/3/a i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Ky parim kushtetues është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në funksion të realizimit të së drejtës së mbrojtjes të të akuzuarit si dhe të garantimit të parimit të barazisë së armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes. Gjykata vëren se qëllimi i këtyre dispozitave është të krijojnë mundësinë për të akuzuarin të njihet paraprakisht me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit, në mënyrë që të ushtrojë të drejtën e tij për të përgatitur një mbrojtje efektive, pra për të paraqitur argumentet në favor të tij dhe për të kundërshtuar akuzën e ngritur (shih vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

10. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ajo duhet të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (shih vendimet nr.37, datë 19.09.2011; nr.25, datë 10.06.2011; nr.5, datë 17.02.2003 dhe nr.33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese).

⁵⁸ Neni 66 i Kodit Penal: “Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; c) **pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë**; ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.

⁵⁹ Vendimi Kamasinski kundër Austrisë, datë 19.12.1989, Vendimi Pelissier e Sassi kundër Francës; Vendimi Drassich kundër Italisë etj.

12. Po në këtë drejtim, qëllimi i të drejtës për t'u informuar për akuzën, i sanksionuar nga neni 6/3/a i KEDNJ-së, është që informacioni i kërkuar t'i jepet të akuzuarit në momentin e ngritjes së akuzës, ose në momentin e fillimit të procesit gjyqësor dhe është thelbësor fakti që vepra penale për të cilën dënohet një person, është ajo për të cilën ai është akuzuar (shih vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Nga sa më lart, informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të veprës penale, duhet të konsiderohet si kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtjeje efektive, e cila është një nga garancitë themelore për realizimin e të drejtës për një proces të rregull ligjor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së (shih vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese)".

64.2. Duke iu kthyer gjendjes së fakteve në rastin konkret, në aktin e njoftimit të akuzës të të pandehurës E.Ç., Prokuroria ka ushtruar ndjekjen penale, duke pretenduar:

a. provueshmërinë e faktit se kontrata e shitblerjes së tokës bujqësore me nr. {...} rep, nr. {...} kol, në fjalë është e falsifikuar në lidhje me çmimin e blerjes dhe në lidhje me faktin se kjo tokë realisht nuk është blerë, falsifikim që i përket vitit 2006;

b. provueshmërinë e përdorimit të kësaj kontrate nga e pandehura po në vitin 2006 për të përfutur kredinë dhe parashkrimin e ndjekjes penale për këtë fakt dhe, më pas, akuza;

c. ka saktësuar se akuza konkrete konsiston në përdorimin e kësaj kontrate në datë 02.10.2017⁶⁰ në ILDKPKI, kur ka dhënë shpjegime, duke e konsideruar të provuar përdorimin e këtij dokumenti, si formë e anës objektive të veprës penale "Falsifikimi i dokumentave".

d. Gjithashtu, akuza ka saktësuar se për faktin penal të falsifikimit të dokumentit/kontratë e shitblerjes nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} (data 10 e korigjuar) dhe përdorimin e tij, të dy fakteve që i përkasin vitit 2006, ndjekja penale është parashkruar.

Është tashmë e qartë se akuza ka saktësuar faktin që lidhet me kryerjen e një vepre penale, cilësimin juridik që i bëhet faktit dhe, njëherazi, shkakun e akuzës, dmth faktet materiale për të cilat akuzohet e pandehura E.Ç.. Në këtë kontekst, qëndrimin e të pandehurës në apelin kundërshtues se prokuroria është konfuzë në ngritjen e akuzës, *ky kolegji nuk e gjen të bazuar.*

65. Në lidhje me momentin e dytë të shtruar për trajtim në paragrafin 63 të këtij vendimi (pyetja: A konsiderohet në rastin konkret e falsifikuar kontrata e shitblerjes nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...}, data 10 e korigjuar, për shitblerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar nga noterja 50.000 euro?), ky kolegji, në ndryshim nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë (Kontratat noteriale⁶¹ nuk futen në kategorinë dokumenteve të falsifikuara, pasi këto dokumente janë origjinale dhe shprehje e vullnetit të palëve), vlerëson se edhe aktet noteriale, origjinale, mund të falsifikohen nëpërmjet gënjeshtres ideologjike. Në rastin konkret, sikurse u analizua edhe më lart, kjo ka ndodhur në një kohë më të vonë sesa data 06.07.2006 (data kur kontrata është regjistruar në regjistrin noterial), me vullnetin e palëve të aktit noterial/kontratës së shitblerjes, të pandehurës E.Ç., familjarëve të saj që kanë nënshkruar aktin, por dhe të noteres, duke krijuar noterja po një akt noterial, të nënshkruar nga palët kontraktore, me çmim tjetër (të ndryshuar) të tokës bujqësore, nga çmimi i kontratave që iu kishte dhënë më parë palëve, kontrata këto të gjendura në hipotekë (aktualisht në ASHK) dhe në arkivën e vetë noterit, që kanë çmimin 300.000 lekë.

⁶⁰ Më datë 02.10.2017 kur është mbajtur procesverbali "Mbi shpjegimet e subjektit deklarues".

⁶¹ Kontrata e shitblerjes me Nr. 2938 Rep., dhe Nr. 1490 Kol., datë 10.07.2006, si dhe kontrata e shitblerjes me Nr. 2937 Rep., dhe Nr. 1489 Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara noteres Luljeta Kongoli, me palë: Shitësit: R. Kaja, S. Kaja dhe Ervin Kaja; Blerës: E.Ç.,

65.1. Lidhur me konkluzionin e këtij kolegji se edhe aktet noteriale, origjinale mund të falsifikohen nëpërmjet gënjeshtërs ideologjike, konstatohet se termin “dokument” i përmendur në nenin 186/1 të Kodit Penal, nuk përkufizohet se çfarë përfshin. Megjithatë, trajtimi teorik ka sqaruar pa asnjë ekuivok se “document” janë, pikë së pari, *në kuptimin e ngushtë*, çdo objekt në të cilin, *në formë të shkruar*, është vënë deklarata e ndonjë personi për një fakt relevant juridik. Teksti i deklaratës mund të vendoset (shkruhet) me dorë, me makinë, me kompjuter, me fotokopjim dhe fotografim. Gjithashtu, dokument, në kuptim të inkriminimit, përveç dokumentit të zakonshëm të shkruar, që përdoret në komunikimin juridik, kuptohen edhe dokumente të tjera, me të cilat mund të dëshmojnë fakte të caktuara dhe e dhëna e regjistruar, e cila është rezultat i përpilimit elektronik të të dhënave. Pra, është e qartë se, ndër dokumentat që gëzojnë mbrojtje nga inkriminimi janë aktet zyrtare, ku përfshihen edhe aktet zyrtar që përpilohen nga personi që ushtron veprimtari publike, sikurse në rastin konkret noteri. Pikërisht, për këtë kategori të dokumentave flet neni 253 i K.Pr.Civile, që jep një përkufizim të aktit zyrtar: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”*.

65.2. Ky kolegji arsyeton se, referuar falsifikimit, si formë e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, ai konsiston në falsitet *material* dhe *ideologjik*. *Falsifikimi material* realizohet duke vepruar drejtpërsëdrejt mbi dokumentin, si psh duke bërë shtesa, korrigjime, ndryshime dhe çdo veprim tjetër material (nëpërmjet shtypjes, gërryerjes, fshirjes në dokumentin ekzistues). Ndërsa *falsifikimi ideologjik* mundësohet duke falsifikuar përmbajtjen e tij, pa prekur formën e dokumentit, duke vërtetuar një fakt që nuk ka ndodhur fare, ose nuk ka ndodhur në masën që përcaktohet në dokument. Pikërisht, me këtë metodë të fundit është falsifikuar kontrata e shitblerjes, e lidhur përpara noteres Luljeta Kongoli, përdorur nga e pandehura E.Ç. fillimisht për marrjen e kredisë në vitin 2006. Kjo kontratë duhet të ishte e njëjtë me atë që ishte depozituar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë (në funksion të regjistrimit të kontratës së shitblerjes) dhe me atë të gjendur në arkivën e noteres, ndërkohë ndryshon nga ato **vetëm për sa i përket çmimit**, ku noterja ka pasqyruar vlerën/çmimin 50.000 euro dhe kjo është konfirmuar nga palët, pra, edhe nga e pandehura/blerësja E.Ç., e cila ka nënshkruar këtë akt noterial, duke i shërbyer çmimi i ri mundësimin të marrjes së kredisë prej saj.

65.3. Në vlerësim të këtij kolegji, fakti që kontratat e titulluara kontrata shitjeje kanë qenë me elementë fiktiviteti, pra, të lidhura që në gjenezë duke mos pasur qëllim palët të sjellin pasoja juridike në lidhje me çmimin, një element parësor (thelbësor) i një kontrate shitjeje, por janë ndërmarrë vetëm për të plotësuar kushtet për të përfituar kredinë që do të mbulonte çmimin e apartamentit që synohej të blihej, nuk shmang falsifikimin ideologjik, arsyetuar më lart mbi kontratën e lidhur mbi sipërfaqen prej 3445 m², falë të cilit është përftuar një kontratë me një çmim të ndryshëm nga ai i kontratave të gjendura në Z.V.R.Paluajtshme Kavajë (aktualisht në ASHK) dhe në arkivën e vetë noteres. **Për ekzistencën e falsifikimit nuk është çështje relevante saktësia e përmbajtjes së dokumentit autentik, apo fiktiviteti i kontratës së shitblerjes në rastin konkret. Kjo kontratë përfaqëson për të tretët një dokument publik apo akt zyrtar, mbi të cilin ekziston prezumimi i përgjithshëm ligjor për saktësinë e përmbajtjes së tij, me supozimin që janë përmbushur në tërësi kushtet e parashikuara ligjore.** Me rëndësi për ekzistencën e falsifikimit është që dokumenti origjinal (autentik), pra, kontrata e shitblerjes, kopje të të cilës gjendet në arkivën e noteres dhe në Z.V.R.Paluajtshme Kavajë (aktualisht në ASHK) është ndryshuar në lidhje me çmimin.

65.4. Gjithashtu, ky kolegji gjen të papërputhur me faktet dhe konceptin teorik mbi *falsifikimin e padëmshëm*, konkluzion e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë se në rastin e veprimeve juridike fiktive dhe të simuluar, dmth në rastet e dokumentave/kontrata ku janë dokumentuar këto veprime juridike, kemi të bëjmë me *falsitetit të padobishëm (falso inutile)*. Referuar teorisë së të drejtës penale, falsiteti i padobishëm ose i padëmshëm ndodh në raste e mosekzistencës së objektit tipik, objektit material të falsifikimit, kur flitet për një akt i cili nuk ka vlerë provuese si dokument për qëllimet e vendimit që në rastin konkret duhet të merret, ose falsifikimi nuk e ndryshon besueshmërinë e objektit të falsifikuar, ose falsifikimi kryhet mbi një vepër/dokument ose një pjesë të tij pa vlerë provuese dhe *në të gjitha rastet veprimi i kryer, nuk ka aftësinë për të arritur një qëllim të paligjshëm*⁶². Mbi këto rrethana akti është i papërshtatshëm, për të fyer ndjeshëm interesin e mbrojtur dhe, për pasojë, falsifikimi nuk ndërshkohet.

Referuar këtij koncepti mbi falsifikimin e padobishëm dhe pandërshkueshmërinë penale të tij, konkluzioni se aktet noteriale ku janë dokumentuar veprimet juridike fiktive ose simuluese, hyjnë në këtë kategori falsifikimi, del jashtë këtij përkufizimi teorik, përpos dhe cungon faktet e rezultuara të provuara, për të cilën dhe është akuzuar e pandehura E.Ç.. Akuza konsiston edhe përdorimin prej saj të një aktit/dokumenti të falsifikuar, pasi mbi aktin origjinal/autentik, që ka pasur të dokumentuar një kontratë shitje fiktive, është nxjerrë një tjetër kontratë, me elementin çmim të ndryshuar dhe ky i fundit është përdorur nga e pandehura. Është e qartë se ky fakt i atribuuar të pandehurës nuk bie nën hipotezën e falsifikimit të padëmshëm apo të padobishëm.

65.5. *Si konkluzion, në vlerësim të këtij kolegji*, kontrata e shitblerjes nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} (data 10 e korigjuar), e tokës arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, *është e falsifikuar nga pikëpamja ideologjike, në lidhje me çmimin e blerjes*. Lidhur me këtë falsifikim të kryer si veprim nga noterja ka qenë në dijeni edhe e pandehura E.Ç. (shih paragrafin 61.5 të këtij vendimi), e cila e ka paraqitur këtë akt në aplikimin për kredi në vitin 2006 dhe në vitin 2017 në ILDKPKI.

65.6. Organi i akuzës e ka argumentuar falsitetin ideologjik të kontratës nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë {...} (data 10 e korigjuar), së tokës arë me sipërfaqe 3440 m², duke i atribuuar të pandehurës E.Ç. përdorimin si formë të anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, *edhe faktin se kjo tokë realisht nuk është blerë* (përveç falsifikimit në çmim), që nënkupton që kontrata ka qenë fiktive. Pra, megjithëse ndër argumentat e akuzës për të kundërshtuar arsyetimin e vendimit të apeluar janë dhe: “*Sidoqoftë, e pandehura nuk është sjellë në gjykim për falsifikim në lidhje me këto dy kontrata, që gjenden tek noteri dhe në ASHK, por për një kontratë të falsifikuar*” (paragrafi 58.5 i këtij vendimi); “*nuk është sjellë për gjykim për fiktivitetin e kontratave, por është sjellë për gjykim përse ka nënshkruar dhe në vijim ka përdorur një kontratë të ndryshme nga ajo që gjendet tek noteri dhe në ASHK*” (fq. 31 e ankim), në aktin e njoftimit të akuzës, të pandehurës përdorimi i kontratës së falsifikuar, i atribuohet duke e përqëndruar elementin e falsitetit ideologjik edhe në faktin se toka realisht nuk është blerë, që nënkupton se kontrata ka qenë fiktive. Mbi këtë qëndrim të organit të akuzës në atribuimin e faktit penal të përdorimit të dokumentit/kontratë të falsifikuar pranë ILDKPKI-së të pandehurës E.Ç., ky kolegji e gjen me vend faktin që Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë është ndaluar ka arsyetuar dhe ka konkluduar se: “... *veprimet juridike fiktive ose të simuluar nuk plotësojnë elementët e figurës së veprës penale të “Falsifikimit të*

⁶² Praktika e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Italisë: seksioni 5 nr.265111, datë 22 shtator 2020, Seksioni 5 nr. 28599 07/4/2017, Bautista, Rv. 270245; Seksioni 5, nr. 11498 05/07/1990. Casarola, Rv. 185132; Seksioni 54/41, nr. 205/ 1984, Marinelli, Rv. 164742

dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, por përpilimi dhe përdorimi i tyre në praktikë mund të passjellë përgjegjësi penale për vepra të tjera penale... ”.

65.7. Në vijim të konkluzionit të mësipërm të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, edhe **ky kolegji** vlerëson se të nënshkruarit e kontratave fiktive në funksion të mundësisimit të marrjes së një kredie nga një institucion kredihënës, nuk përbën falsifikim intelektual në kuptim penal, pra, për t’u penalizuar sipas nenit 186/1 të Kodit Penal. Kjo, pasi **fiktiviteti** (si element) në këtë rast, nëse shoqërohet me qëllimin e kërkuar nga dispozita për të mos kthyer më kredinë e marrë, përfshihet në elementët e sjelljes penalisht të dënueshme nga neni 146 i Kodit Penal, “*Mashtrim në kredi*” që parashikon se: “*Mashtrimi në dokumentet e paraqitura, duke përfutuar padrejtësisht kredi **duke regjistruar në mënyrë fiktive** në hipotekë objekte që nuk ekzistojnë, ose tej vlerës së tyre reale, ose **në pronësi të një tjetri**, të bëra me qëllim për të mos kthyer më kredinë e marrë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet*”.

Po kështu, në nenin 143/a/3 të Kodit Penal sanksionohet si vepër penale “Manipunimi i çmimeve dhe përhapja e informacioneve të rremë” dhe një ndër format e kryerjes së veprës penale janë dhe: a. Veprimi apo mosveprimi i personit që: a) **nënshkruan një kontratë fiktive për shitjen apo zëvendësimin e titujve**; c. përhap informacion apo fakte të tjera të rreme për rritjen ose rënien e çmimit të titujve apo krijimin e një **tregtimi fiktiv aktiv të tyre**, me qëllim përfitimi personal për vete, një palë të tretë apo në dëm të kësaj të fundit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në tre vjet. Në nenin 145 të Kodit Penal parashikohet se: “Paraqitja e rrethanave të rreme në lidhje me objektin që sigurohet ose krijimi i rrethanave të rreme dhe paraqitja e tyre në dokumentet duke përfutuar padrejtësisht sigurime, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”. **Lidhur me këtë** parashikim, në praktikën e Kolegjit penal të Gjykatës së Lartë⁶³ është arsytuar: ““Në nenin 145 të Kodit Penal parashikohet se: “**Paraqitja e rrethanave të rreme në lidhje me objektin që sigurohet ose krijimi i rrethanave të rreme dhe paraqitja e tyre në dokumentet duke përfutuar padrejtësisht sigurime, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet**”....**Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se i gjykuari nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale për falsifikimin, jo për faktin se nuk provohet ta ketë kryer, por se veprimet e tij në lidhje me përdorimin e dokumenteve të falsifikuar janë pjesë përbërëse e realizimit të qëllimit kriminal të mashtrimit në sigurime. Kolegji Penal çmon se falsifikimi nëpërmjet përdorimit dhe vepra penale e mashtrimit në sigurime për të gjykuarin nuk konkurrojnë si vepra penale më vete**”.

65.8. Aty ku ligjvënësi ka parashikuar fiktivitetin, apo rrethanat e rreme që mund të burojnë edhe nga një veprim juridik fiktiv, si elementë sjellje/të anës objektive të një vepre penale, e ka bërë në dispozita të veçanta të tij, duke e ngritur kundërligjshmërinë në nivel penal. Ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit, arsyeton se fiktiviteti i veprimeve juridike në përgjithësi, nuk përbën falsifikim intelektual, në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal, pasi **bëhet fjalë për një marrëdhënie juridike civile apo private** ndërmjet palëve kontraktore, të cilat **me vullnetin e tyre** zgjedhin të kryejnë veprime juridike **pa pasur si qëllim** që të sjellin pasoja juridike⁶⁴. Mbi analizën e mësipërme, ky kolegji gjen të pathemeltë argumentin e prokurores se “*fiktiviteti nuk ngelet më mes palëve, në momentin kur dokumenti përdoret tek të tretë, institucione shtetërore, duke treguar diçka të ndryshme nga realiteti dhe se në këtë situatë gjendemi përpara veprës penale të falsifikimit*”, duke nënkuptuar që falsifikimi si vepër penale në formën e përdorimit, qëndron **në çdo rast**, kur aktet

⁶³ Vendimi nr. 354, datë 20.12.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁶⁴ Neni 92 i Kodit Civil parashikon: “[...] Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)”.

zyrtare ku dokumentohen veprimet juridike/kontrata fiktive paraqiten në institucione të ndryshme shtetërore. Në vlerësim të këtij kolegji, fiktiviteti i një veprimi juridik si element sjelljeje/i anës objektive të një veprë penale duhet të gjendet në trup të një dispozite penale konkrete, pasi ndryshe mbetet një marrëdhënie juridike civile ndërmjet palëve kontraktore. Në rastin e paraqitjes së një kontrate të tillë në një institucion kredidhënës, kontratë falë të cilës dhe është mundësuar regjistrimi në mënyrë fiktive i pronës në emër të personit që kërkon të përfitojë kredi, pronë që i përket dikujt tjetër, nëse nuk i shërben qëllimit të kërkuar nga dispozita penale, për të mos e kthyer më kredinë, mbetet një **marrëdhënie juridiko-private** ndërmjet palës kredimarrëse, sikurse rezulton e pandehura E.Ç., dhe vetë institucionit kredidhënës, sikurse rezulton { ... } Banka Sh.A. Në një situatë të tillë, duhet bërë dallimi ndërmjet **kundërligjshmërisë civile apo të formave të tjera të kundërligjshmërisë nga kundërligjshmëria penale.** Pikërisht, jo pa qëllim ky kolegji më lart (në paragrafin 55.1. të këtij vendimi) arsyetoi gjerësisht si një ndër elementët formues të veprës penale, referuar dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, *kundërligjshmërinë në aspektin penal* që nënkupton se veprat duhet të jenë të parashikuara nga ligji si të tilla, pra, si vepra penale (në kohën e kryerjes).

65.9. Ky kolegji, gjen të pabazuara konsideratat ngushtësisht të karakterit civil të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, në kuadër të trajtimit akuzës së parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal (përveçse të panevojshme, arsyetuar në kuadër të trajtimit akuzës së parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, arsyetuar më lart) se “...tokat bujqësore i janë kaluar të pandehurës E.Ç. nëpërmjet veprimit juridik të mbuluar që është dhurimi, pasi kontrata e shitjes me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, si dhe kontrata e shitblerjes me Nr.{...} Rep, Nr.{...} Kol, datë {...}, janë veprime juridike simuluese. Pra, burimi për krijimin e këtyre pasurisë është dhurimi dhe jo shitblerja... Në rastin konkret, këto kontrata hyjnë në kategorinë e veprimeve juridike simuluese, pasi qëllimi i vërtetë i palëve në lidhjen e këtyre kontratave ka qenë të mbulojë veprimin juridik të dhurimit, i cili përmbush të gjitha kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij, me qëllim sigurimin e një kredie bankare...”. Referuar deklarimeve të vetë të pandehurës E.Ç., as ajo vetë nuk ka pretenduar se qëllimi i palëve ka qenë dhurimi (siç argumenton gjykata e shkallës së parë), por është shprehur se e gjithë sipërfaqja që është regjistruar në emrin e saj ishte në respekt të ligjit nr.7501, që çdo pjesëtar i familjes bujqësore të merrte 5000 m² nga toka në pronësi dhe regjistrimi në emrin e saj mund të kryhej, vetëm nëse kryetari i familjes bujqësore i shiste këto toka me kontrata shitblerje, sikurse kishin vepruar dhe ata (e njëjta gjë është deklaruar, në fazën e hetimit paraprak dhe nga prindërit e të pandehurës). Nga ana tjetër, në këtë rast kemi të bëjmë me një shkak të paligjshëm të kontratave të shitblerjes së tokës bujqësore (shkaku i ligjshëm është një ndër konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës⁶⁵), në kuptim të me parashikimit të nenit 677 të Kodit Civil, “Shkaku i paligjshëm”, sipas të cilit: “Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme”.

65.10. Në përfundim, linjën e arsyetimit të përdorur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë “tokat bujqësore i janë kaluar të pandehurës E.Ç. jo me kontratë shitje, por nëpërmjet veprimit juridik të mbuluar që është dhurimi”, të përdorur për të kundërshtuar ekzistencën e falsitetin ideologjik të kontratës së shitblerjes në fjalë, në kontekstin se kjo tokë realisht nuk është blerë, pra, që kontrata është fiktive (formë tjetër e falsifikimit të aktit/kontratës të pretenduar nga akuza), **ky kolegji nuk e**

⁶⁵ Neni 663 i Kodit Civil: “Konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës Neni 663 Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”.

gjen të bazuar. Pavarësisht kësaj, ky kolegji arsyeton se këto konsiderata, apo linjë arsyetimi e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, nuk kanë asnjë ndikim në konkluzionin e mësipërme të këtij kolegji në paragrafin 65.7 dhe 65.8, konkluzion në fakt që përputhet me konkluzionin e arritur edhe nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë “*veprimet juridike fiktive ose të simuluar nuk plotësojnë elementët e figurës së veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”*” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, por përpilimi dhe përdorimi i tyre në praktikë mund të passjellë përgjegjësi penale për vepra të tjera penale”.

65.11. Si konkluzion, në përmbledhje të arsyetimit në paragrafët 65-65.10. në vlerësim të këtij kolegji, kontrata e shitblerjes nr.{...} rep, nr.{...} kol, datë {...} (data 10 e korigjuar), për shitblerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, mbi argumentat e pranuar më sipër nga ky kolegji, nuk vlerësohet e falsifikuar nga pikëpamja ideologjike, në lidhje me faktin se kjo tokë realisht është blerë (sikurse i atribuuohet të pandehurës), por vlerësohet e falsifikuar nga pikëpamja ideologjike, në lidhje me çmimin e blerjes, i rezultuar i ndryshëm nga ai i kontratave të gjendura në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë (aktualisht ASHK) dhe në arkivën e noteres. Kjo kontratë është përdorur nga e pandehura E.Ç. në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe praktikës dokumentare për t’u trajtuar me kredi në vitin 2006, ashtu edhe në ILDKPKI, kur ka dhënë shpjegime më datë 02.10.2017.

66. Në lidhje me momentin e tretë të shtruar për trajtim më lart (paragrafi 63 i këtij vendimi), nëse ky akt i konsideruar nga ky kolegji i falsifikuar në lidhje me çmimin e blerjes, i paraqitur nga e pandehura E.Ç. në ILDKPKI, si pjesë e praktikës dokumentare që kishte mundësuar kontratën e kredisë/huasë me institucionin kredidhënës, kur ka dhënë shpjegime më datë 02.10.2017⁶⁶ në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, përmban elementët e objektivë dhe subjektivë të kërkuar për ekzistencën e figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumentave” në formën e përdorimit, ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit vlerëson se në veprimin e të pandehurës, mungon ana subjektive, dashja si element i nevojshëm për konfigurimin e veprës penale të falsifikimit apo përdorimit të dokumentave.

66.1. Sikurse u analiza më lart, sa i takon formës së kryerjes së veprës së falsifikimit të dokumenteve të paraqitur nga neni 186/1 të Kodit Penal, nga ana objektive, falsifikimi i dokumenteve, mund të kryhet në dy forma: *(i)* nëpërmjet “falsifikimit të dokumenteve”, ose *(ii)* nëpërmjet “përdorimit të dokumenteve të falsifikuara” nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Falsifikimi, si njëra nga format kryerjes e përmendur më sipër, mund të bëhet në dy mënyra: *ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi dokumentin,* duke i bërë shtesa a tjetërsime të paligjshme, apo me çdo veprim tjetër material një dokumenti ekzistues të mëparshëm dhe në këtë rast, do të ndodhemi përpara falsifikimit “material”; apo në mënyrën tjetër që konsiston në *falsifikimin përmbajtjes së dokumentit, pa prekur formën e tij, duke ndryshuar konceptin dhe brendinë e dokumentit* dhe në këtë rast, kemi të bëjmë me *falsifikim “intelektual”* që çënon pjesën përshkruese-dëftuese të dokumentit. Ndërsa, për sa i përket *anës subjektive,* fajin, që ka të bëjë me qëndrimin psikik kundrejt faktit penal të paraqitur nga norma penale inkriminuese, vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, njeh si formë faji, vetëm atë të dashjes, në kuptimin që autori i veprës penale, e paraqit dhe e dëshiron faktin e falsifikimit, apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar. “Dashja” konsiston në dijeninë e subjektit, jo vetëm për të falsifikuar, por edhe për të cënuar marrëdhënien juridike që dokumenti, objekt falsifikimi, ka për qëllim të kryejë, pra, autori të synojë

⁶⁶ Më datë 02.10.2017 kur është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues”.

dashjen e falsifikimit dhe cënimit të funksionit që mbart akti përkundrejt atij që i drejtohet. Kjo veprë penale kryhet me “keqdashje”, si në formën e falsifikimit, ashtu edhe në atë të përdorimit dhe subjekti prek apo rrezikon të prekë të mirën juridike të mbrojtur, në varësi të vërtetësisë apo pavërtetësisë së dokumentit dhe marrëdhënien konkrete të mbrojtur, në kuadër të së cilës autori ndërmer veprimet “falsifikim” apo “përdorim”, apo të dyja njëherësh.

66.2. Për të nxjerrë në pah elementët që karakterizojnë anën subjektive, dashjen në figurën e veprës penale “falsifikimi i dokumentave”, ky kolegji ndalet në të kuptuarit drejt *të objektit juridik*, pra, të qëllimit të ligjvënësit (*ratio legis*) në parashikimin e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal “Falsifikimi i dokumentave”, në formën e falsifikimit apo të përdorimit të dokumentit të falsifikuar. E thënë ndryshe, ky kolegji ndalet në konkretizimin e të mirës juridike që legjislatori ka synuar të mbrojë në penalizimin e *falsifikimit dhe përdorimit të një dokumenti të falsifikuar* (shih argumentimin në paragrafin 55.2, 55.2.1 dhe 55.3 të këtij vendimi). Objekti, apo e mira juridike që synohet të mbrohet nëpërmjet veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, është marrëdhënia juridike konkrete që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, si dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve, nga veprimet ose mosveprimet kriminale, që sjellin si pasojë cënimin apo rrezikimin e ligjshmërisë së funksionimit të këtyre organeve, si dhe të drejtave apo interesave të ligjshëm të shtetasve⁶⁷. Nëpërmjet figurës së kësaj veprë penale ligjvënësi ka synuar të mbrojë drejtëpërdrejt interesin publik për autencitetin material apo vërtetësinë ideologjike të dokumentit, si dhe *interesin e specifik të subjekteve privatë apo publikë që garanton dokumenti i vërtetë për nga prejardhja dhe në përmbajtje, në sferën juridike të veprimtarisë së të cilëve (subjekteve) synon të ndikojë falsifikimi apo përdorimi i një dokumenti të falsifikuar.*

66.3. Ky kolegji arsyeton se, çdo veprë penale që kryhet me dashje, supozohet se është kryer me një qëllim të caktuar dhe autori i veprës që vepron me dashje është i qartë se me veprimin apo mosveprimin e tij do të arrijë këtë qëllim. Në këtë rast, qëllimi ka të bëjë me *qëllimin final, qëllimin e përgjithshëm që udhëheq veprimtarinë e autorit të veprës penale*. Qëllimi final tek figura e veprës penale të falsifikimit, *është të mashtrijë* nëpërmjet falsifikimit apo përdorimit të një dokumenti, dokument që paraqet rrethana të pavërteta si të vërteta. Qëndrimi i prokurores së posaçme, ndër shkaqet e ankimit, se legjislatori nuk ka përcaktuar qëllimin e veprës penale të falsifikimit, bie ndesh me sa më lart u arsyetua mbi elementin *dashje* në kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, *me të mirën juridike/marrëdhënien juridike të mbrojtur* nëpërmjet kësaj veprë penale, si dhe me dallimin ndërmjet *qëllimit të posaçëm, specifik*, si element përbërës të anës subjektive të veprës penale, kur dispozita e kërkon (neni 186/1 i Kodit Penal nuk e kërkon), nga *qëllimin final, qëllimin e përgjithshëm* që udhëheqës veprimtarinë e autorit të veprës penale në veprat penale të kryera me dashje. Mbi këtë moment u arsyetua gjerësisht në paragrafin 55.3. të këtij vendimi.

66.4. Duke iu kthyer faktit historik që i është atribuar të pandehurës E.Ç. si *përdorim i dokumentit të falsifikuar*/kontratë shitblerje nr.{...} rep, nr.{...} kol, datë {...} (data 10 e korrigjuar), për shitblerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3440 m², ku çmimi i shitjes është shënuar 50.000 euro, konstatohet se kjo kontratë është paraqitur prej saj **në funksion të** shpjegimeve mbi burimet e krijimit të pasurive që figurojnë në emër të saj, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 arsyetuar më lart. Kontrata në fjalë, pra, ajo me këtë çmim, rezulton të jetë pjesë e praktikës së

⁶⁷ Vendimi nr.57, datë 19.04.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

kredisë gjendur pranë {...} Bank, të cilën e pandehura ka qenë e detyruar ta paraqiste në funksion të pyetjes së shtruar nga ILDKPKI: “Në deklarin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Arë me sip.1 450 m², me adresë {...}, blerë me datë {...} në vlerën 300 000 lekë, të ardhura nga paga dhe Arë me sip. 3 440 m², me adresë {...}, blerë me datë {...} në vlerën 50 000 Euro me burim kredi nga BIA, në shumën prej 35 000 Euro dhe 15 000 Euro të ardhura nga paga. Paraqisni dokumentacion vërtetues në lidhje me këto asete. Sqaroni lidhur me burimin e krijimit të këtyre asetëve (kredi dhe paga) në vlerat 300 000 leke dhe 50 000 Euro, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues (vetëm në 2006 ju keni krijuar asete, në vlerën totale 10 527 717 lekë, konvertuar në all me kursin e vitit). Sqaroni pse keni deklaruar që toka në {...} me sip. 3 440 m² është blerë në masën 35 000 Euro nga kredia e marrë në {...}, kur kjo bankë, në përgjigjen e dt.08.08.2017, na konfirmon se kredia 35 000 Euro është marrë në dt.29.09.2006 për blerje apartamenti”.

66.5. Pyetja që shtrohet në situatën e mësipërme është se cila është e mira juridike/marrëdhënia juridike konkrete që është rrezikuar nga e pandehura E.Ç. në rastin e përdorimit të dokumentit/kontratë shitblerje në ILDKPKI më datë 02.10.2017 dhe a ka synuar përdorimi i këtij dokumenti cënimin e veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, konkretisht, veprimtarinë e ILDKPKI-së. Në varësi të kësaj përgjigjeje mundësohet sqarimi i elementit subjektiv, dashje, në kryerjen e veprës penale të përdorimit të dokumentit të falsifikuar nga e pandehura E.Ç. Funksioni i aktit/kontratës së shitblerjes së paraqitur nga e pandehura në ILDKPKI vështrohet në harmoni me objektin e veprimtarisë së ILDKPKI-së. **Ky kolegji arsyeton** (sikurse arsyetoi në kuadër të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal) se, veprimtaria e ILDKPKI-së synon kontrollin në deklarin e saktë dhe kontrollin e pasurisë, legjitimitetin e burimeve të krijimit të pasurive, detyrimeve financiare, për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta, si dhe verifikimin e situatave të konfliktit të interesit sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Pra, nuk është në objektin e veprimtarisë së këtij institucioni verifikimi i faktit, nëse subjektet apo dhe institucionet bankare kanë synuar apo mundësuar zbatimin jo korrekt të normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare, e cila përbën *një marrëdhënie private* ndërmjet institucionit kredidhënës dhe kredimarrësit. Në këtë kontekst, nuk mund të thuhet se paraqitja nga e pandehura E.Ç. e së njëjtës kontratë shitblerje, me çmim 50.000 euro, e gjendur në dokumentacionin e marrjes së kredisë⁶⁸, kontratë fiktive që në gjenezë të saj, pasi palët as kanë paguar dhe as kanë pasur si qëllim të paguajnë çmimin e përmendur në kontratë, ka synuar cënimin e veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, konkretisht të ILDKPKI-së. Paraqitja e kësaj kontrate nga e pandehura në fakt është në funksion të mundësimin të përmbushjes së veprimtarisë së rregullt të këtij organi dhe *pjesë integrale e praktikës dokumentare të kontratës së huasë/kredisë* së lidhur ndërmjet të pandehurës E.Ç. dhe {...} Bank SH.A më datë 29.09.2006. Në këtë kontekst arrihet në konkluzionin se, në veprimin e të pandehurës E.Ç. në paraqitjen/përdorimin e kontratës së shitblerjes me çmimin *50 000 euro në ILDKPKI, mungon dashja për të cënuar marrëdhënien juridike që dokumenti i dorëzuar synon të provojë përpara këtij institucioni, gjithnjë nisur nga sfera juridike e veprimtarisë së këtij institucioni*. Natyrisht, dashja nuk nënkupton në vetvete çdo qëllim, pra, nuk nënkupton atë që prokurorja parashtron në ankim si qëllim të të pandehurës në kryerjen e veprës penale të përdorimit të dokumentit/kontratës së falsifikuar, “*për t’i qëndruar besnike akteve të falsifikuara, me qëllim që të mos diktohej se çfarë kishte ndodhur në realitet*”, por dashja konsiston **në qëllimin final** të vetë veprës penale të përdorimit të dokumentit

⁶⁸ Sekuestruar praktika e përfitimit të kredisë pranë Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. mbi vendimin e datës 15.07.2021 “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave”.

të falsifikuar dhe në rastin konkret duhet të synojë të mashtrojë nëpërmjet përdorimit të një dokumenti të falsifikuar, me qëllim cënimin apo rrezikimin e ligjshmërisë së funksionimit të ILDKPKI-së.

66.6. Referuar parimit të cënueshmërisë së nevojshme të marrëdhënies së mbrojtur (*nullum crimen sine iniuria*), sipas të cilit vepra penale, përveçse një shkelje ligjore e normës, duhet të konsistojë edhe në një cënim ose tentim të cënimit të marrëdhënies juridike që mbrohet si një e mirë juridike nga objekti i normës penale (analizuar në paragrafin 55.2. të këtij vendimi), **konstaton ky kolegji se, e pandehura E.Ç. nuk ka synuar cënimin e marrëdhënies së mbrojtur, cënimin e ligjshmërisë së funksionimit të ILDKPKI-së, jo vetëm për faktin se ka sqaruar rrethanat mbi burimet e krijimit të pasurisë që figurojnë të regjistruara në emër të saj, por edhe për faktin se objekti i veprimtarisë së këtij organi, nuk është verifikimi i zbatueshmërisë së normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare nga subjektet deklarues, apo identifikimi i veprimeve juridike të vlefshme apo të pavlefshme të ndërmarra nga subjekti deklarues vetëm për të plotësuar kushtet për të përfituar kredinë.** Për pasojë, nuk ka sesi të flitet për *interes*⁶⁹ të të pandehurës E.Ç. në përdorimin e kësaj kontrate fiktive shitje, fiktivitet i deklaruar po prej saj në ILDKPKI, pjesë e praktikës së kontratës së kredisë, përderisa kjo kontratë dhe veçanërisht çmimi, i paqenë që në gjenezë/në aktin origjinal, nuk i shërben të provuarit të diçkaje juridikisht të rëndësishme për veprimtarinë e ILDKPKI-së. Siç konstatohet, të pandehurës nuk i është dashur të justifikojë përpara inspektorit të ILDKPKI-së në muajin tetor 2017 faktin se “*tek noterja kontrata për pasurinë prej 3440 m² mban një shumë tjetër blerje nga ajo që gjendet në Bankën {...}*”, sipas terminologjisë së prokurores⁷⁰ dhe pretendimit të saj për ekzistencën e veprës penale përdorimit të dokumentit/kontratë të falsifikuar. Ky kolegji gjen me vend të përmendë në mbështetje të argumentimit të mësipërm dhe qëndrimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin nr.24, datë 9.2.2017, ku kolegji është shprehur: “... Ky Kolegj çmon se në rastin konkret, nga ana e gjykatave të themelit është gabuar në zbatimin e nenit 186 të Kodit Penal, pasi mungon ana subjektive si element i nevojshëm për konfigurimin e veprës penale. Vepra penale, duhet të jetë e kryer nga një person dhe të jetë e kundërligjshme. Ajo përfshin, si kundërligjshmërinë juridike formale, ashtu edhe atë thelbësore. Kjo e fundit ka të bëjë me zbatimin e parimit të cënueshmërisë së nevojshme të marrëdhënies së mbrojtur (nullum crimen sine iniuria) që mbrohet si një e mirë juridike nga objekti i normës penale. Vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj, e cila nga ana tjetër pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret dhe duhet të konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë, vetëm kur ekzistojnë të katër elementët e saj siç janë: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të ndëshkohet.....Për konfigurimin e një vepre penale konkrete (neni 186 të Kodit Penal), nuk mjafton vetëm shkelja e përcaktimit ligjor, thjeshtë si komandë ligjore,

⁶⁹ Vendimi nr.617, datë 16.06.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: “Që të arrihet në konkluzionin se jemi përpara kryerjes së veprës penale të parashikuara nga neni 186/1 i Kodit Penal në formën e përdorimit, do të duhet së pari të provohet përdorimi i aktit, por njëkohësisht të vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale së akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar”. Vendimi nr.24, datë 09.02.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: “Nëse subjekti nuk është i ndërgjegjshëm për cënimin dhe kompromentimin e interesit që dokumenti luan në rastin konkret, atëherë nuk mund të ketë një qëndrim psikik në dashjen e anës objektive të kësaj vepre penale”.

⁷⁰ Faqja 31 e konkluzioneve të parashtruara në apel: “Ndërkohë deklarimi i dhënë në muajin tetor 2017 para inspektorit të ILDKPKI-së nga e pandehura nuk korigjon ndonjë gabim material, por rrëfen të vërtetën. Ky rrëfim vjen jo për pasojë të dëshirës për korigjim, por se e pandehura.....duhet të justifikojë faktin se tek noterja kontrata për pasurinë 3440 m² mban një shumë tjetër blerje nga ajo që gjendet në Bankën Emporiki”.

por kërkohet edhe prania e një cënimi, domethënë të një sulmi që i bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale inkriminuese nga fakti penal... ”.

66.7. Si konkluzion, mbi arsyetimin e mësipërm, fakteve materiale që i rezultuan këtij kolegji të provuara dhe interpretimit të ligjit, paraqitja/përdorimi në ILDKPKP më datë 02.10.2017, e kontratës së shitblerjes me çmimim 50.000 euro, dmth më datë 02.10.2017⁷¹ kur është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues”, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, **nuk përbën** veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 Kodit Penal “Falsifikimi i dokumentave”, në formën e përdorimit të dokumentit të falsifikuar. Kjo rrethanë është e parashikuar nga neni 388 pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale, pra, një ndër rastet kur gjykata merr vendimin e pafajësisë. Në vlerësim të këtij kolegji, mungon njëri prej elementëve formues të figurës së veprës penale, **ana subjektive, dashja, si formë faji e kryerjes së kësaj vepre penale.**

67. Në funksion të trajtimit të të gjithë shkaqeve të ankimit që janë përqëndruar në linjën e arsyetimit në vendimin e ankimuar, ky kolegji, *pavarësisht konkluzionit si më lart,* gjen me vend të theksojë se nuk gjen të përputhur me situatën e fakteve që i rezultuan këtij kolegji, konkluzionin e arritur nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë: “Gjykata çmon se figura e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal nuk konkurron asnjëherë me figurën e veprës penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, **kur shërben si mjet për të provuar anën objektive të kësaj të fundit sikurse është deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë** (pika 37.7 e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë). **Ky kolegji** arsyeton se, kemi konkurim të veprave penale, nëse kemi një fakt të vetëm që i atribuohet autorit dhe, pikërisht, *këtë fakt duket sikur e parashikojnë dy ose më shumë dispozita penale.* Kjo nuk është situata e të pandehurës E.Ç., e cila rezulton se e ka përdorur dokumentin kontratë shitblerje të falsifikuar nga pikëpamja ideologjike në funksion të marrjes së kredisë (fakt penal për të cilin është parashikuar ndjekja penale) dhe, më tej, në funksion të dhënies së shpjegimeve plotësuese në ILDKPK mbi burimin e të ardhurave të përdorura për blerjen e apartamentit, si pjesë e praktikës së kredisë. Sikurse u arsyetua më lart, këtij kolegji i rezultoi se, përdorimi i dokumentit/kontratë shitblerje e tokës bujqësore nuk është në funksion të përmbushjes apo mjet që i ka shërbyer “deklarimit të rremë”, si elementë sjelljeje penalisht i dënueshëm, i parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal, element për të cilin ky kolegji vlerësoi se nuk qëndron në rastin konkret (konkluzioni i përmbledhur në paragrafin 66.7). Duke qenë kështu, nuk jemi në kushtet kur *dy norma ligjore rregullojnë “të njëjtën lëndë”* dhe kur kur do të duhej të zbatohet *parimi i specialitetit* që merret në konsideratë në zgjidhjen e çështjes së konkurimit të normave penale dhe cilësimit të drejtë juridik të fakteve penale. Në vendimin unifikues nr.3, datë 02.11.2015 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur si më poshtë lidhur me konkurimin dhe parimin e specialitetit (*lex primaria derogat legi subsidiariae*): “... **28. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në rast konkurrimit të normave penale, fakti që konsiderohet si vepër penale duket sikur parashikohet nga dy ose më shumë dispozita penale, por në të vërtetë kemi një vepër të vetme dhe nuk aplikohen dispozitat mbi bashkimin e veprave penale. Në këto raste, dispozitat e ndryshme që parashikojnë të njëjtën fakt si vepër penale, ose përjashtojnë njëra-tjetrën, ose thithin njëra-tjetrën, për arsye se marrëdhënia juridike që është cenuar, mbrohet nga dispozitat penale që parashikojnë si vepër penale të njëjtin fakt. Për të zgjidhur çështjen e zbatimit të saktë të normës ligjore, dhe si pasojë, cilësimit të saktë ligjor të veprës penale të parashikuar nga norma e zbatueshme, në rastin kur në pamje të parë**

⁷¹ Më datë 02.10.2017, kur është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues”.

(prima facie), në të njëjtën kohë duket sikur veprojnë më shumë se një dispozita penale, si kriteret logjike dhe juridike për zgjidhjen e kësaj çështjeje nga doktrina janë elaboruar këto parime: **i) parimi i specialitetit** (lex specialis derogat legi generali), **ii) parimi i subsidiaritetit** (lex primaria derogat legi subsidiariae), **iii) parimi i përthithjes** (lex consumens derogat legi consumptae). **29. i)** Në bazë të parimit të specialitetit, kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme, kjo në përputhje me kriterin e përgjithshëm juridik për zgjidhjen e kundërshtive lex specialis derogat legi generali. **Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një norme penale (të përgjithshme) janë të gjithë të pranishëm edhe në një normë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente më specifike që e cilësojnë normën e dytë, të posaçme në raport me normën e parë. Norma e përgjithshme përmbahet krejtësisht në normën e posaçme, kjo e fundit ka një përmbajtje më të gjerë dhe e përfshin të parën (marrëdhënie lloj dhe specie), prandaj shkelja e normës së posaçme (si normë me madhe) logjikisht përfshin edhe shkeljen e normës së përgjithshme (norma më e vogël), ndaj vetëm norma e posaçme do të zbatohet. Sa më e madhe të jetë prania e elementëve specifikues përbërës të një norme penale inkriminuese, aq më e ngushtë është fusha e veprimit dhe e zbatimit të saj, në raport me normën e përgjithshme, duke pasur kjo e fundit më pak elementë rrethorë që e kufizojnë fushëzbatimin e normës së përgjithshme, e cila rrjedhimisht gjen një zbatim më të gjerë. Meqenëse norma e përgjithshme ka një fushëzbatim më të gjerë nga ajo e posaçme, një fakt që përbën veprë penale që hyn në fushëzbatimin e normës së posaçme, do të hyjë edhe në fushëzbatimin e normës penale të përgjithshme. Megjithatë, po t'i zbatonim të dyja normat penale do dyfishoheshin efektet dhe do të shkelej parimi i ndalimit të gjykimit dy herë mbi të njëjtin fakt. Prandaj, vetëm njëra normë inkriminuese do të gjejë zbatim, ajo e posaçme, sepse norma e përgjithshme do përfshihet nga norma e posaçme. Baza e zbatimit të këtij parimi mbështetet në faktin se kemi të bëjmë me të njëjtën lëndë, domethënë me të njëjtin objekt; pra me të njëjtën marrëdhënie juridike të mbrojtur nga norma penale inkriminuese”.**

67.1. Në konkluzion, argumenti mbi moskonkurueshmërinë e veprave penale të parashikuara “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal me figurën e veprës penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, në rastin konkret, nuk mbështetet nga ky kolegji i Gjykatës së Posaçme të Apelit.

68. Si përfundim, Gjykata e Posaçme e Apelit konkludon në pathemelësinë e shkaqeve të ankimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në kuadër të kërkimit për ndryshimin e vendimit nr.48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe deklarimin fajtorë të të pandehurës E.Ç. për veprën penale të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal, “Falsifikimi i dokumentave”, në formën e përdorimit.

69. Për sa u arsyetua më sipër, në kuadër të të dyja akuzave “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, në formën e përdorimit dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, në formën e “deklarimit të rremë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vlerëson se vendimi nr.48, datë 16.09.2022 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të lihet në fuqi në tërësinë e tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në nenet 428, pika 1 shkronja a) të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.48, datë 16.09.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Shpenzimet proceduriale edhe në gjykimin në apel mbeten sikurse janë bërë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 12.01.2023.

GJYQTARE
DANIELA SHIRKA
d.v.

GJYQTARE
IGERTA HYSI
d.v.

GJYQTARE
MILIANA MUÇA
d.v.